

# PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



Viti V . Nr. 46. 19 shtator - 19 tetor 2010. Organ i shoqatës kulturore "Zëri Ynë"

Çmimi 0.80€



**7**

Fatos SHALA  
Institucione me grila



**18**

Intervistë  
Një e ardhme më e  
mirë për bujqësinë



**28**






Prof. dr. Hysen MATOSHI  
Imam Vehbi Ismaili:  
portreti i besimtarit...



Intervistë me presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu

**KOSOVËN E PRESIN SHUMË NJOHJE**







**8** Përvjetori i 11-të për 1840 plagët...

**Portreti i muajit:** Rikthehet..... 2  
**Avni Avdiu:** "Empatia" ..... 3  
 Intervistë me presidentin Fatmir Sejdiu..... 4-6  
**Fatos Shala:** Institucione me grila ..... 7  
**Astrit Veliqi:** Përvjetori i 11-të për 1840 plagët e hapura të Kosovës ..... 8  
**Përparim Bublaku:** S'ka zgjidhje për pacientët në koma ..... 9



**14** Reformimi i sistemit gjyqësor...

**Lulzim Ahmeti:** Rritja ekonomike deri në 5 për qind ..... 10  
**Dritë Slivova:** Mësimdhënësit mbesin pezull..... 11  
**Drita Vitia:** Fakulteti ekonomik "vërshohet" nga studentët ..... 12-13  
**Flamur Hyseni:** Reformimi i sistemit gjyqësor i domosdoshëm për integrim ..... 14-15



**16** Kur maqedonasit shkruajnë...

**Iljasa Salihu:** Kur maqedonasit shkruajnë libra shqip..... 16-17  
 Intervistë me ministrin Blerand Stavileci 18-19&22-23  
 Syri i kaltër ..... 20-21




**30** Atentatet dhe vdekja e Aliut r.a.

**Shpresa Zaplluzha & Samire Bilaca:** Trajtimi pedagogjik i nxënësve me sjellje të dhunshme ..... 24-25  
**Emine A. Vezaj:** Tatëpjeta e shoqërisë muslimano – shqiptare: shkaqet..... 26-27  
**Prof. dr. Hysen Matoshi:** Imam Vehbi Ismaili: portreti i besimtarit atdhetar..... 28-29  
**Muhamed J. Kajolli:** Atentatet dhe vdekja e Aliut r.a..... 30-32



**37** Igjiena e gojës brengë e...

**Arsim Jonuzi:** Sulm i hatashëm hakerësh..... 33  
**Atdhe Ibrahimimi:** Letërsia në përjasje me besimet fetare ..... 34  
**J.P.:** Herë korrin sukses, e herë fundosemi ..... 35  
**Besime Rrustemi:** "Hajt se një ditë do të bëhet mirë!" ..... 36  
**Artan N. Bejta:** Higjiena e gojës, brengë e arsyeshme..... 37-38  
**Dilaver Polisi:** Klubet trajnohen se si duhet t'i mbrojnë lojtarët e tyre ..... 39  
**Alban Bilalli:** Dardan Berisha i gatshëm për Kosovën në çdo kohë ..... 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,  
 KULTURË, ARSIM, ETIKË  
 Viti V / Nr. 46

19 shtator 2010 - 19 tetor 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI  
 kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës  
**Avni AVDIU**  
 avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës  
**Flamur MALOKU**  
 flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika  
**Osman D. GASHI**  
 osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore  
**Mimoza SINANI**


e-mail:

revistapaqja@gmail.com  
 revistapaqja@hotmail.com  
 http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,  
 përballë teatrit Dodona,  
 Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!



# RIKTHEHET

**P**ër ish-drejtorin ekzekutiv të QKU-së, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë ka vendosur në favor të tij. Ky komision i përbërë prej tre anëtarëve dhe një kryesuesi, nuk ka gjetur asnjë shkelje, siç është pretenduar, që ka bërë Ali Sadriu gjatë periudhës sa ka qenë drejtor. Ai është suspenduar me vendim të UD të Sekretarit Permanent, Haxhi Kamberit dhe në vendimin për suspendim nuk ishte dhënë asnjë arsyetim. Ali Sadriu ishte suspenduar para tre muajsh, pas insistimeve të shumta të ministrit Bukoshi. Bashkëpunimi institucional ndërmjet Bukoshit dhe Sadriut ishte prishur kur drejtori në suspendim kishte larguar nga puna ndihmësdrejtorin e QKU-së, Hasan Ahmeti. Thuhet se kthimin e Ali Sadriut në QKU e ka mbështetur edhe Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu. Sadriu u prit me nderime të larta nga punonjësit e QKU-së. Firma 'Krasniqi' kishte shtruar jashtë qilim të kuq në shenjë respekti të pritjes së tij.

Pronari i firmës që ka blerë qilimin dhe lulet është Skënder

Krasniqi. E vëllai i tij, Izet Krasniqi, punon në Qendrën Klinike Universitare, si zyrtar i lartë për investime kapitale.

Në shenjë falënderimi që Ali Sadriu i ka dhënë tenderin për pastrimin e QKU'së, ata e kanë shpërblyer me këtë pritje. ■

## BIOGRAFIA:

**Ali Sadriu** lindi më 20 gusht 1950, në fshatin Davidovc të Shtimes.

Filloren e kreu në vendlindje, të mesmen në Ferizaj. Fakultetin ekonomik e kreu në Universitetin e Prishtinës. Punoi si mësimdhënës i lëndëve ekonomike, në fabrikën e veglave dhe ujitjeve elektrike, në sektorin e planifikimit dhe analizës, si udhëheqës kontabiliteti (në Ferizaj), drejtor financiar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, drejtor financiar në Bankën e Bashkuar të Kosovës NANKOS. Që nga themelimi ka aderuar në LDK dhe nga viti 1991 punoi si kryetar i komunës së Shtimes, në strukturat e atëhershme të Qeverisë së Kosovës. Prej vitit 1997 ishte anëtar i Kryesisë së LDK-së, dega në Shtime dhe njëherësh edhe Kryetar i LDK-së, dega në Shtime si dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë periudhës 2000-2001 ishte bashkëdrejtues në Autoritetin Qendror Fiskal të Kosovës, i cili u shndërrua në Ministri për Ekonomi dhe Financa të Qeverisë së Kosovës, në krye të së cilës u vu më pas Ali Sadriu.



**F**otoja e ballinës është bërë nga Mo-hamad Sajad. Revista italiane "Internazionale" e ka publikuar në një faqe të plotë, ndërsa "Guardian" e vuri në faqe të parë. Ka qarkulluar nëpër botë, por pak ka sensibilizuar. Nuk është fotomontazh, as sajësë artistike, por pjesë e realitetit të hidhur me të cilin po përballet një popullatë e tërë pas fatkeqësisë së goditur natyrore. Fotografia jep një pamje tejet prekëse. Shihet se si mizat i kanë mbuluar kokë e këmbë fëmijët e shtrirë përdhe në dyshemenë prej balte. Ato u qëndrojnë sipër fëmijëve sikur të vegjlit të ishin mbeturina. Të bien në sy dy koka fëmijësh të ngjitura njëra pas tjetrës, gjë e cila tregon se janë gjallë, sepse njëri po thith biberonin me sy të mbyllur, ndërsa tjetri ka mbështetur krahun e djathtë në tokë. Biberoni është bosh. Pak më tutje, përdhe, është një shishe tjetër plastike, edhe ajo bosh. Në plan të dytë shohim dy fëmijë të tjerë që po flenë, të cilët në ndryshim nga dy të parët, duket sikur janë pa jetë, të mbledhur me lecka. Këta vogëlushë iu shpëtuan përmbajtjeve që fundosën Pakistanin dhe si miliona të tjerë u shpërngulën nga vendi. Vijnë nga rrethinat e Peshavarit. U gjetën në një cep të rrugës në Azakhel. Ata u vardiseshin nga pas makinave që kalonin aty, duke u kërkuar diçka për të ngrënë. Kjo familje, mamaja Fatima, babai Aslam Khan dhe tetë fëmijët e tyre (dy të parët në foto, Reza dhe Mahmoud, janë binjakë nga dy vjeç

# "EMPATIA"

secili), nuk janë pakistanezë, por refugjatë afganë, të cilët e kanë braktisur vendin e tyre, fillimisht për shkak të luftërave dhe tani për shkaqe natyrore. Ata vazhdojnë të jenë në radhën e gjatë të njerëzve të mjerë që zgjasin duart për të lypur, për të mos vdekur urie. "Kanë një muaj që nuk pinë qumësht", - thotë e ëma. "Kur e gjetëm sërish, Reza e mbante ende biberonin bosh në gojë", - shkruan gazetarja. Në fillim, babai i tyre Aslam e mbante familjen duke shitur pula me biçikletë. Tani, ata jetojnë përreth dhe brenda një tende të sajuar, pa asnjë organizatë humanitare që drejton kampin e vogël pa ujë dhe pa ndihmë shëndetësore. Njerëzit dhe bagëtitë mbijetojnë në pisllekun e paanë, ndërkohë që mizat kanë pushtuar vendin. Për t'i trembur Fatima ka vetëm disa gjethe bambuje, pak kohë dhe pak fuqi "për t'u shpallur luftë" mizave. Leckat që shihen në fotografi janë e gjithë pasuria e tyre. Reza ka veshur një bluzë mbi të cilën është shkruar fjala "Apples", disa germa të alfabetit latin dhe disa flutura të vizatuara. Duket sikur mizat janë gjithmonë gati. Ka gjasa që ushqehen dhe shpërndahen duke nuhatur pisllekun. Biologëve nuk u duket normale jeta e dy vogëlushëve, ku njëri ushqehet me mbetjet e tjetrit.

**Është e vërtetë se bota është mbërthy-**

**er anekënd me fatkeqësi jo vetëm natyrore. Mirëpo po ashtu është e vërtetë se po në këtë botë luksi dhe shkapërderdhjet e shfrenuara nga bollëku s'kanë të sosur. Bota e dy tablove: ajo e mjerimit dhe ajo e hedonizmit notojnë në po të njëjtën sferë, por si dy botë krejtësisht të ndara.**

**Po shkruhet e po thuhet mjaft se bota s'po bën aq sa duhet për ta zbutur gjendjen katastrofike në Pakistan. Humanizmi e solidariteti po veniten përballë dramës njerëzore. Sikur harrohet se fatkeqësitë janë sprova për të gjithë dhe herët a vonë gjithsecili do të kalojë nëpër kapërcyellin e tyre. Dhe fatkeqësia tërheq fatkeqësinë, ndërsa fatkeqësia më e madhe është kur humbet ndjenja e keqardhjes dhe atëherë kur njeriu i gëzohet fatkeqësisë së tjetrit.**

**Po çfarë rëndësie ka e tërë kjo për ne, konkretisht këtu në Kosovë? Të paktën të na ngjallë kujtesën. Ta sjellim ndër mend se edhe ne dikur ishim refugjatë diku, nën qiell të hapur, në kushte të mjerueshme; përballeshim me urinë dhe vdekjen. Nuk është edhe periudhë e largët sa të harrohet. Prandaj le të shërbejnë këto skena që mos t'i kalojmë me një perceptim pa ndjesi njerëzore. Le ty hymë pak në lëkurën e tyre dhe ndryshe do të ndihemi. Madje edhe ndryshe do t'ia dimë vlerën gjendjes në të cilën ndodhemi.** ■



# KOSOVËN E PRESIN SHUMË NJOHJE



## Muhamet JAHIRI

**Ë**shtë i pari i vendit, i cili është i bindur se Republikën e Kosovës po e presin ditë të mira. Ai ka deklaruar se Kosova do të ketë shumë njohje, sidomos pas vendimit për ligjshmërinë të dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND). Po ashtu, ka shprehur bindjen e tij se edhe veriu i

vendit do të integrohet dhe problemet atje do të kalohen, mirëpo sipas tij për këtë duhet të punohet më shumë dhe gjithnjë në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare.

Ai ka deklaruar se misionit të UNMIK-ut i ka kaluar koha dhe ka shprehur bindjen e tij se duhet të ndryshohet Rezoluta 1244. Gjithashtu ka treguar për raportet e institucioneve të Kosovës me misionin evropian të EULEX-it. Në fund ka dhënë edhe një mesazh për qytetarët e Kosovës. Për më shumë flet për revistën "Paqja", presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu.

**PAQJA:** *Z. Sejdiu është paralajmëruar se do të ketë shumë njohje për Kosovën pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por ato po vijnë shumë ngadalë. Cili është komenti juaj për këtë?*

**Sejdiu:** Asnjëherë njohjet nuk i kam lidhur as me kohën, as me numrin. Për këtë jam shumë i qartë. Flas për procesin. Do të ketë njohje, por cili do të jetë numri dhe kur do të ndodhin këto njohje, nuk mund të them, sepse është çështje ekskluzive e secilit shtet sovran që ta zgjedhë kohën e vet për veprim. Me rëndësi është se kemi premtime të mira. Besoj se do të ndodhin njohje.

**PAQJA:** *Kur pritet që në një të ardhme të afërt të kemi njohje?*

**Sejdiu:** Ka premtime të mira prej shumë shtetesh jo vetëm prej një shteti. Nuk mund të them saktësisht se kur do të ndodhë një gjë e tillë, sepse është çështje e vendimit të vet atyre shteteve që do ta njohin Republikën e Kosovës. Secili shtet i bën analizat e brendshme dhe e gjen momentin e vet në kuadër të politikave të tij.



**PAQJA: A i ka stagnuar njohjet projekt-rezoluta serbe në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së?**

**Sejdiu:** Nuk dua të hyj në psikikën e vendeve. Është përpjekje e Serbisë të bëjë edhe një herë një diversion në kuadër të shteteve të OKB-së, por jam shumë i bindur se nuk do t'ia arrijë qëllimit. Mund të jenë disa elemente përkohësisht të papërshtatshme, që nuk ka një rrjedhje të drejtpërdrejtë me njohjet, por arsye e kësaj është se shumica e vendeve janë në pushimet e verës. Ka një pjesë të vendeve që praktikisht, sidomos ato të Konferencës Islamike, këtë muaj kanë edhe festë shtetërore.

**PAQJA: Z. Presidenti jeni edhe me profesion jurist. A mendoni se duhet të ndryshohet Rezoluta 1244, kur dihet se një gjë të tillë e ka kërkuar edhe Ministri i Jashtëm Skënder Hyseni?**

**Sejdiu:** Ne kemi konsulta të nevojshme për çdo prezantim të Kosovës, edhe për seanca të rëndësishme, siç ka qenë ajo e Këshillit të Sigurimit. Është prezantuar qëndrimi ynë se

suksesshme dhe, natyrisht, si mision i tillë kjo rezolutë është përmbushur. Kërkesa është shtruar jo vetëm për ta larë gojën, por për të dhënë sinjale se ne kemi ndërtuar një realitet pozitiv në Kosovë, se Kosova është e njohur ndërkombëtarisht nga shumë vende, se Gjykata Ndërkombëtare ka dhënë mendimin e vet pozitiv për gjithë atë që është kërkuar të sqarohet rreth veprimeve tona si vend. Tash është koha që Këshilli i Sigurimit të marrë një qasje tjetër të re dhe të heqë nga fuqia një dokument i cili e ka pasur efektin e vet pozitiv, absolutisht për kohën. Dhe në këtë kuadër nuk e quaj alogjike, edhe pse e kemi parasysh faktin se mund të ketë ende vende që e kundërshtojnë ndryshimin e Rezolutës 1244. Por, është shumë me rëndësi që institucionet e Kosovës e kanë kërkuar ndryshimin e kësaj rezolute.

**PAQJA: A besoni se institucionet e Kosovës do të mund ta bëjnë këtë?**

**Sejdiu:** Gjërat në Kosovë janë duke lëvizur pozitivisht. Të gjithë miqtë e Kosovës i kanë parasysh këto lëvizje pozitive, kështu që ne do të sigurojmë një numër të mjaftueshëm të vendeve anëtare të OKB-së për ta njohur Republikën e Kosovës. Pastaj proceset do të përshpejtohen.

**PAQJA: Priten bisedime teknike me shtetin e Serbisë, sa janë të përgatitura institucionet e Kosovës për një gjë të tillë?**

**Sejdiu:** Kosova është bërë e pavarur më 17 shkurt 2008. Është njohur nga shumë vende. Në fuqizim të tërë kësaj është mendimi tepër pozitiv i GJND-së. Kosova nuk u ikën asnjëherë bisedimeve me Serbinë, që janë në të mirë të qytetarëve të të dyja vendeve sovrane. Për tema të tilla jemi të gatshëm të bisedojmë me të dhe me çdo shtet tjetër fqinj. Pse mos të bisedohet për lirinë e lëvizjes së qytetarëve? Pse mos të bisedohet për bashkëpunim ekonomik? Pse të mos diskutohet për çështjet energjetike? Për parandalimin e krimit të organizuar? Këto janë tema të nevojshme për të cilat mund të bisedohet, por s'do të bisedohet asnjëherë për çështje të cilat nënkuptojnë hapjen e çështjeve të temave për statusin e Kosovës. Është me rëndësi që zotimet që i kemi dhënë në relacion me projektin e Ahtisaarit, të zbatohen në tërësi. Ka ende vështirësi në pika të caktuara, por ato do të ecin më tutje. Ne nuk e kemi hall çështjen e bisedimeve, as të negociatave në forma të ndryshme. Për ne është me rëndësi se një proces i madh ka përfunduar.

**PAQJA: Z. President, gjendja në veriun e Kosovës a është mjaft e brishtë?**

**Sejdiu:** Them se duhet të punohet më tepër. Duhet punë e institucioneve të vendit, por edhe një angazhim shtesë në mbështetje nga ana e EULEX-it dhe institucioneve ndërkombëtare. Duhet pasur parasysh se në këtë pjesë që njëmbëdhjetë vite nuk është bërë edhe punë shumë. Unë çmoj rezultatet e arritura, por them se është mund të bëhet edhe më tepër.

Unë them se ka qenë një mandat ndërkombëtar atje dhe këtë e dini shumë mirë. Nuk është koha tash t'i vajtojme momentet e shkuara, por dihet shumë



mirë qenë për-deci-ndërkombëtar të Bashkuara, dhe ndërkohë kemi një mbështetje nga ana e EULEX-it, i cili i mbështet institucionet e Kosovës për sundim të ligjit dhe të sigurisë, që realisht në veri mund të themi se është tepër e nevojshme që të bëhet më shumë.

**PAQJA: Nëse mungon zgjedhja politike atje, si do të vepronet më tutje?**

**Sejdiu:** Politika është koncept i përgjithshëm i të gjitha veprimeve të nevojshme që duhet t'i bëjë një shtet. Politika s'duhet të bëhet vetëm në Kuvend. Në kuadër të kësaj politike asnjëherë nuk kemi paraparë idenë ose vizionin e dhunës kundër qytetarëve, pavarësisht se kush mund të jenë ata, por kemi paraparë sundimin dhe zbatimin e ligjit. Zbatimi i ligjit kërkon edhe masa konkrete ndaj atyre që kanë rënë ndesh me ligjin. Po kjo asnjëherë s'duhet të kuptohet si pjesë e ndjenjës ose e dëshirës.

Progresi në veri nuk duhet të ndalet. Elemente të rëndësishme deri tash janë bërë, sidomos me praninë e Policisë së Kosovës, hapjen e Zyrës Civile si dhe me kthimin gradual të qytetarëve nëpër shtëpitë e tyre. Megjithatë, në veri duhet veprim më urgjent dhe mbështetje ndërkombëtare.

**PAQJA: Kohëve të fundit ka pasur edhe deklarata të ndryshme për autonomi për serbët e veriut. Cili është koment i juaj?**

**Sejdiu:** Ne kemi politikën shtetërore të Kosovës, që është kryesisht zbatimi i projektit Ahtisaari, zbatimi i plotë i Kushtetutës dhe i ligjeve të Kosovës. Ide mund të ketë, mund të bisedohen në forma të ndryshme dhe njerëzit kanë të drejtë të flasën, por institucionet e Kosovës s'mund të merren me spekulime. Tiroli dhe çfarëdo varianti tjetër është i papranueshëm. Ide të tilla janë

shtuar edhe gjatë negociatave për statusin, që për delegacionin e Kosovës kanë qenë të papranueshme. Të papranueshme janë edhe sot.

**PAQJA: Z. President në Kosovë pas UNMIK-ut kemi një mision tjetër ndërkombëtarë atë të EULEX-it. Si shihet roli i këtij misioni pas opinionit të GjND-së?**

**Sejdiu:** EULEX-i ka ndërmarrë veprime inkurajuese dhe të mira, por ka hapësirë për të punuar më shumë. S'do të dëshiroja që EULEX-i të mbetet peng i vendimeve të pesë shteteve anëtare të BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Kosova e pavarur dhe e njohur ndërkombëtarisht është realitet. Kosovën e pavarur e kanë njohur 22 vende të BE-së, të cilat e përbëjnë strukturën themelore të EULEX-it. Prandaj dëshirojmë mbështetje në këtë frymë, në zbatimin e ligjeve të Kosovës, në zbatimin e Kushtetutës së Republikës, por edhe në kuadër të mandatit që kanë marrë me dokumentin e rëndësishëm të 4 shkurtit të 2008-s.

**PAQJA: Z. President, duke parë këtë përmbushje, a mendoni se i ka ardhur fundi pavarësisë së mbikëqyrur?**

**Sejdiu:** Kosova është e pavarur. Të tillë e kanë njohur shumë shtete. Këtë s'do ta quaja si pjesë të mbikëqyrjes në këtë etapë, por do ta quaja pjesë mbështetëse në proceset e rëndësishme që po kapërcen Kosova. Dhe, natyrisht, do të vijë koha që të mos konsiderohet as tip i pavarësisë së mbikëqyrur. Bile, tash, i bëj opionencë

for-mulës që ju e nxirrni: çdo shtet që e ka njohur Kosovën, e ka njohur si shtet të pavarur, sovran dhe integral.

**PAQJA: Z. President, cili do të ishte mesazhi juaj për qytetarët e Republikës së Kosovës?**

**Sejdiu:** Shpreh konsideratën time për angazhimet e secilit qytetar të Kosovës, në punët që kanë. Kemi halle shumë dhe them se është një përballje e nevojshme edhe emergjente. Sidomos në aspektet sociale, kemi një shifër të madhe të papu-

nëve. Është borxhi ynë që të bëjmë komunikime edhe me vendet e tjera, që të sigurojmë mundësi të punësimit për qytetarët. I falënderoj gjithë qytetarët për mirëkuptimet e përgjithshme që po na bëjnë sepse nuk është e lehtë një gjë e tillë. ■





Në Prishtinë shumica e institucioneve mbajnë rrethoja të hekurta

# INSTITUCIONE ME GRILA

Shumë prej institucioneve që janë të vendosura në Prishtinës janë të rrethuara me rrethoja të hekurta. Zyrtarë të komunës së Prishtinës thonë se këto institucione nuk e kanë përfillur kërkesën për largimin e tyre. Ndërkaq, sipas një raporti të institutit për politika të avancuara GAP, janë rreth 30 institucione me rrethoja

## Fatos SHALA

**G**ati secili institucion qeveritar dhe komunal në Prishtinë është i rrethuar me rrethoja të hekurta tash e dhjetë vjet. Zyrtarë të komunës së Prishtinës kanë thënë se ka pasur kërkesa për largimin e këtyre rrethojave, por thonë se nuk janë përfillur kërkesat e tyre. Megjithatë, ata kanë thënë se brenda këtij muaji do t'u dërgohet edhe nga një shkresë për këtë çështje. Ndërkaq, sipas një raporti të institutit për politika të avancuara GAP, janë rreth 30 institucione që nuk e kanë përfillur kërkesën e komunës për largimin e rrethojave. Në anën tjetër arkitektët thonë se këto rrethoja po duken si grila të burgut.

## Mungon vullneti

Muhamet Gashi, zyrtar për informim në Komunën e Prishtinës, ka thënë se mungon vullneti i institucioneve për largimin e këtyre rrethojave.

“Para dy viteve u kemi dërguar nga një shkresë të gjitha institucioneve dhe kemi kërkuar nga to largimin e rrethojave, por deri tani duhet pranuar se ka pasur mungesë vullneti nga këto institucione që t'i largojnë këto rrethoja”, - ka thënë Gashi. Sipas tij, shkresa dërguar institucioneve ka qenë iniciativë e vetë komunës në atë kohë dhe ajo i është përcjellë institucioneve të tjera. Ai, po ashtu, ka thënë se komuna brenda këtij muaji do të dërgojë edhe nga një shkresë në adresë të të gjitha institucioneve në Prishtinë, ku do

të kërkohet largimi i rrethojave. Ndërkaq në një raport të institutit për politika të avancuara GAP, është evidencuar se vetëm Ministria e Shërbimeve Publike, komuna e Prishtinës dhe pjesërisht Ministria e Kulturës kanë larguar rrethojat përreth objekteve institucionale. Po ashtu, sipas këtij raporti, janë rreth 30 institucione, të cilat nuk e kanë përfillur kërkesën e komunës së Prishtinës për t'i larguar rrethojat. Në anën tjetër, arkitekti Naim Haxholli ka thënë se këto rrethoja e shëmtojnë pamjen e qytetit dhe dërgojnë një mesazh të keq te njerëzit që vizitojnë Prishtinën. “Këto rrethoja duhet të largohen gjithqysh nga institucionet. Ato janë shumë të larta dhe duken sikur me qenë grila të burgut. Po ashtu, këto rrethoja dërgojnë edhe mesazh të keq te vizitorët që vijnë në Prishtinë”, - ka përfunduar Haxholli. ■



## 30 institucione me rrethoja

Gjykata Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, Qendra Sportive ‘1 tetori’, Ombudspersoni i Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Muzeu i Kosovës, Gjykata e qarkut, ish-objekti kryesor i UNMIK-ut, Banka Qendrore e Kosovës, “Hortikultura”, objekti i UNHCR-ës ICO-ja, objekti i UNDP-së, një pjesë e Pallatit të Rinisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, objekti i departamentit të punës dhe i punësimit, i NPM-së, objekti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ndërtesa e Komisionit Evropian, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Banka Botërore, Zyra e Shërbimit Doganore (lagja “Pejton”), etj.



# Përvjetori i 11-të për 1840 plagët e hapura të Kosovës

**Astrit VELIQUI**

**D**ita Ndërkombëtare e të Pagjeturve u shënuar edhe në Kosovë me një sërë aktivitete. Kjo ditë e ne ka marrë një dimension të veçantë, ngase Kosova edhe 11 vjet pas lufte, akoma pret zbardhjen e fatit të shumë qytetarëve të saj. Siç dihet ende nuk dihet asgjë për fatin e rreth dy mijë qytetarëve të Kosovës, të cilët u rrëmbyen me forcë nga ushtria dhe paramilitarët serbë gjatë luftës së viteve 1998-99.

“Duhet përdorur të gjitha mjetet e nevojshme për t’i trajtuar paqartësitë juridike, sociale dhe emocionale të familjeve të personave të pagjetur, prandaj e nxis legjislaturën që të miratojë një ligj për personat e pagjetur, për të fuqizuar mbështetjen ndaj anëtarëve të familjeve dhe përpjekjeve të tyre për të ndërtuar sërish jetën”, - ka theksuar me këtë rast Piter Feith, shef i ICO-së në Kosovë.

Për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Pagjeturve “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut”, në qendër të Prishtinës, organizoi një aksion simbolik për të sensibilizuar opinionin e gjerë në lidhje me këtë problem që po zvarritet tash e 11 vjet.

**“Nisma e të Rinjve”: Ku janë?**

Simbolika që këta të rinj

kanë paraqitur në këtë ditë më këpucë fëmijësh, grash, pleqsh e burrash, me nga një pikëpyetje sipër të vendosura në Sheshin “Nëna Terezë”, pasqyrojnë rritjen e ndërgjegjes humane për problemin e të pagjeturve në Kosovë.

Koordinatori i kësaj nisme Besart Lumi tha se aksioni ynë ka për simbolikë t’i japë karakterin njerëzor çështjes së të pagjeturve, sepse shumë shpesh ata po konsiderohen vetëm si një numër, ndërkaq duhet pasur parasysh se ata, para së gjithash, janë njerëz dhe pjesë e kësaj shoqërie.

“Ne, përmes një numri shumë të madh të këpucëve, që simbolizojnë numrin e madh të viktimave dhe personave të pagjetur, kemi dashur ta japim këtë karakter human atyre”, - ka thënë Lumi.

Po në këtë ditë, autoritetet e Prishtinës kanë kërkuar nga Beogradi që të japë informacione për 1840 personat që ende figurojnë në listën e të pagjeturve.

**Gjetaj: Beogradi mban peng fatin e të pagjeturve**

Kreu i Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit, Prenkë Gjetaj, është i bindur se qeveria serbe i ka të gjitha informacionet për vendndodhjen e kufomave ose mbetjeve mortore.

Ai tha se aktualisht po bëhen hetime për varrezën masive në Rashkë të Serbisë, ku dyshohet të jenë varrosur 250 – 300 shqiptarë të Kosovës.

Por, sipas tij, Prishtina dyshon edhe për disa varreza të tjera në Serbi.

Edhe Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Pagjeturve, ka thënë se Beogradi duhet të heqë dorë nga obstrukcionet dhe të ndihmojë zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Kurse me rastin e kësaj dite, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar ditë më parë ka kritikuar të gjitha qeveritë e vendeve të ish-Jugosllavisë se nuk po bëjnë sa duhet për të zbardhur fatin e më se 15 mijë personave të vrarë në luftërat e viteve 90.

Në Bosnjë sot llogariten 10.500 persona të pagjetur, në Kroaci 2.392 dhe në Kosovë 1.839.

Po në këtë ditë, familjarët e të pagjeturve për të rritur ndërgjegjen si institucionale, ashtu edhe ndërkombëtare, i kanë ndërruar fotografitë e shumta të personave të pagjetur që janë përballë Kuvendit të Kosovës tash e sa vite. ■



PËRREPËRIM BUBLAKU

**N**ë QKUK gjenden nëntë pacientë me koma vigjile. Shumica e këtyre janë në këtë gjendje tani e shtatë vite. Zyrtarët e QKUK-së kanë kërkuar nga ministria e Shëndetësisë të bëhet një zgjidhje për ta. E zyrtarët e Shëndetësisë thonë se nuk kanë mundësi të bëjnë me shumë

**N**ë Qendrën Klinike Universitare, përkatësisht në repartin e anesteziologjisë, për mjekim post-intensiv gjenden nëntë pacientë me koma vigjile. Në mungesë të qendrave rehabilituese, këta pacientë qëndrojnë në këtë klinikë, edhe pse nuk e kanë vendin aty, -thotë Nehat Baftiu, shef në klinikën e anesteziologjisë. "Pacientët me koma vigjile kanë mbetur në repartin anesteziologjisë që nga viti 1999. Realisht, këta pacientë duhet të trajtohen në qendra rehabilituese, sepse vendin e kemi shumë të kufizuar. Me këtë problematikë nuk është marrë as Ministria e Shëndetësisë, e as qendrat e tjera që janë të thirrura për këtë problem", - i ka thënë revistës "Paqja" Baftiu. Por, Faik Hoti, zyrtar në Ministrinë e Shëndetësisë, thotë se në vendet me mundësi të mira financimi, pacientët e tillë i mbajnë në qendra rehabilitimi, ndërsa Kosova nuk e ka këtë mundësi.

### Shtatë vjet në gjendje kome

Nehat Baftiu shton se në këtë repart ka pacientë në gjendje kome që janë të shtrirë qe shtatë vjet. Dhe sipas Baftiut, ekipi kujdeset intensivisht për ta. "Meqë familjarët nuk kanë ku t'i çojnë, ne nuk mund t'i hedhim në rrugë pacientët tanë dhe i mbajmë derisa të zgjohen ose të vdesin këtu në klinikë", - shpjegon Baftiu. Ai shtoi se kanë bërë kërkesë të MSH-ja që të gjejë një zgjidhje. Faik Hoti, zyrtar në Ministrinë e Shëndetësisë, thotë se Kosova nuk ka shumë mundësi për këta pacientë. Hoti shtoi se sa i përket mbulimit të shpenzimeve për këta pacientë, Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndonjë projekt që do të mund t'i mbulonte ato, pa hyrjen në fuqi të ligjit të punës dhe atij të sigurimeve shëndetësore. "Në QKUK janë më pak se 10 raste. Me hyrjen në fuqi të disa ligjeve, si ai i punës dhe i sigurimeve shëndetësore, shpresoj që statusi i pacientëve në gjendje kome do të rregullohet dhe do të mbulohen shpenzimet e tyre, sepse tash për tash, ministria nuk ka ndonjë projekt që do të mund t'i mbulonte shpenzimet e këtyre pacientëve", - shpjegoi Hoti. Ai, po ashtu, ka thënë se Ministria e Shëndetësisë u ka kërkuar drejtorëve të spitaleve rajonale që t'i marrin pacientët nga rajonet e tyre që janë në QKUK dhe t'i transferojnë në spitalet rajonale, varësisht prej cilit rajon janë ata. Disa spitale veç kanë filluar të bëjnë transferimin e pacientëve, si për shembull spitali i Prizrenit e ka bërë këtë, dhe Ministria pret që kështu të veprojnë edhe spitalet e tjera, ashtu që mjekimit intensiv dhe i anesteziologjisë në QKUK, t'i krijohet më shumë hapësirë për punë", - theksuar Hoti. qoftë, e vetmja gjë tën, këtyre pacientëve nuk u mungon, janë barnat. Udhëheqësit e Qendrës Klinike thonë se gjendja në këtë drejtim është përmirësuar, në krahasim me vitin e kaluar. ■

S'KA ZGJIDHJE PËR PACIENTËT NË KOMA



Qëndrime të ndryshme mes pozitës dhe opozitës për rritjen ekonomike

# Rritja ekonomike deri në 5 për qind

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, ka thënë se transferimi i ndërmarrjeve publike në sektorin privat, përmirësimet në rajon dhe në botë do të ndikojnë edhe në rritjen ekonomike të Kosovës

## Lulzim AHMETI

Vendet në tranzicion, si rasti i Kosovës, kanë nevojë për rritje shumë më të madhe ekonomike për shkak se përpallen me shumë mangësi buxhetore, të cilat gjenerojnë papunësi dhe varfëri. Shteti më i ri në botë, Kosova, nuk po arrin të ketë rritje të kënaqshme ekonomike, edhe pse një gjë e tillë po tentohet nëpërmjet tërheqjes së investimeve të huaja.

Këtë vit, sipas zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, do të kemi rritje deri në 5 për qind, e këto shifra kontestohen nga opozita, pasi që sipas tyre janë të “fryra”. Ata thonë se Kosova do të shënojë rritje ekonomike deri në mbi 4 për qind.

### Shala: Në 3 vitet e ardhshme, rritja GDP-së do të jetë 5.5 deri në 6 për qind

Ministri i Ekonomisë dhe Financave (MEF), Ahmet Shala tha se ata, sipas shifrave që disponojnë, parashikojnë që Kosova të shënojë një rritje ekonomike deri në 5 për qind.

“Qasja më konservative që kemi pasur në të gjitha shifrat konfirmojnë se rritja ekonomike do të jetë rreth 5%, edhe pse ne besojmë se mund të jetë më e madhe, por le të themi se kjo do të jetë një shifër e dëshirueshme edhe pse jo që plotëson dëshirat tona, por është arritje e mundshme në këtë situatë, kur i gjithë rajoni është rreth zeros, përveç Shqipërisë”, - thekson ai. Sipas ministrit të MEF-it, Ahmet Shala, të gjitha shtetet në regjion janë në minus, Kosova megjithatë ka siguruar që të ketë një rritje ekonomike prej 5 për qind. “Në 3 vitet e ardhshme, mesatarja e rritjes së GDP-së do të jetë rreth 5.5 deri në 6 për qind, që është një shifër mjaft për t’u dëshiruar”, - ka thënë Shala. Sipas ministrit Shala, Kosova ka nevojë për një rritje shumë më të madhe të ekonomisë se sa 5 për qind, por për t’i arritur ato qëllime duhet më shumë kohë. “Transferimi i ndërmarrjeve publike në sektorin privat në përgjithësi dhe një dinamizëm i mirë i gjithë rrethit ekonomik, në rajon apo në botë, sepse tërë

globi ka filluar të këndellet, do të ndikojnë edhe në Kosovë dhe jam mjaft optimist për këtë”, - tha numri një i MEF-it, Ahmet Shala.

### Selmani: Rritja nuk mund të jetë më shumë se 4 për qind

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Buxhet, Ekonomi dhe Financa, Myzejene Selmani, nga radhët e AKR-së, ka thënë se rritja, e cila pretendohet nga MEF-i, prej 5 për qind nuk është reale. Sipas Selmanit, Kosova mund të ketë rritje ekonomike prej 4 për qind, për shkak të trendeve të tjera të cilat janë negative.

“Rritja e GDP-së është falë investimeve kapitale, të cilat janë bërë nga buxheti i Kosovës dhe dihet se investimet e huaja kanë rënë dhe Kosova është ranguar në vendin e 136 për ambient të investimeve. Rritja më shumë se 4 për qind nuk mund të jetë as këtë vit, sepse nuk ka as eksport dhe dihet se numri i papunësisë është tejet i lartë”, - ka thënë Myzejene Selmani.

### Musa: Me këtë trend të rritjes ekonomike nuk ka perspektivë

Drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovës (OEAK), Lekë Musa, ka thënë se edhe pse ka rritje të inves-



timeve të huaja, kjo është e pakët për të gjeneruar rritje të kënaqshme ekonomike, e cila është tepër e nevojshme. “Kosova ka diku 6 për qind të BPV-së mesatare të BE-së për kokë banori dhe në vitin 2009 kjo madje ka rënë edhe më shumë. Sipas memorandumit ekonomik të Bankës Botërore, ne duhet ta dyfishojmë rritjen ekonomike dhe ta mbajmë atë për dhjetë vite, që të arrijmë vendet e rajonit”, - tha ai. Sipas Musës, me këtë trend, ku e tërë ekonomia varet prej ndihmave të huaj dhe dërgesave nga jashtë, nuk ka perspektivë dhe teori për të arritur këtë rritje të kënaqshme ekonomike.

Ndërkaq, Artan Nimani, profesor universitar, ka thënë se Ministria e Ekonomisë dhe Financave e ka rishikuar në 4.8 për qind normën reale të BPV për vitin 2010, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në Eurozonë si dhe kornizën e rishikuar fiskale. “Rritja mesatare reale e BPV-së gjatë viteve 2010-2013 pritet të jetë 5.4 për qind, me nivelin më të lartë të rritjes prej 6.1 për qind gjatë vitit 2011. Kjo nuk është diçka jo e mirë, por për gjendjen aktuale nuk është e mjaftueshme”, tha Nimani. Shenjë pozitive sipas tij, është se inflacioni i Indeksit të Çmimit të Konsumit, është vlerësuar të jetë 1.8 për qind përgjatë vitit 2010. “Ky inflacion mundëson dhe stimulon investitorët, sepse stabiliteti ekonomik është i qëndrueshëm dhe krijon premisa të mira për të ardhmen afatgjatë”, - ka theksuar Nimani. Qeveria e Kosovës, sipas tij, duhet t’i intensifikojë kryesisht përpjekjet për thithjen e investimeve të huaja, të jetë më azhure në projektet e mëdha ekonomike, si energjetika dhe privatizimi i drejtë i pjesës së mbetur dhe ndërtimi i një partneriteti të mirëfilltë publiko privat. “Një fokus i veçantë duhet drejtuar nga investimet dhe krijimi i kushteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e veçmas atyre të agrobiznesit. Subvencionimi i sektorit agrar është shtyllë kyçe”, - tha ai duke shtuar se Kosova nuk ka kapacitete për krijimin e fabrikave për t’i bërë konkurrencë “Mercedes”-it ose “Fiat”-i, por specat dhe domatet mund të konkurrojnë edhe në Itali e Gjermani. ■



# MËSIMDHËNËSIT MBESIN PEZULL

**Dritë SLIVOVA**

**S**ado që u premtua që procesi i ngritjes së pagave për mësimdhënësit nuk do të shkojë gjatë, deri tash nuk ka asgjë konkrete. Pagat nuk u ngritën në shtator të këtij viti ashtu siç ishte premtuar, dhe ky rast u mbet të zgjidhej tek në janar të vitit 2011. Në shenjë pakënaqësie një pjesë e institucioneve shkollore të Kosovës ditën e parë e bojkotuan mësimin. Ndërsa ata që mbetën më së keqi ishin fëmijët e vegjël të cilët shikonin moshatarët e shkollave tjera teksa po shkonin në shkollë. Prindër të nxënësve në shkollën fillore “Hasan Prishtina”, shprehën pakënaqësitë e tyre lidhur me këtë ndodhi. Ata nuk i fajësuan mësuesit por fajësuan institucionet, të cilat në njëfarë mënyre sipas tyre, po luajnë me durimin e mësimdhënësve. “Më erdhi shumë keq që vajza ime, e cila ishte dashur të fillojë klasën e parë nuk pati mundësi ta përjetonte këtë gëzim pasi që shkolla nuk i hapi dyert për të. Unë e kuptoj dhe e çmoj kërkesën që mësimdhënësit po bëjnë për ngritjen e pagave pasi që puna, të cilët ata e bëjnë nuk është as e vogël po as e lehtë”, - ka thënë Ali Zogu prindi i Ardites e cila tashmë është regjistruar në klasë të parë.

## **Bisedat pa rezultat**

Ali Shabanaj, kryetari i Sindikatës së Bashkuar

të Arsimit Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), ndonëse është shprehur se sindikata e tij ka raporte të mira me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), si dhe me qeverinë e Kosovës, ai prapëseprapë ka kërkuar që pagat për mësimdhënësit të rriten, sepse sipas tij, vlera e mësimdhënësve është shumë më e madhe sesa pagat me të cilat ata vlerësohen. “Kujtojmë se është koha që MASHT-i dhe Qeveria, së bashku me ne si partnerë socialë, të punojnë në krijimin e kushteve dhe mundësive për lëvizje progresive të pagave në sistemin e arsimit publik në Kosovë. Ne do të kërkojmë një ngritje të pagave sa më cilësore, në mënyrë që t’u krijohen mundësi më të mira financiare punëtorëve të arsimit”, - është shprehur kryetari i SBASHK-ut, Ali Shabanaj.

## **Ngritje e mirëfilltë**

Ndërkaq, ministri i Arsimit Enver Hoxhaj, ka thënë se ekziston një premtim i prerë i kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, që pagat do rriten. Edhe pse më herët kishte thënë që ky premtim do të realizohet në shtator, tashmë doli që do të ndodhë në janar të vitit të ardhshëm. “Reforma e sistemit të pagave dhe reforma e përgatitjes profesionale të mësimdhënësve që ne e kemi filluar në 2008, do të vazhdojë edhe më tutje”, është shprehur ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj. ■

Edhe në konkursin e sivjetmë për regjistrimin e studentëve të rinj në Universitetin e Prishtinës, numri më i madh i të interesuarve ishte për Fakultetin Ekonomik. Aplikimi i 5-6 mijë të rinjve në këtë fakultet, tash e disa vjet, është bërë traditë. Edhe pse asnjë nga studentët e anketuar nuk ka arritur të gjejë punë ose të paktën punë praktike, ata mendojnë se është fakulteti më shpresëdhënës për punë. Kjo ka bërë që disa nga fakultetet e tjera të UP-së gati të injorohen, duke mos aplikuar më shumë se 20-30 kandidatë. Mirëpo, sociologu Fadil Maloku shprehet se mendimi se disa fakultete nuk kanë perspektivë është më tepër një paragjykim i të rinjve

## FAKULTETI EKONOMIK “VËRSHOHET” NGA STUDENTËT

**Drita VITIA**

**Q**indra mijëra të rinj e maturantë, edhe këtë vit akademik, ia mësynë Fakultetin Ekonomik. Si në afatin e parë ashtu edhe në afatin e dytë të konkursit për regjistrimin e studentëve të rinj në Universitetin e Prishtinës, bën përshtypje fakti se në Prishtinë ekziston vetëm një fakultet, ai ekonomik. Shumica nuk kanë madje arsye për të konkurruar në ndonjë drejtim të ekonomikut, por shprehen se ndoshta gjejnë punë. Një nga studentët, i cili shpreson se me Fakultet Ekonomik do të gjejë punë pas diplomimit, është Ibrahim Feta. Ai tani është në vitin e dytë të studimeve në këtë fakultet dhe shprehet se këtu qëndron perspektiva. “Ekonomikun e kam zgjedhur për shkak se kam parë perspektivë më të madhe për punë dhe më pëlqen si fushë”, - theksoi Ibrahim, duke këmbëngulur se do të gjejë punë menjëherë pasi ta përfundojë fakultetin, edhe pse tash e dy vjet ai nuk ka pasur mundësi të kryejë ndonjë punë praktike në këtë fushë. “Deri më tani nuk kam pasur mundësi të punësohem askund, as për punë praktike, as me kontratë. Nuk e di nëse do të mund të punësohem diku në drejtimin që studioj, por shpresoj ta përfundoj një herë fakultetin dhe pastaj e shohim”, - u

shpreh Ibrahim duke mos e fshehur dëshirën që të bëhet kontabilist.

Ekonomiku - fakulteti i perspektivës

Edhe kolegu i Ibrahimit, Visar Ramadani, i cili tashmë është regjistruar në vitin e parë të studimeve në Fakultetin Ekonomik, në drejtimin e Marketingut, mendon se ky fakultet ka perspektivë dhe beson se do të ketë mundësi të punësohet në të ardhmen. Visari, edhe pse ende nuk i ka filluar ligjëratat në këtë fakultet, thotë se me këtë drejtim sheh më shumë mundësi për punësim. “Jam regjistruar në ekonomik sepse kam parë më shumë perspektivë për punësim. Ma merr mendja që është drejtim i mirë”, - shprehet Visari me krenari për drejtimin e Marketingut që ai ka zgjedhur. Ai, madje, ka ide të qartë se çka do të punojë në të ardhmen. “Pas diplomimit shpresoj të marr pjesë në ndonjë organizatë ose institucion të marketingut, të reklamave etj.”

Fakultet i perspektivës apo i paragjykitit?!

Megjithatë, jo të gjithë e konsiderojnë Fakultetin Ekonomik si fakultet të perspektivës ose “të fatit” për punë. Analisti dhe sociologu, Fadil Maloku, perspektivën ose mundësinë e punësimit të studentëve me Fakultet Ekonomik e sheh më shumë si paragjykim nga ta. Maloku, rritjen e numrit të të interesuarve për të studi-

uar jo vetëm në ekonomik, por në të gjitha fakultetet e Universitetit të Prishtinës edhe më gjerë, e sheh si një rritje të paplanifikuar dhe jo në përputhje me kërkesën e tregut. “Jo vetëm në Fakultet Ekonomik, por edhe në fakultetet e tjera është evidente një rritje enorme e numrit të studentëve që kujtoj se është pa ndonjë planifikim paraprak, në kuptimin e ndonjë studimi për nevojat e vërteta të tregut të punës në Kosovë”, - shprehet Maloku. Sipas tij, fluksi shumë i madh në Fakultetin Ekonomik dhe interesimi shumë i vogël për fakultetet e tjera, si Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, ose Fakultetin e Bujqësisë, më shumë ka të bëjë me paragjykimin e studentëve sesa me ndonjë arsye të qëndrueshme. “Fluksi ka të bëjë më shumë, për mendimin tim, me paragjykimet e studentëve për Fakultetin e Xehetarisë ose atë të Bujqësisë, si fakultete që nuk premtojnë perspektivë, por njëherësh edhe si fakultete që në shoqërinë tonë nuk kanë ndonjë status a prestigj as social, e as ekonomik, gjë që është një precedent i llojit të vet, duke marrë parasysh nevojat dhe perspektivën për këto degë në Kosovë”, - shprehet sociologu Fadil Maloku. Sipas tij, paragjykimet se Fakulteti i Xehetarisë ose ai i Bujqësisë nuk kanë ndonjë status social a ekonomik, ka të bëjë edhe me mbylljen e minierave dhe pa perspektivën e shprehur edhe haptas ndaj profesioneve bujqësore, e cila sipas Malokut ka bërë që situata e tillë të paragjykohet dhe numri i studentëve të zvogëlohet deri në mbijetim. Ndërkohë, mundësinë e punësimit më të shpejtë dhe më të lehtë të të rinjve me këtë fakultet, Maloku e ka quajtur një paragjykim pozitiv siç është shprehur ai.

Ekonomiku mbledh 5 mijë studentë për një afat



Në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, me qendër në Prishtinë, qysh në afatin e parë të regjistrimit është mbushur numri i të kërkuarve me konkurs. Në të dy qendrat e këtij fakulteti, në Prishtinë dhe në Gjilan, vetëm në afatin e parë të regjistrimit kishin aplikuar mbi 5 mijë kandidatë, të cilët kanë pretenduar që të bëhen fillestarë. Në Prishtinë ishin plotësuar të gjitha vendet e parapa me konkurs për studimet e rregullta, ndërsa në qendrën tjetër, në Gjilan, kishin mbetur mbi 40% vende të lira, aplikimi për të cilat ka filluar tani. Ndërkohë, në UP ka edhe fakultete ku nuk ka numër të aplikuesve as aq sa kërkohen me konkurs. Në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore (FSHMN), me konkurs është pranohet 1505 studentë të rinj, kurse kanë aplikuar vetëm 30 % e kandidatëve nga numri i përgjithshëm. Kurse për afatin e dytë në këtë fakultet kanë mbetur edhe 1317 vende të lira. ■

# REFORMIMI I SISTEMIT GJYQËSOR

Shoqërinë kosovare po e presin reforma thuajse në të gjitha sferat institucionale, por reformat me hapa të shpejtë duhen filluar, vazhduar dhe përfunduar në sferën e ekonomisë, shëndetësisë, arsimit e sidomos në sferën e sistemit gjyqësor, sepse këto janë parakushtet për integrimin në Bashkimin Evropian

**Flamur HYSENI**

**N**dryshimet themelore që duhet të bëhen në sferën e sistemit gjyqësor janë kërkesat më të shpeshta, si nga vetë shoqëria kosovare, po ashtu edhe nga institucionet ndërkombëtare. Këto kërkesa, siç po duket, janë mjaft të vështira për t'u përmbushur nga institucionet kosovare, sepse siç dihet të fillosh reformat në një sferë të caktuar është një punë mjaft e vështirë dhe e ndjeshme, e cila kalon nëpër një proces të vështirë, e sidomos kur është fjala për sistemin gjyqësor, madje një mendimtar i njohur thotë se "reformat janë të dhimbshme". Reformat në sistemin gjyqësor duhet të vazhdojnë me një përkushtim sa më të madh dhe me një seriozitet të lartë, sepse pa reformimin e mirëfilltë të sistemit gjyqësor nuk do të ketë as reformim të mirë në sistemin ekonomik dhe atë politik të vendit.

Shikuar nga këndvështrimi i organizimit të brendshëm shtetëror të Republikës së Kosovës, i funksionimit të institucioneve në mënyrë të mirëfilltë dhe mundësisë së kryerjes së shërbimeve ndaj qytetarëve/shtetasve, del se pakënaqësitë më të mëdha janë të adresuara ndaj sistemi gjyqësor, për arsye se pikërisht në sistemin gjyqësor, i cili përfshin të gjitha instancat e gjykatave, prokurorive, po ashtu edhe avokaturën, janë duke u shkelur të drejtat elementare të qytetarëve (shtetasve). Këtu shpesh kemi vonesa të panevojshme dhe të paarsyeshme të proceseve gjyqësore, injorime nga më të ndryshmet, si nga ana e gjyqtarëve, prokurorëve, po ashtu edhe nga avokatët. Gjithashtu ka edhe lëshime të mëdha profesionale. Të gjitha këto janë në kundërshtim me atë që thuhet se kanë filluar reformat në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Për ta vërtetuar këtë mjafton të vizitohen gjykatat dhe prokuroritë dhe të shihen raportet e monitorimit të organizatave të ndryshme, sidomos raporti i fundit i BIRN-it mbi monitorimin e sistemit gjyqësor dhe raporti i fundit për progresin i Komisionit Evropian.


Nëse e shikojmë nga këndvështrimi i krahasimit me shtetet përreth nesh se si qëndron

gjendja me sistemin gjyqësor të tyre, del se përsëri sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës është mbrapa në shumë aspekte, sidomos në funksionalitet, efikasitet, profesionalizëm, pozitivitete materiale të punonjësve të sistemit gjyqësor dhe kushte infrastrukturore. Për shembull, Republikës së Shqipërisë i është dashur të investojë më shumë se dhjetë vite rreth sistemit gjyqësor për të arritur një nivel të pranueshëm sipas standardeve të mira ndërkombëtare, por prapëseprapë i mbetet edhe shumë kohë për ta arritur nivelin e kënaqshëm të reformimit total të sistemit gjyqësor, sepse hyrja në BE kërkon një gjyqësor të pavarur totalisht, funksional dhe efikas në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

Është e pamundur të ketë sukses reformimi i sistemit ekonomik, shëndetësor dhe arsimor, nëse nuk kemi një reformim të mirëfilltë të sistemit gjyqësor, sepse atëherë nuk do të ketë zbatueshmëri të ligjeve dhe kur nuk ka zbatueshmëri të ligjeve,

n u k mund t ë k e t ë funksionim të sistemit ekonomik, shëndetësor dhe arsimor... etj, në nivelin që e kërkojnë dardet evropiane.

Nëse institucionet tona nuk nojnë me seriozitet të lartë për t'i përmbushur kërkesat që dalin integritet evropiane, për niveleve dhe të drejtave themelore njeriut, për reformimin e sistemit ekonomik, shëndetësor, arsimor dhe sidomos atij gjyqësor, forcimin e sundimit të ligjit dhe të dalin me rezultate konkrete për arritjen e sukseseve në reformimin e këtyre sistemeve, atëherë vështirë se do t'i bindim institucionet e BE-së për të na



# R I DOMOSDOSHËM PËR INTEGRIM

përkrahur për t'u bërë pjesë e këtij bashkimi të shteteve. BE-ja dhe zyrtarët e lartë të saj, kohëve të fundit, janë në mëdyshje sa i përket politikës së zgjerimit në pjesën juglindore të kontinentit, sepse janë tejet të pakënaqura me zgjerimin e fundit që është bërë, sidomos me aderimin e dy shteteve nga kjo pjesë e kontinentit, Rumanisë dhe Bullgarisë. Që të dyja këto shtete nuk kanë arritur të jenë në hap me shtetet e tjera anëtare, sa i përket luftimit të korrupsionit në administratën shtetërore, krimit të organizuar, keqpërdorimit të buxhetit shtetëror dhe subvencioneve të BE-së, lidhur me forcimin ekonomik dhe sistemit gjyqësor të tyre. Në këtë drejtim, BE-ja ka një praktikë jo të mirë sa i përket anëtarësimit të shteteve nga kjo pjesë e kontinentit.

Nëse këtij skepticizmi të zyrtarëve të lartë të BE-së ia shtojmë edhe atë se çfarë i ofron Kosova aktualisht BE-së dhe çfarë do t'i ofrojë në dhjetë vitet e ardhshme, atëherë rezultati del negativ dhe shumë larg realitetit për të arritur një standard çfarë kërkohet për të qenit anëtar i BE-së. I vetmi shans për momentin, minimalisht, për dhjetë vitet e ardhshme është që Koso-

va mund të jetë anëtare d i s a e i n i m i n N ë n u k

e BE-së me kufizime dhe mbikëqyrje nga institucioneve të BE-së, në reform-dhe forcimin e sistemit gjyqësor. Në të kundërtën, Kosova kurrsesi mundet të jetë as në statusin e kandidatit për anëtarësim në BE. Aq më vështirë bëhet kur kësaj i shtojmë edhe problemin tjetër politik, kur dihet se Kosovën si shtet nuk e kanë njohur ende pesë shtete anëtare të BE-së, të cilat janë duke u përballur me problemet e veta, si politike ashtu edhe ekonomike, si p.sh. Greqia e cila është duke u përballur me një krizë ekonomike dhe financiare.

Institucionet e



Kosovës i presin shumë punë në ditët, muajt dhe vitet në vijim që të fillojnë dhe të vazhdojnë reformat në shumë sfera, e sidomos në atë të sistemit gjyqësor, sepse pa një gjyqësor të reformuar, në aspektin e efikasitetit, funksionalitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë së plotë, vështirë se Kosova do t'ia dalë të jetë anëtar me statusin e kandidatit për anëtarësim në BE. Shoqërinë kosovare po e presin reforma thuajse në të gjitha sferat institucionale, por reformat me hapa të shpejtë duhen filluar, vazhduar dhe përfunduar në sferën e ekonomisë, shëndetësisë, arsimit e sidomos në sferën e sistemit gjyqësor, sepse këto janë parakushtet për integrimin në Bashkimin Evropian. ■

(Autori është Asistent në Katedrën e shkencave Kushtetuese – Administrative, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës)

# Kur maqedonasit shkru

**Iljasa SALIHU**

**G**jatë këtyre ditëve, për të satën herë, sidomos pas enciklopedisë skandaloze, maqedonasit na 'informojnë se jemi ardhacakë e endacakë'. Për të qenë paradoksi edhe më i rrezikshëm, këso informatash u plasohen nxënësve të vitit të dytë të shkollave të mesme, po edhe profesorëve të cilët verbërisht po i kapërcejnë njësitë mësimore. Shtrembërimi i këtyre fakteve, që gjenden në librin e historisë dhe gjeografisë, nuk ka filluar me shfaqjen e enciklopedisë maqedonase, porse ky fenomen shpifës ka qenë i vendosur shumë më herët, qysh në kohën e Ivo Andriqit, pastaj në kohën e Gligorovit, e kështu për afro 19 vite radhazi në këtë shtet problematik, shpifemi e nënçmohemi deri në skajshmëri. Një për të gjitha librat shkollorë, shqiptarët janë trajtuar shkurtazi vetëm atëherë kur është shkruar ose informuar diçka për Republikën e Shqipërisë. Qysh herët na kanë bërë me dije se shqiptar është vetëm ai i cili jeton në shtetin e Shqipërisë, ndërsa këta të tjerët duhet të identifikohen me shtetin ku jetojnë, duke rënë kështu në kurthin e konceptit të shtetit komb. Për fatin tonë të keq, edhe pas një lufte të armatosur dhe pas një marrëveshje që garanton të drejta të barabarta për të gjitha kombësitë, ne ende po mësojmë prej autorëve maqed-

donas. Shqiptarët, nëpër këto libra, janë të inkuadruar vetëm si përkthyes, madje si përkthyes servil, të cilët patën frikë tash e shtatë vite t'i medializojnë një sërë gabimesh të qëllimshme të autorëve maqedonas.

Përderisa shumë albanologë botërorë, autorë librash, po i quajnë dhe po i paraqesin shqiptarët si kombi më i vjetër në Ballkanit, akademikët sllavo-maqedonas garojnë mes tyre se kush po i fyen dhe po i nënçmon më së shumti shqiptarët. Ndërsa dihet mirëfilli se, historikisht, këta që sot trumbetojnë se i përkasin maqedonasve të vjetër, pikërisht këta janë sllavë e bullgarë. Henry Kissinger për ta shprehet: "Sllavët në Maqedoni, të cilët, pothuajse ekskluzivisht janë bullgarë, do t'i ngrënë kërkesat e tyre...". Kjo gjë vërehet edhe në praktikë. Pothuajse të gjithë kanë marrë nënshtetësi dhe pasaporta bullgare, pra, aty ku dhemb dhëmbi shkon edhe gjuha.

Kështu, përskaj gjitha këtyre kundërthënieve dhe kontestimeve, ata nuk lodhen që edhe më tej të artikulojnë vlerë kundrejt shqiptarëve autoktonë. Ky shtet, tanimë nuk mund të karakterizohet me diçka tjetër pos me skandale tejet tendencioze, ku në agjendën e këtyre shfaqjeve, Ministria e Arsimit të Maqedonisë, nuk u lodh fare, me rastin e librit shkollor "Shoqëria", ku Kosova ende paraqitet si pjesë e përbashkët e Serbisë. Në librin "Gjeografia" për vitin e dytë, të autorëve maqedonas pohohet se: "vendosja e paraardhësve, prej ku rrjedh popullsia shqiptare në Maqedoni, ka filluar para 220 vjetëve, gjegjë-

sisht nga fundi i shekullit të XVIII. Në fillim kishte një numër të vogël të tyre. Në shekullin XIX, fillon një valë e re e vendosjes së shqiptarëve në Maqedoni, atëherë janë vendosur numri më i madh i shqiptarëve. Theksojmë se vendosja e re e shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë nuk është proces i mbaruar, ai bëhet edhe sot, në fillim të shekullit të XXI. Vendosja e këtillë, e pakontrolluar, vendosja në mënyra të ndryshme, mund t'i dëmtojë të gjithë në Republikën e Maqedonisë". Në këtë libër gjithashtu shkruhet se, "shqiptarët e Maqedonisë që e llogarisin veten si autoktonë, kryesisht janë popullsi maqedonase që gjatë periudhës së sundimit turk kanë pranuar fenë islame dhe janë shqiptarizuar". Duke mos u ngopur me shpifje dhe nënçmime, autorët e këtij libri edhe më tej kanë shkruar: "Midis tyre, ka edhe ndonjë fis që ka prejardhje turke dhe rome ose çerkeze". Pastaj, libër-shkruesit, kinse nuk e paskan ditur se në Islam është i ndaluar portreti i Muhamedit a.s., lëre që tentuan që përskaj biografisë së Pejgamberit tonë të vendosin edhe portretin e tij, por në vend të këtij maskarallëku, shkuan në një skandal tjetër, duke e paraqitur portretin e Sulltan Nevruzit në biografinë e Muhamedit a.s. Kështu, gjatë këtyre ditëve u zbulua edhe skandali i librit të muzikës, ku fillim e mbarim atij libri i jepet ngjyrë maqedonase dhe ortodokse, marrë parasysh këngët kishtarë që nxënësit shqiptarë duhet t'i mësojnë në atë libër.

Ky akt vandal i radhës nuk shpëtoi pa u kritikuar edhe prej organizatave dhe njerëzve të profileve të ndryshme. Me zë paksa më të venitur ishin profesorët e gjeografisë dhe historisë, të cilët lejuan që marrja profesionale dhe morale të zbulohet prej dikujt tjetër. Për më tepër rreth këtyre turpeve dhe tendencave shtrembëruese, Kryetari i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, z. Muhamed Murtezi, ekskluzivisht për revistën tonë, u shpreh: "Shoqata e Botuesve Shqiptarë", që nga themelimi i saj në vitin 2000, ka reaguar vazhdimisht ndaj anomalive që kanë ndodhur me tekstet shkollorë në përgjithësi, kurse me ato në gjuhën shqipe në veçanti, të botuara nga "Prosvetno Dello", ku kishte gabime dhe mangësi



**Muhamed Murtezi**  
Kryetari i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë

# lajmë libra shqip

të shumta në sfera të ndryshme, duke u nisur që nga përkthimet e këqija dhe tejet të paqarta, e pastaj deri te toponimia në frymën e gjuhës maqedonase, gabimet drejtshkrimore, sintaksore, morfologjike, e madje edhe teknike. Në këtë drejtim, me entuziazmin tonë dhe dëshirën për të përmirësuar gjërat, asokohe (periudha 2000-2003), ne si Shoqatë madje edhe propozuam dhe ofruam një zgjidhje të drejtë, duke e emërtuar si projekti “Edicioni i botimeve - Libri shkollor”. Por, për fat të keq, zëri ynë atëbotë hasi në veshë të shurdhër dhe mbeti i papërkrahur nga institucionet shtetërore. Skandalet që dolën në shesh ditëve të fundit, sa i përket teksteve shkollore edhe në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën maqedonase, janë sigurisht rezultat i politikës së gabuar shtetërore gjatë këtyre 20 viteve sa i përket qasjes ndaj teksteve shkollore, gjegjësisht përzgjedhjes dhe përgatitjes së tyre. Po ashtu, konsiderojmë se kjo që po ndodh me librin shkollor vjen edhe si rezultat i tentimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që Ministrinë e Arsimit ta shndërrojë edhe në shtëpi botuese, duke mos e menduar fare se tekstet shkollore nuk mund të hartohen në mënyrë administrative, duke shpallur konkurse

politike për autorë dhe recensentë të librave, ku më tepër vijnë në shprehje lidhjet dhe njohjet personale se sa kualiteti, por se kjo mund të bëhet vetëm me ekipe të caktuara profesionale të pedagogëve dhe njerëzve të sferave të ndryshme, të cilët funksionojnë sipas hierarkisë profesionale botuese e jo shtetërore. Ne, po ashtu, mendojmë se një pjesë jo e vogël e fajit për “qarkullimin e lirë” të teksteve me përmbajtje fyese për shqiptarët bie edhe mbi subjektet politike shqiptare, të punësuarit shqiptarë në Ministrinë e Arsimit dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit e lëndëve përkatëse, të cilët nuk kanë denoncuar me kohë mangësitë dhe anomalitë e paraqitura aty.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Nikolla Todorov, është shprehur optimist për këto gabime dhe ka paralajmëruar revidim të librave nga klasa e parë deri të pestën, si dhe të “Gjeografisë” për vitet e dyta të arsimit të mesëm, por ka lënë të hapur mundësinë e revidimit edhe të librave të tjerë, për të cilat mund të zbulohen gabime dhe parregullsi të rënda. Megjithatë, deri në largimin eventual të “Historisë” për klasat e VI-ta, do të duhet kohë, pasi komisionet e revidimit, që do të duhet



të bëjnë super-recensimin e teksteve aktuale, duhet të sjellin vendim me të cilin do të konstatojnë parregullsi.

Kësisoj çdo ditë e më tepër vendohemi nëpër sprova të ndryshme për sa i përket fushës së arsimit, duke mos i përjashtuar edhe fushat e tjera, çka na bëhet me dije se duhet kërkuar me ngulm, në mënyrë urgjente, që materiali mësimor për të gjitha klasat duhet të përputhet me materialin e nxënësve të Tiranës dhe Prishtinës, duke hedhur kështu një hap drejt njësimimit të abetares për të gjithë shqiptarët që jetojnë në trojet e veta, por që gjenden ende nën kolonizim. ■



# NJË E ARDHME MË E

- **Pylltaria do të ketë trajtim meritor**
- **KE-ja ka ndarë 5 milionë euro grante për fermerët**
- **Rendimenti i sivjetmë i grurit, i njëjtë me vitin e kaluar**
- **Në të ardhmen do të ketë investime edhe nga vendet e tjera për bujqësinë**

## Intervistoi: Osman D. GASHI

**K**osova pas shpalljes së pavarësisë së saj, pas njohjes së shumë shteteve nga të katër anët e botës dhe pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të realitetit të ri që është krijuar, tregon se vendi ynë deri-diku ka arritur të ketë një stabilitet politik në arenën ndërkombëtare që ka qenë një prioritet.

Mirëpo, Kosova ka edhe prioritetet e sfidat e brendshme me të cilat duhet të merret. Ndër këto sfida është edhe zhvillimi ekonomik, ulja e nivelit të varfërisë në Kosovë dhe ngritja e standardit të jetesës në vendin tonë. Duke pasur parasysh këtë, Kosova mundësitë për t'u zhvilluar ekonomikisht i ka

edhe përmes sektorit të bujqësisë e blegtorisë, pasi ka tokë pjellore dhe kushte të mjaftueshme për zhvillimin e këtyre dy fushave me theks të veçantë.

Për këtë çështje, për t'u informuar më për së afërmi me gjendjen e bujqësisë realizuam dhe një intervistë me ministrin e MBPZHR-së, Blerand Stavileci.

Ai për revistën 'Paqja', tregoi se sa është investuar në bujqësinë e Kosovës, po ashtu se në të ardhmen pritet që të ketë progres më të madh zhvillimor në këtë fushë dhe bashkërisht diskutuam edhe për shumë çështje e probleme tjera, me të cilat MBPZHR-ja përballet gjatë punës së saj.

**PAQJA: Si ka qenë gjendja e MBPZHR-së kur ju e keni marrë drejtimin e kësaj ministrie?**

**Ministri Stavileci:** Kur kam ardhur në postin e ministrit në MBPZHR, gjendja ka qenë e mirë. Këtu janë bërë punë të mira, ka pasur aktivitete dhe janë realizuar projekte të rëndësishme, sidomos prej vitit 2008 e këndeje. Kam gjetur një staf dhe bashkëpunëtorë shumë të mirë. Natyrisht, nevojat

nga njëra anë dhe mundësitë nga ana tjetër, nuk kanë bërë që të kemi edhe më shumë burime njerëzore, sepse Kosova si një vend bujqësor dhe blegtoral do të duhej që, përveç burimeve financiare dhe burimeve tjera fizike e materiale, të jetë e orientuar edhe në burime njerëzore për bujqësi, pikërisht për t'u ndihmuar banorëve të zonave rurale që përbëjnë 60% të zonave të banuara të Kosovës. Këto burime do t'u ndihmonin fermerëve që të ushtrorjnë aktivitetin bujqësor me një administratë dhe institucione, të cilat mund të jenë edhe më shumë në mbështetje të tyre. Natyrisht, ka ende hapësirë për t'u përmirësuar dhe shtuar numrin e projekteve mbështetëse dhe zhvillimore, për t'i zgjeruar aktivitetet dhe shtuar numrin e njerëzve të përgatitur dhe të motivuar, që edhe më shumë ta forcojmë MBPZHR-në dhe institucionet e tjera që kanë lidhje me bujqësinë. Nëse vazhdohet me këtë dinamikë pune si deri më tani, në periudhën e ardhshme, bujqësia do të zërë një vend meritor në ekonominë kosovare.



# MIRË PËR BUJQËSINË

## Pylltaria do të ketë trajtimin e duhur

**PAQJA:** Kohëve të fundit keni pasur një iniciativë për pengimin e prerjes së pyjeve, siç ishte rasti në Keqekollë. Çfarë është bërë për pengimin e dukurive të tilla?

**Ministri Stavileci:** Ministria që unë drejtoj ka dy shtylla kryesore, bujqësinë dhe zhvillimin rural në njërin anë dhe në anën tjetër ka pylltarinë. Në të kaluarën, për arsye të natyrave objektive dhe subjektive sektori i pylltarisë është lënë më anash. Ka pasur shumë probleme të trashëguara, pengesa dhe vështirësi, për të cilat unë që nga fillimi kam dashur që ashtu si bujqësia, edhe pylltaria të ketë trajtimin e duhur.

Si toka pyjore edhe ajo bujqësore janë asete të vendit tonë, ngase të dyja së bashku bëjnë rreth 94% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Kosovës. Ne kemi 53% tokë bujqësore dhe 41% tokë pyjore dhe pikërisht për këto arsye, por edhe për të mirat që toka pyjore sjellë, kam kërkuar që të ketë trajtim meritator dhe më të mirë se sa në të kaluarën. Në shkurt të këtij viti, nga Qeveria e Kosovës është miratuar Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, e cila shënon një moment të rëndësishëm në këtë aspekt. Ndërkaq, moment tjetër i rëndësishëm është edhe kalimi i kompetencave të menaxhimit të pyjeve nga niveli qendror në atë lokal.

**PAQJA:** Në fund të qershorit ju keni nënshkruar memorandumin për kalimin e këtyre kompetencave që i përmendët, që menaxhimi i pyjeve t'u kalojë komunave nga pushteti qendror. A është ky një lloj decentralizimi në këtë aspekt. Deri ku ka arritur ky proces i kalimit të kompetencave?

**Ministri Stavileci:** Në kuadër të decentralizimit, së bashku me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe me komunat e Kosovës, kemi nënshkruar një memorandum si rezultat i amandamentimit të ligjit për pyjet, i cili ka paraparë që dy kompetencat që kanë të bëjnë me mbro-



**se ky kalim i menaxhimit të pyjeve në pushtetet lokale është jo i mirë ngase mund të dëmtohen pyjet edhe më shumë. Sa janë serioz këta zëra?**

**Ministri Stavileci:** Për secilin veprim që ndërmerret, në këtë rast edhe për veprimet që merr MBPZHR-ja, asnjëherë nuk mund të themi se ka vetëm një rrugë të zgjidhjes së problemit dhe të trajtimit të një çështjeje. Gjithmonë do të ekzistojë edhe mendimi i kundërt me të. Procesi i delegimit të kompetencave ka qenë edhe domosdoshmëri legjislative, sepse kjo është paraparë edhe me amandamentimin e ligjit për pyje dhe këto kanë qenë edhe referencat e ekspertëve, mirëpo nuk është e mundur që për çdo veprim që ndërmerret, të ketë konsensus të plotë. Ne besojmë se ky veprim është në të mirën e këtij sektori dhe po ashtu, problemet dhe mangësitë që mund të shfaqen edhe në të ardhmen, ne do t'i adresojmë përmes ligjit të ri për pyje, për arsye se tani kemi formuar grupin punues dhe shumë shpejt do ta kemi edhe draftin e parë të ligjit të ri për pyjet, i cili më tej do të dërgohet për procedurë të mëtejshme në Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, ngase është objektiv edhe i agjendës sonë legjislative për vitin 2010, edhe i agjendës evropiane.

## KE-ja ka ndarë 5 milion euro grante për fermerët

**PAQJA:** Në sektorin e bujqësisë, sa u keni ndihmuar fermerëve gjatë sezonit të mbjelljeve sidomos atij pranveror?

**Ministri Stavileci:** Që nga viti 2008 kemi një program të veçantë të subven-

me këta sektorë të hortikulturës. Kemi më shumë se 100 projekte në kuadër të perimtarisë dhe jemi të kënaqur me rrjedhën e deritashme, sidomos në prodhim, por jemi të brengosur ashtu si edhe fermerët për çështjet e zinxhirit të prodhimtarisë sekondare, si: ruajtja e prodhimeve, depot, konservimi, përpunimi, e deri te plasimi i produkteve në treg. Përveç këtyre masave financiare me të cilat i kemi përkrahur fermerët, për herë të parë sivjet kanë pasur edhe mundësinë të marrin mbështetje të drejtpërdrejtë financiare nga grantet e Komisionit Evropian (KE). Këto grante kapin shifrën prej 5 milionë euro, shifër kjo që është pothuajse e njëjtë me buxhetin që ne kemi për prodhimtari, e cila është e dedikuar pikërisht për masën 4 të PBZHR-së, që ka të bëjë me ruajtjen, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore. Pastaj, ka edhe shumë donatorë të tjerë që e përkrahin prodhimtarinë dhe pavarësisht se nga vijnë këto donacione, ato shkojnë te fermerët tanë dhe ata kanë përfitime të drejtpërdrejta për realizimin e projekteve të tyre.

**PAQJA:** Si realizohet marrja e këtyre donacioneve apo granteve nga ana e bujqve, përmes projekteve që ju ua identifikoni lokacionet apo nga bujqit që kanë më së shumti nevojë?

**Ministri Stavileci:** Ministria e Bujqësisë ka një strategji të hortikulturës, ku hyn edhe strategjia për perimtarinë 2009-2013, që rrjedh si derivat i planit strategjik. Sektori i hortikulturës është më strategjiku në fushën e bujqësisë

# Syri i kalter

# Margaritari i Shqipërisë

**S**yri i Kaltër është një ndër vendet më të bukura të Shqipërisë, i cili gjendet në mes të Sarandës dhe Gjirokastrës. Është monument natyror. Prej burimit të kaltër nga Mali i Gjerë del uji i kristaltë, i cili merr ngjyrën e kaltër nën rrezet e diellit. Ky burim është me ujëra të freskëta dhe të ëmbla i rrethuar me bimësi të dendur dhe me gjelbërim të përherëshëm. Forma e tij është ovale e ngjashme me formën e një syri. Thellësia e tij është gjer në 45 metra.

dhe ekzistojnë kushte, kriteret e masa (siç ekzistojnë edhe në Bashkimin Evropian) për të aplikuar dhe për t'i përfituar këto grante. Deri sivjet ka pasur një bashkëparticipim 30% me 70% nga bujqit për t'i realizuar projektet e tyre, por sivjet e kemi rritur në 50% me 50%. Për shembull, për një projekt të caktuar, ne si ministri financojmë gjysmën e investimit që bënë fermeri dhe kur kësaj ia shtojmë edhe lehtësirat që ata i kanë, p.sh. vendi ynë prinë në listën e inpleteve bujqësore, të cilat janë të liruara nga tarifat doganore dhe TVSH-ja, atëherë edhe veprimtaria e tyre bëhet me e lehtë. Gjatë kontakteve dhe bisedave me fermerë, shihet se ata kanë nevojë për mbështetje më të madhe, mirëpo si për sektorët e tjerë edhe për perimtarinë, hapat të cilët jemi duke i ndërmarrë bashkërisht për të përmirësuar gjendjen aktuale janë mjaft premtues edhe për të ardhmen e këtij nënsektori të bujqësisë.

**PAQJA: Ju theksuat se MBPZHR-ja i ndihmon një fermeri 50% të investimit. A obligohet fermeri me diçka karshi ministrisë, tatim shtesë apo diçka tjetër?**

**Ministri Stavileci:** Jo nuk kanë ndonjë obligim, është një proces shumë i hapur. Ne bëjmë një kontratë me fermerin, respektohen procedurat dhe kriteret e parapara, të cilat janë të njohura dhe kjo masë është ende e hapur, fermerët mund të aplikojnë me projektet e tyre që kanë të bëjnë me sektorin e hortikulturës deri në fund të muajit shtator. Modeli i të aplikuarit është si në Evropë, i pari që aplikon, i pari përfiton. Pra, në momentin që fermeri aplikon, duke iu nënshtruar procedurave paraprake, pasi t'i përmbushë kriteret ai fiton edhe të drejtën për të përfituar financiarisht. Pastaj, ne si ministri kemi ekipet tona inspektuese, të cilat e monitorojnë ecurinë e realizimit të investimit të fermerit dhe në përputhje me procedurat që kërkohen, atij i akordohet edhe mbështetja financiare.

### **Rendimenti i sivjetmë i grurit, i njëjtë me vitin e kaluar**

**PAQJA: Në korrik ka filluar fushata e korrje-shirjeve. Sa janë të kënaqur bujqit dhe a i ka përmbushur pritjet e bujqve rendimenti i sivjetmë?**

**Ministri Stavileci:** Gjatë muajve të kaluar kemi realizuar fushatën e korrje-shirjeve për kulturën e grurit dhe drithërave të bardha në përgjithësi.

Tani jemi në përfundim e sipër të hartimit të raportit të përgjithshëm për ecurinë e realizimit, për rendimentin, për mbarëvajtjen e punëve në terren, për distribuimin e derivateve dhe shumë shpejt do të dalim me një raport gjithëpërfshirës me të gjitha të dhënat e marra nga drejtoritë komunale të bujqësisë dhe nga shoqatat e ndryshme të bujqve e mullisëve për të pasur një gjendje reale. Në bazë të të dhënave preliminare, mesatarja e rendimentit të arritur ishte rreth 3.6 tonë për hektar dhe kjo nuk ndryshon shumë nga mesatarja e rendimentit për vitet e fundit. Vitin e kaluar e kemi pasur mesataren 3.5 tonë për hektar, para dy vitesh kemi pasur 4.5, para tre vitesh 3.9, kurse para katër vitesh 3.2 tonë për hektar dhe nëse i krahasojmë, nuk ka ndryshuar shumë. Rendimenti i sivjetmë nuk është varur vetëm nga faktorët subjektivë, por edhe nga ata objektivë, ku në masë të madhe kanë ndikuar edhe faktorët klimatikë. Siç konstatojnë ekspertët, në periudhën e pjekurisë së grurit e ashtuquajtura "periudha e qumështit", kemi pasur tem-

peratura shumë të larta që kanë penguar zhvillimin normal të grurit dhe kur kësaj i shtohen edhe elementë të tjerë, del se ky është një rendiment real. Por, vlen të theksohet se si pasojë e faktorëve klimatikë, rendiment më të ulët kanë pasur edhe vende të tjera. Shifra dhe kuota të tilla janë sjellë edhe në regjion, për arsye se rendimentet dhe prodhimtaria e drithërave lidhet me prodhimtarinë globale. Varësisht nga zonat gjeografike edhe rendimenti ka pasur dallime, në vendet kodrinore ka pasur rendimente shumë më të larta se në ato rrafshinore, kështu që, janë një mori faktorësh që kanë ndikuar. Me buxhetin që kemi në dispozicion, planifikojmë t'i rrisim subvencionet për të mbjellat e ardhshme vjeshtore të grurit dhe fermerëve do t'iu subvencionohen më shumë se sa viteve të tjera edhe derivatet e naftës. Po ashtu, në kuadër të kësaj pakoje subvencionuese, do ta fusim edhe një masë të re për subvencionimin e prodhimit të farës së grurit në vendin tonë.

**PAQJA: Pikërisht donim të dilnim edhe**



**aty se kohëve të fundit është rritur çmimi i bukës që ka lidhje të drejtpërdrejtë me grurin. A është në gjendje Kosova me sipërfaqen që ka t'i përmbushë kërkesat e qytetarëve të saj për grurë dhe bukë apo duhet të importojë nga jashtë?**

**Ministri Stavileci:** Në mungesë të statistikave të mirëfillta dhe në bazë të të dhënave që i kemi, aktualisht sipërfaqja që mbillet me grurë sillet rreth 78 mijë hektarë dhe nëse i përpjesëtojmë me rendimentin 3.6 tonë për hektar, del se prodhimi i brendshëm mbulon rreth 60% të nevojave konsumuese të qytetarëve, pjesa tjetër do të importohet.

Natyrisht, nëpërmjet politikave tona investuese synojmë që në të ardhmen kjo prodhimtari të jetë edhe më e lartë, ngase qëllimi ynë është të ngushtojmë hendekun mes prodhimit dhe nevojës për import të grurit. Besojmë që kjo gjë do të ndodhë falë këtyre masave që po ndërmerren dhe investimeve në infrastrukturën e fermave, përdorimin e teknologjive dhe pajisjeve të reja të një bujqësie intensive dhe prodhuese. Kjo lëvizje e çmimit nuk është një dukuri që ka ndodhur vetëm në Kosovë, por është regjionale e globale dhe ka ndodhur për arsye se dy nga prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj të grurit në botë, Rusia dhe India, kanë pasur probleme e tyre, të cilat kanë qenë natyrore. Megjithatë, rezervat botërore të grurit tregojnë që situata nuk duhet të jetë alarmante. Nëse shohim edhe çmimin e grurit në bursat e Frankfurtit, Novi Sadit, e bursat e tjera prestigjioze, shohim se ka luhajtje të çmimeve, por kjo nuk do të duhej të reflektonte automatikisht në ngritje ose në situata alarmuese që do të nxisnin panik te popullata.

**PAQJA: Më herët e përmendët buxhetin dhe donacionet që vijnë nga KE-ja apo donatorë të tjerë. Sa i përket buxhetit të ndarë nga qeveria, a pritet të ketë rritje për vitin e ardhshëm për MBPZHR-në?**

**Ministri Stavileci:** Në qoftë se e krahasojmë kronologjikisht buxhetin e MBPZHR-së në sektorin investues për grante e subvencione, por edhe për investime kapitale në sistemin e ujitjes, në vitin 2007 pothuajse nuk ka pasur buxhet dhe subvencionet kanë qenë vetëm 300 mijë euro, në vitin 2008 është rritur në 1.2 milion euro, vitin e kaluar dhe këtë vit kemi një buxhet prej 5 milionë euro, por n.q.s. kësaj i shtojmë edhe donacionet, ne kemi kaluar shumë në prej

10 milionë euro të investimeve në sektorin e bujqësisë. Në anën tjetër, nevojat janë shumë të mëdha. Ne besojmë që edhe me planifikimet buxhetore, nga viti i ardhshëm e tutje, vazhdimisht do të ketë rritje për sektorin e bujqësisë. Nuk mund të paragjykojmë se sa do të jetë rritja e saktë, pasi që dihet se Qeveria e Republikës së Kosovës ka edhe shumë prioritetet, të cilat si të tërësishme nuk mund të realizohen në të njëjtën kohë, mirëpo natyrisht që do të vijë edhe momenti i mbështetjes shumë më të madhe dhe të drejtpërdrejtë edhe për sektorin e bujqësisë.

**Në të ardhmen do të ketë investime edhe nga vendet e tjera për bujqësinë**

**PAQJA: Kohëve të fundit keni pasur takime me ministra homologë të rajonit. Sa pritet që vendet e rajonit të ndihmojnë dhe a keni nënshkruar ndonjë marrëveshje me ta për krijimin e lehtësirave për bartjen e mallrave bujqësore?**

**Ministri Stavileci:** Në panairin ndërkombëtar "Agra 2010", i cili është mbajtur në Gornja Radgona të Sllovenisë, kam takuar homologun slloven Dejan Zhidan. Po ashtu, kam takuar edhe ministra të shteteve tjera të rajonit, ministrin kroat, maqedonas, atë hungarez, si dhe ministra dhe zyrtarë të vendeve të tjera me të cilët kemi pasur takime multilaterale dhe bilaterale. Me secilin kemi diskutuar për çështjet e përgjithshme në sektorin e bujqësisë dhe natyrisht që në takimet tona bilaterale kemi folur edhe për mundësitë e bashkëpunimit ndërshtetëror. Kemi biseduar për shumë gjëra konkrete dhe jemi zotuar që ta thellojmë këtë bashkëpunim, jo në aspektin deklarativ, por në atë konkret, në realizimin e investimeve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë tregtarë dhe bujqësorë. Besoj që shumë shpejt, me kontaktet që jemi duke i mbajtur do të kemi edhe vizita të ndryshme. Shumicës së ministrave i është bërë ftesa për ta vizituar Kosovën së bashku me investitorët potencialë të sektorëve të ndryshëm, që fillimisht të shihen mundësitë ku ata do të mund t'i bënin investimet, efekt i drejtpërdrejtë i të cilave do ishte ngritja e kapacitetit të prodhimtarisë në vendin tonë. Pra, që gjërat të prodhohen në vendin tonë dhe nga toka jonë, në këtë mënyrë do të zhvillohej sektori i bujqësisë dhe do të rritej prodhimtaria, do të ulej kostoja e prodhimit dhe do

gjeneroheshin vende pune të reja, për arsye se bujqësia është një sektor me mjaft potencial.

**PAQJA: Në kuadër të MBPZHR-së është edhe sektori për zhvillim rural. Në çfarë gjendje është sot fshati kosovar dhe si është gjendja sociale në të?**

**Ministri Stavileci:** Zhvillimi rural është një fushë e rëndësishme e cila trajtohet në mënyrë të veçantë nga ana jonë si institucion. Po ashtu, edhe BE-ja zhvillimin rural e sheh si një kaptinë të veçantë dhe shumë të rëndësishme. Mjafton t'i shohim katër shtyllat kryesore të orientimeve politike të BE-së në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, dy nga katër shtyllat, që i bie 50% e objektivave dhe politikave të saj lidhet me zhvillimin rural, me aktivitete të tjera bujqësore dhe jobujqësore dhe me atë që quhet diversitet rural p.sh. turizmi malor, etj. Rreth 60% e popullatës sonë jeton nëpër zona rurale dhe ne e kemi për obligim të krijojmë një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe të ekuilibruar të të gjitha fshatrave. Në këtë kontekst, është e nevojshme që secili rajon i yni të shfrytëzojë potencialin e vet bujqësor që ka dhe t'i përdorë racionalisht mundësitë në fushat e tjera si turizmi, eko-turizmi, turizmi malor, etj. Ne i kemi disa masa nëpërmjet të cilave investojmë dhe një nga mënyrat e investimit bëhet edhe përmes Grupeve Lokale të Veprimit. Sivjet e kemi dyfishuar buxhetin për investime të ngjashme dhe komunitetet e ndryshme, organizatat joqeveritare, shoqëria civile, agjencitë dhe institucionet e ndryshme, për të siguruar financa për investime në vendet ku ato veprojnë, mund të konkurrojnë nëpërmjet projekteve të tyre në MBPZHR. Pjesë e vizitave që kisha në Slloveni ishte edhe një fermë turistike, e cila ishte shembull shumë i mirë i ndërlidhjes së aktiviteteve nga bujqësia, turizmi dhe aktiviteti ekonomik në një vend të vetëm. Jam optimist që në të ardhmen edhe ne do të kemi mundësi që fshatrave tonë, përveç gjërave elementare t'i krijojmë edhe mundësi të tjera për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, duke e ngritur kështu edhe standardin e jetesës së njerëzve që jetojnë në këto vende. Duhet të ndërëgjegjësohemi dhe vetëdijësohemi se ne jemi ata që duhet të promovojmë shtetin tonë, vetë duhet t'i promovojmë bukuritë dhe resurset natyrore që i ka Kosova. ■

# Trajtimi pedagogjik i nxënësve

**Shpresa ZAPLUZHA & Samire BLLACA**

**S**istemi arsimor në Kosovë është përballur e vazhdon të përballohet me situata problemore specifike, të cilat kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe, njëkohësisht, sa më cilësore. Një temë tepër e ndjeshme dhe mjaft e dhimbshme është dhuna, e cila fatkeqësisht është prezente në shkollat tona. Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të komunave, këshillat rinore, komitetet e të drejtave të fëmijëve që funksionojnë në kuadër të shkollave fillore, si dhe këshillat e prindërve ka vendosur të ndër marrëmasat e nevojshme për ta luftuar atë.

Dhuna nuk mund të kapërcehet duke e shmangur atë, ose thjesht duke e cilësuar atë si jo të moralshme. Ajo mund të përballohet vetëm duke e trajtuar ashtu si duhet. Dhuna në shkollë është e kushtueshme jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në kuptimin e dëmeve afatgjate që ajo shkakton në shëndetin dhe personalitetin e individit, në zhvillimin e tij, në humbjen e nocioneve për mënyrën e të jetuarit dhe, mbi të gjitha, në ndikimin e fuqishëm që ka në pjesën më vitale të burimeve njerëzore të zhvillimit të një vendi.

Shumë njerëz besojnë se dhuna është një fenomen i natyrshëm dhe i përkohshëm në zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve. Shumë veprime të dhunshme të tyre janë të një natyre “jo serioze” dhe eventualisht do të zhduken me rritjen fizike dhe mendore. Sipas këtyre studimeve, sjelljet dhe zakonet agresive që janë fituar në një moshë të vogël janë të prira që të rezistojnë dhe të ruhen për një kohë të gjatë. Këto studime treguan që fëmijët agresivë janë një grup në rrezik, të cilët kanë gjasa më të mëdha se sa fëmijët më pak agresivë, që kur të rriten të bëhen kriminelë dhe vrasës.

Trajtimi pedagogjik, ndihmesa e nxënësve, mësuesve dhe prindërve për një shkollë më të shëndoshë, më të përgjegjshme dhe më të mirë për të gjithë, është nevojë emergjente. Stafet që veprojnë në to ndryshojnë sipas kushteve dhe mundësive që ka çdo vend.

Historia e kohëve të fundit të Kosovës ka qenë e mbushur me lëvizje kaotike të

popullatës, si nga rajoni ashtu edhe nga zonat urbane rurale. Këto lëvizje kanë ndikuar në mënyrë negative në fushën e arsimit, ku shumë shkolla urbane janë të stërbushura me nxënës, ndërsa ato rurale mbyllen. Ndihet mungesa e arsimtarëve të kualifikuar. Arsimi fillor është pothuaj i përgjithshëm, ndërsa gjatë shkollimit të mesëm ka një shkallë të madhe të atyre që e ndërpresin shkollimin. Ky fenomen prek veçanërisht vajzat dhe bashkësitë e pakicave. Ndërkohë, situata shoqërore ekonomike në Kosovë është gjithashtu e vështirë dhe mund të jetë një prej faktorëve bazë, kontribuues në çështjen e dhunës. Ka dëshmi që konfirmojnë se dhuna ndaj fëmijëve është në rritje, kurse çështjet e prostitucionit dhe të trafikimit janë bërë objekt i hulumtimeve. Shumë faktorë shoqërorë e të ambientit, të cilët mendohet se i kontribuojnë sjelljeve të dhunshme, janë të pranishme në Kosovë.

Shkaqet e paraqitjes dhe të manifestimit të dhunës te fëmijët janë të shumta dhe të llojllojshme, prandaj dhuna te fëmijët paraqitet edhe nga gabimet e bëra gjatë edukimit të tyre. Qëndrimi i ashpër dhe autoritativ i prindërve, kërcënimet e tyre si dhe ndësh-

fizike, ndikojnë në shfaqjen e dhunës te fëmijët.


Sot, në këtë sistem edukativo - arsimor mjaft bashkëkohor në shkollat tona, po na përcjellin edhe probleme shumë serioze, të cilat po dalin si rrjedhojë e organizimit jo të drejtë të shkollave tona. Vlerësohet se në vitin 2000, në botë kanë ndodhur rreth 199 000 vrasje rinore – ekuivalent i vdekjes së 565 fëmijëve dhe të rinjve me moshë nga 10 deri më 29 vjeç, mesatarisht çdo ditë dhe kjo si rezultat i dhunës ndërpersonale. Por shkalla e vrasjeve rinore ndryshon dukshëm në varësi të rajonit ose shtetit, kurse shkalla e femrave pothuajse gjithkund është më e ulët se shkalla e meshkujve.

## Faktorët e sjelljes së dhunshme


Nëse ne e kuptojmë dhunën si të shkaktuar nga moskujdesi, ne mund të shohim se fëmijët nuk janë të lindur të jenë të dhunshëm, por mund të bëhen të dhunshëm për shkak se:

- kanë përjetuar dhunë,
- kanë përjetuar dobësim të marrëdhënieve me kujdestarin primar të tyre,
- kanë qenë dëshmitarë të modeleve të roleve të fuqishme që janë të dhunshme,

➤ janë



# Nxënësve me sjellje të dhunshme



shpërblyer për agresion,

- ➔ kanë qenë të prekur nga TV apo dhuna e lojërave me kompjuter,
- ➔ mungesa e shkathtësive të dëgjimit, gjuhës apo sociale,
- ➔ kanë qenë të abuzuar,
- ➔ kanë qenë të traumatizuar nga humbja.

Faktorët kryesorë të sjelljes të person-  
alitetit të lidhur me dhunën rinore janë:

## a) hiperaktiviteti,

- impulsiviteti,
- kontroll i ulët ndaj sjelljes,
- probleme me vëmendjen,
- historia e sjelljes agresive të hershme,
- të arritura të ulëta arsimore

## b) Ndikimi i familjes dhe i moshatarëve

Atmosfera në shtëpi është çelësi për  
zhvillimin e sjelljes të dhunshme te të  
rinjtë. Disa prej faktorëve kryesorë famil-  
jarë të lidhur me dhunën adoleshente janë:

- mbikëqyrje e keqe e fëmijëve nga ana e  
prindërve dhe dënime të rënda fizike  
për disiplinimin e tyre,
- konflikt mes prindërve në fëmijërinë  
e hershme,
- nivel i ulët i besnikërisë mes fëmijës  
dhe prindërit,
- nëna e cila e ka lindur fëmijën e parë  
në moshë të re,
- përjetim i përçarjes ose ndarjes së

- prindërve në moshë të hershme,
- nivel i ulët i kohezionit familjar,
- status i ulët socio-ekonomik i familjes.

## c) Shoqërimi me moshatarë delikuentë

## d) Faktorët socialë, politikë dhe kulturorë

## e) Bandat dhe ofertat lokale të armëve dhe drogës

## f) Niveli i ulët i kohezionit social në shoqëri

## g) Kualiteti i qeverisjes së shtetit, ligjet e tij, shkalla në të cilën ato zbatohen, si dhe politika e mbrojtjes sociale

## h) Të ardhurat jo të barabarta, ndry- shimet e shpejta demografike te pop- ullata e re dhe urbanizimi

## i) Kulturat të cilat nuk japin alternativa jo të dhunshme për zgjidhjen e konflikteve

## Shërbimi psiko - pedagogjik në trajtimin e nxënësve me sjellje të dhunshme

Është shumë e domosdoshme që  
shkolla ta ketë sa më funksional shër-  
bimin profesional brenda saj. Prob-  
lemet që i paraqiten shkollës duhet të  
trajtohen patjetër me seriozitet, sepse  
është në interes të përgjithshëm që të  
mos tolerohen situatat e dhunshme.  
Në rastet kur në shkollë paraqiten situ-  
ata të dhunshme, një ndihmë të madhe  
mund të japin shërbimet profesionale

psiko-pedagogjike siç janë: pedagogu,  
psikologu, sociologu dhe mjeku.

Në rastet e paraqitjes së dhunës në  
shkollë, detyrë e këtij shërbimi është  
që të propozojë zgjidhje profesionale  
në përputhje me nivelin e zhvillimit të  
fëmijës dhe në përputhje me shkallën e  
shkeljes së rregullave në shkollë.

Mësimdhënësit, pavarësisht nga nive-  
li i përgatitjes së tyre, nuk mund të jenë të  
gatshëm që t'i analizojnë thellë situatat e  
ndryshme psiko-sociale, ose edhe prob-  
lemet e thella pedagogjike e shëndetësore,  
e në veçanti dukurinë e dhunës.

Kombinimi i këtij shërbimi të tillë  
brenda shkollës krijon një imunitet të  
fortë dhe mbrojtje shumë të efektshme  
ndaj situatave të dhunshme në shkollë,  
pavarësisht nga kush shkaktohen ato.  
Trajtimi profesional nga shërbimi psiko-  
pedagogjik mund të jetë çelës i suksesit  
të eliminimit të dhunës në shkollë.

Ky shërbim, përveç monitorimit të  
sjelljeve të nxënësve, duhet të shërbejë  
edhe për monitorimin e sjelljes dhe met-  
odologjisë së punës së mësimdhënësve  
të shkollës dhe të stafit tjetër brenda  
shkollës, me qëllim që brenda dhe jashtë  
shkollës të krijohet një ambient i për-  
shtatshëm për nxënie. ■

# TATËPJETA E SHOQËRISË MUSL

‘Është fakt që njeriu i së sotmes nuk e shikon më veten në kuadër të vlerave të përhershme ose në sfond të realitetit që është më i madh se vetë ai. Ai nuk e përjeton vetëm krizën e metafizikës, siç thonë filozofët, por e përjeton edhe krizën e vlerave dhe së mirës!’

(R. Guenon)

**Emine A. VEZAJ**

**N**isur nga rëndësia e individëve që përfaqësojnë shoqëritë dhe shërbejnë si veprues të saj, rizgjimi ose dekadencia e një shoqërie do të varej, në një shkallë të madhe, nga sjellja e këtyre njerëzve. Shoqëritë e tranzicionit dhe ato pas kësaj çdoherë janë caqe të shthurjeve morale, politike e ekonomike. Sidoqoftë, kriza e një shoqërie është gjithmonë intelektuale, përpara se të jetë morale, ekonomike, politike, juridike e historike. Varësisht prej situatave të krijuara në shoqërinë muslimano – shqiptare, shkaqet e tatëpjëtës së kësaj shoqërie mund të preken në këto dy pika kryesore: *mullaizmi* dhe *misticizmi* – *tesavvuifi*.

## 1. Mullaizmi - teologët mendjergushtë (M. Ikballi)

Sipas këtij emërtimi, të bërë nga M. Ikbali, cilësohen shërbëtorët e Zotit – teologët. Koha në të cilën jetojmë ne, dashtë e pa dashtë, përmendet si ‘koha bashkëkohore’ në saje të së cilës këta teologë duhet t’i përgjigjen kohës dhe realitetit të sotëm. Pa gjetur pretekst se me anë të globalizmit të të gjitha shoqërive ne kemi lënë mënjanë atë që është dogmë e fesë sonë të pastër, kemi tematizuar dhe faktorizuar gjërat e tanishme duke shmangur çdo gjë që quhet ‘shumë kohë më parë, ose na ishte njëherë’ krijohen paragjykime të tmerrshme se kinse burimet fundamentale të fesë sonë i shohim të tepërta për kohën e sotme. Teologjia jonë ndodhet para problemeve të shumta, për të cilat me të vërtetë duhet një koordinim teologjik intelektual me edukatë profetike, që do t’i përgjigjej kohës, e cila do ta përgatitë besimtarin se si ta pranojë dhe refuzojë atë që do t’i paraqitet, si p.sh ‘revolucionin shkencor’, ‘revolucionin e filozofisë shkencore’ ose ‘tmerrin e metafizikës’ në kohën e sotme. Teologu i sotëm, këto tema nuk guxon t’i shohë si diçka jorelevante dhe të huaja. Teologjia islame është në gjendje të ruaj gjallërinë e saj dhe të jetë gjithmonë ak-

tuale. Për Shpalljen e fundit në Kuran thuhet *huden li’l-âlemin* – “udhëzim për të gjitha botët” dhe do të thosha dhe shpjegim për të gjitha kohërat. Shpallja e fundit në mënyrë konstante i rivlerëson vlerat dhe i përkufizon ato në formën më të mirë. (I. Bardhi)

Diplomomania e disa teologëve të sotëm dhe zgjidhja tyre e pakontrolluar në gradimin profesional teologjik e ka shndërruar vendin tonë në një arenë lufte mes nesh dhe atyre që nuk mendojnë si ne. Këto ‘theological mani’ përbëjnë epidemi shoqërore dhe infektuese, ndërsa vlerat i shndërrojnë në antivlera. Sot, kemi teolog të arsimuar fetarisht, por aspak të socializuar me masën, thjesht të pandërtuar për t’u përgjigjur interesave dhe qytetarëve të këtij shekulli. Duke i shfletuar dhe lexuar disa publikime teologjike të teologut të sotëm, për të parë se me cilat çështje sot merren teologët dhe çfarë përgjigjesh ofrojnë, kupton se

nuk kanë lidhje me standardin në të cilin jetojnë. Profili i teologut të sotëm, nga ai i një hoxhe mejtepi (kur shihet si person ‘non grata’ në një mes njerëzish), duhet të reduktohet në njeriun akademik. Fatmirësisht, masa e cila frekuenton xhamitë, tashmë nuk është vend ku si pasojë e rrethanave ekzistuese të kohës (kur feja ishte opium për masën, e panevojshme për kohën, rrezikonte indin kombëtar shqiptar, izolon nga bota moderne, e deri tek ato më banale, të llojit ‘fundamentalizëm’ dhe ‘radikalizëm’) frekuentohej vetëm nga të varfrit dhe të ngratët. Heterogjenia që karakterizon shtëpitë e Zotit është nga analfabeti deri tek akademiku. Dhe kjo sigurisht se është për t’u përshëndetur si ngjarje me perspektivë dhe vetëdijesim për shoqërinë se feja është për dhe me njeriun.

Jam kundër idesë së edukimit fare formal ose diplomomanisë. Duhet të kapërcehet ajo sfidë e të ashtuquajturës



# IMANO – SHQIPTARE: SHKAQET

‘mendjengushtësi teologjiane’. Teologu i sotëm nuk guxon të jetë i përjashtuar nga qarku shoqëror dhe i trajtuar si i jashtëm nga aktiviteti shoqëror. Nëse pranojmë se jetojmë në një kohë kur çdo gjë është shndërruar në ‘tallava’, do të ishte fatkeqësi që të pranojmë se edhe feja nuk mund të kursehet prej kësaj. Në fakt, teologu, sipas përkufizimit, nuk mund të jetë profesionist në çështje të fesë (në të vërtetë zanatçi!) sepse Zoti nuk mund të jetë objekt i punës së tij në mënyrën se si janë objektet e shkencave të tjera. Teologjisë, përveç metodës së saj shkencore, i nevojitet tej mase edhe brendia, të kuptuarit, studimi...

## 2. Misticizmi – Tesavuffi (mungesa e frymës mistike)

Misticizmi është një doktrinë filozofike që pretendon se në ndjesinë e brendshme të individit, përmes gjendjes ekstاتike, shfaqet prania e drejtpërdrejtë e Hyjnores. Në botën islame si sinonim i misticizmit është termi *tesavvuf*, që është përkufizuar si ‘drejtim nga dëshira hyjnore dhe nënshtrim i vullnetit hyjnor’.



Tesavvufi, ose mistika islame është jeta ndjesore, thelbi shpirtëror i Islamit. Një shoqëri pa dije shpirtërore vdes. Pasi njeriu me shpirtin e mbërthyer nga materializmi ka humbur atë që quhet ndjesi shpirtërore, figurativisht do të duhej një ‘modus vivendi’ për të shpëtuar ikjen e dhunshme nga realiteti shpirtëror dhe komunikimi me Krijuesin. Ikja e pavetëdijshme nga kjo përshpirtshmëri e ka shndërruar njeriun në një trup statik të destinuar vetëm për kënaqësi biologjike dhe nevoja fiziologjike. Nevojat biologjike dhe fiziologjike, si dhe nevojat për siguri janë të vendosura në thelbin e motivit të mungesës, ndërsa nevojat e tjera në thelbin e motivit të rritjes. Në këtë kontekst flitet për të ashtuquajturat “nevoja themelore” në majën e të cilave është ideja për *vetë-sëndërtim* (A.H. Maslow). Njeriu, në të vërtetë, e përjeton vlerën vetëm atëherë kur veprimtaria e tij është e përshkuar nga kënaqësia, kur e sheh kuptimin, kur ndihet mirë. (Cit. Sipas I. Bardhi)

Komunikimi me Krijuesin është zhbërë nga tëhuajsimi i antivlerave që na mbërthejnë në çdo krah. Ndërkohë që secili njeri bën përpjekje që komunikimin me Krijuesin e vet ta ketë sa më të plotë, komunikimin me botën sa më efikas dhe komunikimin me veten sa më esencial. Edhe konflikti ndërmjet Kabilit dhe Habilit që përfundoi me gjakderdhje, me vëllavrasje, është pika që shënon çrregullimin e komunikimit të njerëzimit, si pasojë e çrregullimit të komunikimit të njeriut me Krijuesin... Mungesa e komunikimit të drejtë me Krijuesin shkakton humbje të komunikimit të drejtë me veten e prej këndeje edhe me një komunikim të çrregulluar edhe me të tjerët, i cili bëhet prodhues i përfytyrimeve të errëta e të frikshme. (Dr. M. Krasniqi)

Nëse nisemi nga historia islame, aty ku zë fill edukata dhe kultura jonë, shohim se edhe të dërguarit e Zotit ishin në ‘përgatitje’ shpirtërore para se t’i besohej bartja e mesazhit hyjnor. P.sh takimi i Musait në malin e Sinaut për dyzet ditë me Zotin e botëve, burgu i Jusufi, po edhe vetmia e Pejgamberit a.s. në shpellën Hira. Qëllimi final i fesë islame në përgjithësi dhe i tesavvufit në veçanti është ta përgatisë njeri me shpirt të çiltër dhe me zemër të pastër. Protag-

onisti njeri duhet të jetë peng i komunikimit me Krijuesin. Madje Xhelaludin Rumi e interpreton bukur ‘varshmërinë’ e namazit si komunikim direkt i besimtarit me Krijuesin: ‘Ata që vazhdojnë ta përjetojnë gjendjen e namazit edhe pas namazit’. Së këndejmi, koncept kryesor i dijes dhe njohjes sufike është Zoti. Zoti përbën kulmin e sferës metafizike të ekzistencës. Ai është Qenia më reale e përqendruar në epiqendrën e sferës metafizike. Ai është themeli i botës ezoterike dhe metafizika i është nënshtruar vetëm Atij. Për pasojë, para se të themi se ‘ka Zot’, ne duhet të kemi një koncept për Zotin. Zoti është koncept bazor dhe ekziston tek njeriu që prej lindjes, por jo si koncept i pastër racional. Ai është koncept i cili mund të përkapet me syrin e përbashkët të arsyes dhe zembrës. (Dr. M. Izeti). Tesavvufi është një e vërtetë morale, shpirtërore dhe konfidencë mes Krijuesit dhe krijesës. Tesavvufi është përpjekje për ta jetësuar fenë në një mënyrë cilësore në përshatje me thelbin e saj duke e zhveshur nga papastërtitë materialo – shpirtërore dhe duke e fituar moralin dhe cilësitë e bukura. (O. N. Topbas)

Tesavvufi mbetet i vetmi kanal që orienton njeriun drejt klimës morale dhe shpirtërore duke mos i hedhur poshtë domosdoshmëritë e botës lëndore – materiale. Tesavvufi mbetet e vetmja alternativë kundër interpretimin radikal që i bëhet fesë në përgjithësi. Ka rëndësi të madhe që përmes frymës mistike, Islami të rigjejë te ne dimensionin intelektual dhe shpirtëror, jo thjesht juridik dhe kalamist. Nga kjo e fundit marr shkas të përmend një opinion të Bernard Luisit, i cili sugjeron që politika amerikane të marrë në konsideratë dialogun dhe përmirësimin e marrëdhënive me sufinjtë islamë, si të vetmen alternativëve me perspektivë për zgjidhjen e konfliktit në Lindjen e Mesme. (S. Schwartz).

Përfundimisht, fesë duhet t’i kthehet vendi i duhur me përkrahjen dhe dashurinë e lirë, duke mundësuar krijimin dhe funksionimin e institucioneve kulturore fetare. Kemi nevojë që njeriun tonë ta bëjmë sa më të dashur, si për vetveten ashtu edhe për të tjerët, duke ia ngritur, në rend të parë, kulturën e bisedës dhe të dëgjimit. (Dr. I. Bardhi). ■

# Imam Vehbi Ismaili: port

**Prof. dr. Hysen MATOSHI**

**E**dhe në botimin e ri të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, të parajlmëruar bujshëm si ndreqës i gabimeve të atij paraprak të periudhës së komunizmit, pastaj si akceptues i vlerave të përgjithshme kombëtare shqiptare, që nuk do t'i marrë parasysh kufizimet ideologjike, disa nga personalitetet e shquara kombëtare nuk janë trajtuar në përputhje me përmasën e tyre reale. Ka raste kur personalitete, por edhe ngjarje, të rëndësishme historike, janë lënë anash krejtësisht. Embargoja komuniste ka vijuar për një numër jo të paktë figurash kombëtare, të cilat nuk u pajtuan me komunizmin, me sistemin më rrënues të vlerave tradicionale e autentike shpirtërore të botës shqiptare. Imam Vehbi Ismaili nuk bën pjesë në këtë Fjalor Enciklopedik Shqiptar prej mijëra faqesh, paçka se rëndësia e veprës së tij për kulturën kombëtare është, vërtet, e rrallë.

Pa pasur qëllim që të polemizoj me redaksinë e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, do të përpiqem që të argumentoj, duke u mbështetur në materialet e tetë vëllimeve të promovuara, faktin pse imam Vehbi Ismaili do ta nderonte, si një zë i veçantë, secilën sprovë tonën enciklopedike.


Së pari, është veprimtaria e tij themelore prej një imami të përkushtuar, i cili tërë jetën ia dëdiko shërbimit fetar, brumosjes së bashkëkombësve të tij me kulturë dhe me mësim fetar, paralelisht duke dhënë kontribut edhe për organizimin e mërgatës shqiptare muslimane, si komunitet i veçantë në SHBA e në Kanada, për gati 60 vjet pandërprerë. Ai, nga një komunitet i paktë e i paorganizuar, sikundër ishin shqiptarët muslimanë të Detroidit para vajtjes së tij atje, arriti të krijonte një lëvizje të fuqishme morale e materiale, të rëndësishme për t'iu dalë krah, në krye të herës, nevojave të komunitetit ku vepronte, pastaj edhe të Kosovës dhe përgjithësisht të botës shqiptare. Ai, po ashtu, krijoi modelin e suksesshëm të organizimit, pa pasur asnjë rezervë a paragjykim që, në raste të caktuara, të ndjekë edhe shembullin e organizimit të vëllezërve shqiptarë të

përkatësisë ortodokse, të cilët këtu kishin arritur më herët dhe kishin vënë në krye të tyre një figurë të rëndësishme kombëtare sikundër ishte peshkopi Fan Noli.

Së dyti, imam Vehbiu nuk e la asnjëherë anash edukimin kombëtar krahas atij fetar. Si vizionar që ishte, ai e kishte kuptuar me kohë se feja dhe kombi mund të mbijetonin vetëm duke u mbështetur në njëra-tjetrën, ndaj edhe punoi palodhshëm në të dyja frontet e ndërgjegjësimit. Dhe do të përpiquej me të gjitha potencialet ta mbronte bashkësinë e tij etnike nga asimilimi, duke ua mësuar bashkëkombësve të tij, vëllezër të besimit, krahas fesë islame, edhe gjuhën shqipe edhe kulturën kombëtare. Kontributi i tij bëhet edhe më i çmuar e më i dashur, kur kujtojmë se si me modesti shprehej për tërë atë punë të tijën vigane, duke thënë se nuk ishte i sigurt nëse kishte bërë aq sa duhet për shqiptarët. Nuk e shihte asnjëherë fenë si pengesë në rrugën e bashkimit kombëtar, përkundrazi, konsideronte se në jetën e shqiptarëve feja ka qenë pikërisht vatra e bashkimit të tyre. Këtë pikëpamje do ta argumentonte edhe me rolin e jashtëzakonshëm mobilizues që dikur e kishin xhamitë në luftën kundër

serbëve e malazezve, si vend ku mbrojtësit e Shkodrës armatoseshin moralisht, shpirtërisht dhe fizikisht. Sipas tij, xhamia ishte, përveçse vend i adhurimit të Krijuesit, “edhe një shkollë e universitetit nga e cila kanë dalë dijetarë të mëdhenj e intelektualë të shquar”.

Së treti, imam Vehbi Ismaili është intelektual yni i madh e i shumanshëm: dijetar i rrallë dhe mjeshtër i letrave shqipe, por edhe njëra ndër urat lidhëse të kulturës sonë me atë botërore, madje edhe në kohën e izolimit të pashembullt kulturor e përgjithësisht shoqëror. Megjithëse në enciklopedinë tonë nuk përfaqësohet as me një rresht të vetëm, duhet thënë se Vehbi Ismaili e pasuroi literaturën shqipe për plot katër mijë faqe shkrime autoriale e përkthime me vlerë. Plot 70 vjet shkëputje nga trangu etnik nuk ndikuan që të krijohej një diferencim i tij kundruall gjuhës, traditave e kulturës shqiptare; përkundrazi, dashuria dhe dhimbja për Atdheun, për Shqipërinë e vënë nën tutelën ideologjike ateisto-komuniste dhe për Kosovën e shtypur në të gjitha trajtat e dhunës më çnjerëzore sllave, u bënë një moto, një kuptim i jetës së tij. Imam Vehbiu, prandaj, na del, në kuptimin e plotë të fjalës,



# reteti i besimtarit atdhetar

udhëheqës fetar me dije të gjera nga kultura islame, por njëkohshëm edhe intelektual që gjithnjë kishte parasysh detyrën ndaj atdheut. Sjellim këtu vetëm mendimin e tij për Kosovën, të shprehur që më 1993: “Kosovën e kam dashur që në fëmijëri dhe duke i studiuar përpjekjet e popullit shqiptar për liri që nga Lidhja e Prizrenit e deri në independencën që mori Shqipëria e cunguar, kam pasur mendimin se ata kanë derdhur më shumë gjak për të... Kosova është plaga ime, si e çdo shqiptari, prandaj sa herë që më jepet rasti, flas dhe shkruaj për Kosovën dhe shqiptarët në ish-Jugosllavi. Kam bindje të fortë se do t’ua arrijnë qëllimeve të tyre”.

Krahas përpjekjeve intelektuale për vetëdijesim fetar e kombëtar, imam Vehbi Ismaili u përqendrua edhe në angazhimet e pareshtura kundër sundimit të egër komunisto-ateist në Shqipëri, që e kishte ndaluar fenë me ligj, kishte ndjekur e vrarë përfaqësuesit më eminentë të saj, kishte përdhosur faltoret, kishte ndaluar mendimin e lirë, të drejtën e organizimit politik jashtë strukturave partiake komuniste. S’do mend se imami në fundin e kësaj të keqeje e shihnte fillimin e agimit të lirisë në të gjitha dimensionet e saj. Duke e njohur hollësisht përmasën e shkatërrimit shpirtëror në botën shqiptare, është krenarësisht e kuptueshme se pse në shkrimet e tij publicistike, në ligjëratat dhe sidomos në lutjet e tij, preokupim kryesor i tij del shpëtimi i Shqipërisë dhe i shqiptarëve nga tmerrri komunist.

Interes të veçantë përbëjnë edhe përkthimet e tij në shqip nga gjuhët e tjera, por edhe anasjelltas. Përveç literaturës fetare përktheu edhe vepra letrare, por që kishin gjithashtu tematikë fetare. Imam Vehbi Ismaili, duke qenë një krijues me talent të rrallë dhe me një kulturë shprehëse e diturore të fituar gjatë punës pothuajse shekullore intelektuale, arriti që edhe vetë të bëhej një autor i përkthyer, duke krijuar një urë dykahëshe të komunikimit kulturor.

Natyrisht, një fjalë rasti për imam Vehbiun është veçse një shikim kalimthi në këtë monument tonin kulturor të lënë disi jashtë rrjedhave të komunikimit normal me lexuesin në Shqipëri, por edhe në trojet e tjera etnike shq-



iptare. Botimi i veprës së imam Vehbi Ismailit është një arritje e madhe, është rikthim i denjë i përvojës së tij intelektuale e veprimtare në mesin tonë, një ndihmë dhe një udhërrëfyes për shumë aspekte të jetës sonë fetare e kombëtare përgjithësisht. Kuptohet, kjo veprë do të kishte një tjetër dimension rëndësie për proceset kulturore e fetare të zhvilluara te ne, në rast se do të mund të komunikonte kaq lirshëm, sa edhe sot, me lexuesin shqiptar qysh në kohën e krijimit të saj. Pamundësia e komunikimit të lirshëm e ka dëmtuar edhe autorin, por edhe kulturën tonë. Botimi i këtij kompleti veprash përbën një ngjarje të shënuar kulturore, ndërsa vlerësimi i drejtë i kontributit të tij të shumanshëm, pa mohuar rëndësinë e disa qasjeve të deritashme, të cilat kanë gjetur vend në vëllimin e parë të kompletit, mbetet obligim për këtë brez dhe brezat e studiuësve që vijnë. Gjithashtu, duhet thënë

se imamin e sjellin këtu, në një trajtë të patretshme e dinjitoze shkrimore, ata që kanë sjellë viteve të fundit mjaft vlera identifikuese për jetën e për identitetin tonë, për vlerat më të ndritshme të së kaluarës sonë: Shtëpia Botuese LOGOS A, me Adnan Ismailin në krye të saj; por një kontribut të çmueshëm, ndër shumë punë të tjera të vyera, e ka dhënë edhe përgatitësi i kësaj serie Nexhat Ibrahimit, pa lënë anash edhe ndihmesat e çmueshme të Zekerija Ibrahimit si redaktor i përgjithshëm, të Husamedin Abazit si kryeredaktor dhe të të gjithë atyre zotërinjve të tjerë, pa punën e të cilëve kjo veprë unike, si përmbajtje dhe po aq e rrallë si dizajn e cilësi shtypi, nuk do ta shihte dritën e botimit.

Uroj nga zemra që të gjithë, me autorin imam Vehbi Ismaili në ballë të kësaj pune, ta kenë fituar kënaqësinë e Allahut të Madhërishtëm për gjithë kontributin e dhënë. ■

# Atentatet dhe vdekja e A

Muhamedi s.a.v.s. njëherë i kishte thënë Aliut: “O Ali, a e di ti se cilët janë më kriminelët prej popujve të hershëm dhe më kriminelët e vonshëm? Ai i tha: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri’. Atëherë Muhamedi s.a.v.s. i tha: ‘Më kriminelët prej të parëve ishin ata që e therën devenë, ndërsa të fundit janë ata që do të therin ty dhe bëri me shenjë nga vendi ku do të therej’



**Muhamed J. KAJOLLI**

## Si erdhi deri tek armëpushimi?

**K**ur Aliu r.a. e humbi Egjiptin, filloi të mendonte më tepër për Hixhazin. Ushtarët e tij e kuptuan rrezikun dhe filluan të rigrupohen. Siç theksuam më herët, ushtria e Aliut r.a. vërtet ishte zvogëluar shumë. Mirëpo ai në Hixhaz po rezistonte fuqishëm, bile për një kohë të shkurtër arriti që t'i rimerrte tokat e humbura deri në Jemen. Rivaliteti midis Aliut r.a. dhe Muaviut filloi të ashpërsohej sërish. Si duket, në këtë kohë të vështirë që po kalonte shteti islam, perandori bizantin Konstanti II (641-668), i biri i Herakliut, do të mendonte për një sulm të shpejtë, i cili do t'ia kthente prestigjin e babit të tij.

Në fakt, burimet bizantine kanë regjistruar një marrëveshje midis Muaviut dhe Perandorisë Bizantine që në vitin 659-të, marrëveshje e cila ishte nënshkruar në dëm të muslimanëve: “Në këto kushte, Muaviu ishte i shtrënguar të përpiqej për marrëveshje me bizantinët. Më 659 nënshkroi paqe me ta, duke premtuar edhe pagimin e tributeve për perandorinë” (Ostrogorsky:94)

Tani më veç na janë të njohura luftërat arabo-bizantine, të cilat kishin filluar menjëherë pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s., gjegjësisht bizantinët

ishin mundur nga arabët në vitin 636 në betejën e Jermukut, vetëm katër vite pasi Herakliu kishte arritur një fitore spektakulare kundër Perandorisë Perse. Asnjë analist nuk e kishte pritur se ai do të humbiste nga beduinët arabë, por ja që ushtria e perandorit më të fuqishëm të botës u mund nga një ushtri e vogël! Pas kësaj disfate pasuan edhe disfata të tjera të njëpasnjëshme, saqë për një kohë të shkurtër e tërë Siria ra në duart e arabëve dhe në vitin 642 bizantinët e humbën edhe Egjiptin. Në vitin 655 Muaviu arriti ta mundte edhe flotën bizantine në detin e hapur të Mesdheut.

Nëse i kthehemi periudhës së luftërave civile brenda shtetit islam, duket se popujt e rajonit ishin të stërlodhur dhe asnjëri prej tyre nuk mendonte ta shfrytëzonte rastin e dobësismit dhe të përçarjes së muslimanëve, sepse këta akoma numëroheshin si fuqia më e madhe në rajon. Mirëpo, marrëveshja e nënshkruar nga Muaviu më (659), si duket, duhet të kuptohet në dy mënyra. E para, Konstanti II-të kishte ndërmend ta rikthente imazhin e dikurshëm të Perandorisë Bizantine dhe, e dyta, ishte bluf prej tij kundër Muaviut së sflitur në luftërat civile.

Literatura e përgjithshme bizantine na mëson se e para do të ishte më e qëndrueshme, sepse ai kishte bërë ndry-

shime të mëdha në strukturat ushtarake dhe qeverisëse brenda perandorisë. Ai fillimisht do t'i siguronte kufijtë jugorë me anë të marrëveshjes me Muaviun, më 659-të, ndërsa ushtrinë e tij e dërgoi në veri dhe në lindje të perandorisë, për t'u hakmarrë ndaj sllavëve dhe armenëve.

Një vit më vonë, gjërat kishin ndryshuar. Muaviu ishte shpallur kalif dhe ndarja mes Aliut r.a. dhe Muaviut ishte bërë akoma më e thellë. Muaviu, duke i kuptuar ambiciet e perandorëve, e aq më tepër ambiciet e djalit të Herakliut, do të duhej të siguronte kufijtë e tij jugorë me Aliun r.a., për t'iu përgjigjur ambicieve të Konstantit II-të, i cili tanimë kishte rikthyer disa toka të humbura në veri dhe lindje të perandorisë.

Ndërsa bizantinologu Norwich, luftërat civile brenda shtetit islam i quan fat i mirë për bizantinët e stërlodhur. “Lufta civile mes Aliut dhe Muaviut zgjati deri më 661-in, kur edhe Aliu u vra dhe Muaviu mbeti kalifi i vetëm. Për pesë vjet, bota muslimane u sfliti nga ndarja dhe Bizanti arriti të marrë frymë lirisht.” (Norwich:98) Nga kjo mësojmë se Konstanti II-të ka përdorur blonfin kundër Muaviut dhe ka arritur të bëjë një marrëveshje në favor të tij.

Si duket marrëveshja midis Muaviut dhe Konstantit II-të nuk është realizuar dhe sigurisht ka mundur që Muaviu të

# Aliut r.a.

kërcënohet nga Konstanti II-të dhe këtu Muaviu është detyruar të bënte marrëveshje armëpushimi me Aliun r.a., të cilën ky i fundit e pranoi për hir të bashkimit dhe mosderdhjes së gjakut të mëtutjeshëm midis muslimanëve, ashtu që muslimanët të mund t'i ktheheshin normalitetit, mësimëve të Kuranit, të fesë dhe shkencës. Muaviut i duhej kjo marrëveshje sa për t'iu treguar bizantinëve se Aliu r.a. dhe ai u bashkuan sërish. Kjo tregonte se bizantinët duhet të mateshin fort nëse mendonin t'i sulmonin muslimanët. Kjo taktikë e Muaviut, bëri që Konstanti II-të t'i tërheqë trupat e tij nga kufiri me Arabinë.

## Si u vendos të kryenin atentatet?

Bota islame ishte mbërthyer në luftëra civile prej ditës së parë të kalifatit të Aliut, që kishin vazhduar deri në fund të jetës së tij. Sa herë që muslimanëve u jepej mundësia të bashkoheshin, dilte dikush që do ta prishte marrëveshjen. Kështu ndodhi në Betejën e Devesë. Pasi kishin mësuar se po bashkoheshin dy ushtritë, grupi i komplotit ndaj Osmanit r.a., e prishi marrëveshjen duke sulmuar dy ushtritë që ishin afër njëra-tjetrës dhe kështu filloi beteja e njohur si Beteja e Devesë. Më pas, ishte beteja e Siffinit, të cilën po ashtu e prishi ky grup komplotistësh, të cilët më vonë u emëruan si havarixhë të përdalur.

Havarixhët u luftuan rreptë nga vetë Aliu r.a. por në fakt ata nuk u eliminuan plotësisht, edhe pse ishin vrarë me mijëra sosh. Në mesin e tyre kishin ngelur individë, të cilët mendonin të hakmerreshin me çdo kusht. Ata ishin të shpërndarë nëpër qendrat e mëdha të regjionit të Kufes dhe Basrës (Irakut të sotëm).

Kur disa prej havarixhëve mësuan për armëpushimin midis Aliut r.a. dhe Muaviut, atyre nuk ju shkoi për shtat kjo marrëveshje dhe filluan të grupoheshin dhe të merreshin vesh se si ta prishin sërish këtë marrëveshje. Në qytetin e Medinës së ndriçuar do të takoheshin:

1. Abdurrahman Ibën Amër, i njohur me nofkën Ibën Mulxhem,
2. Amër Ibën Bekr Et Temimi dhe
3. Burk Ibën Abdullah Ibën Temimi



Ata ishin të vetëdijshëm se fuqia e tyre fizike ishte thuasje inekzistente në vend, mirëpo ata do të vendosin që të “stabilizonin” umetin me anë të atentateve që do t'i ndërmerrenin. Ata do të caktonin ditën e 17-të të muajit Ramazan që t'i kryenin atentatet ndaj tri figurave më të njohura që ishin në konflikt. Kështu Ibën Mulxhmit i ra shorti që ta kryente atentatin ndaj Aliut r.a.

Amri do ta bënte atentatin ndaj Amër Ibën Asit, ndërsa Burk-it i ra Muaviu.

Historianët nuk na sjellin ndonjë të dhënë shtesë, nëse këta tri persona ishin të lidhur me ndonjë organizatë të jashtme. Zakonisht vendime të tilla të

mëdha marrin njerëz që janë nëpër organizata për t'i plotësuar ambiciet e tyre politike, e jo individë të thjeshtë që urrejnë një individ ose një politikan. Prandaj këtu vërehet një mungesë e madhe e historianëve dhe analistëve të historisë që nuk kanë dhënë detaje më të gjera rreth atentateve. A ka qenë e mundur që shërbimet bizantine të kenë ndikuar në marrjen e këtij vendimi, në veçanti kur Konstanti i II-të kishte ambicie që të kthente imazhin e perandorisë?

## Këshillohet që të caktojë rojet e tij

Aliu r.a. asnjëherë nuk kishte reshtur së edukuari umetin e vet me mësimet fetare. Mirëpo me ndalimin e luftës civile, ai do të kishte më shumë kohë për t'ia kushtuar umetit për t'i drejtuar sipas shkollës së Muhamedit s.a.v.s. Historianët theksojnë se disa personalitete që ishin afër tij dhe këshilltarët e tij e kishin këshilluar që të ishte më i kujdesshëm sepse kishin nuhatur për një atentat të mundshëm ndaj tij. Aliu r.a., duke pasur parasysh këshillat e tyre, iu ishte përgjigjur se nuk mendonte si ata. Vendimi im është i prerë, sepse "që herët jam paralajmëruar nga Resulullahi s.a.v.s. për këtë, ndërsa ju duhet të dini se, secili njeri ka me vete nga dy melekë të cilët e ruajnë. Kur njeriut i vjen kaderi i Zotit, ato largohen prej tij".

Kjo përgjigje e tij e prerë jepte të kuptohej se ai nuk dëshironte të kishte roje personale. Ai ishte i bindur se do të vritej, sepse këtë e kishte mësuar nga Muhamedi s.a.v.s. i cili një herë i kishte thënë Aliut: "O Ali, a e di ti se cilët janë më kriminelët prej popujve të hershëm dhe më kriminelët e vonshëm? Ai i tha: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri'. Atëherë Muhamedi s.a.v.s. tha: 'Më kriminelët prej të parëve ishin ata që e therën devenë<sup>2</sup>, ndërsa të fundit janë ata që do të therin ty dhe bëri me shenjë nga vendi se ku do të therej'<sup>3</sup>.

## Atentatet

Kur komplotistët u betuan dhe caktuan që dita e 17-të të Ramazanit të jetë dita e veprimtimit, këta tre u nisën për në destinacionet e tyre. Takimi duket të ketë qenë disa muaj para Ramazanit të vitit 40 hixhri. Ibën Mulxhemi shkoi në Kufe, Amri në Kajro, ndërsa Burku në Damask. Për këta dy të fundit nuk janë dhënë hollësisht rreth qëndrimit të tyre në këto dy qytete, ndërsa për Ibën Mulx-

hemin tregohet se kur ka arritur në Kufe, ai paska takuar ithtarë të havarixhëve dhe atje qenka njoftuar edhe me një grua shumë të bukur, të cilës ushtria e Aliut ia kishin vrarë burrin dhe të vëllanë në betejën e Nehrevanit.

Ajo i paska ofruar martesë me kusht që t'i paguante një mehr prej 3000 dinarësh dhe që ta vriste Aliun r.a. Kushtet për të ishin të mirëpritura dhe ai jetoj me të mbi një muaj. Një ditë ajo ishte mërzhitur prej tij dhe kishte kërkuar që ta realizonte kushtin e dytë, mirëpo ai i ishte përgjigjur asaj se ne kemi ditën e caktuar dhe atë do ta bëjmë kur të vijë ajo ditë për të cilën jemi betuar.

Në ditën e 17-të të muajit Ramazan, në ditën e xhuma, Aliu r.a. kishte dalë nga shtëpia e tij për të falur namazin e sabahut. Me të arritur në xhami, i thirri



të pranishmit për në namaz, kur Ibën Mulxhemi i doli para dhe e goditi me shpatë të helmuar në kokë. Ai u mbulua i tëri me gjak. Të pranishmit e kapën atentatorin dhe kërkuar prej Aliut r.a. që ta mbysnin menjëherë, mirëpo ai iu tha: Nëse vdes unë vriteni, po nëse do të shpëtoj ma leni mua këtë punë." (Bidaje: 6/8-9, Taberi:5/98-102)

Aliu r.a., derisa po vuante nga plagët e mara, të cilët i vazhduan dy ditë, vazhdonte t'i këshillonte të gjithë ata që e vizitonin. Gjithashtu, ai i këshilloi fëmijët e tij, duke ju lënë edhe testamentin<sup>4</sup>. Njëri prej vizitorëve e pyeti: 'O emiri ynë, nëse vdes, a t'ia japim besën djalit tënd Hasanit? Ju tha: 'Nuk ju urdhëroj e as nuk ju ndaloj, ju shikojeni vetë.<sup>5</sup> Pas kësaj fjalie nga goja e tij nuk doli më asnjë fjalë tjetër përveç fjalës (La ilahe il-lall Llah) derisa vdiq.'

Ai vdiq ditën e diel, të natës së 19-të të muajit Ramazan, të vitit 40 hixhri. Dy djemtë e tij Hasani dhe Huseini e lanë xhenazen e tij, ndërsa namazin e xhenazes ia fali djali i madh Hasani. Ai u varros në orët e vona të natës, në re-

zidencën e tij pranë një muri, me qëllim që të mos dihej varri tij nga frika se mos havarixhët e nxirrtnin xhenazen.

Ky është mendimi i shumicës, ndërsa një mendim tjetër, i cili tregohet nga disa historianë thotë se familja e tij, vendosi që ta varroste atë në Medinë, mirëpo një natë derisa ata po flinin nën qiellin e hapur, deveja në të cilën ishte xhenazja ishte liruara dhe kishte shkuar në drejtim të panjohur.

Gjithashtu ka mendime se ai është varrosur në Nexhef etj. Mirëpo vendvarrimin e tij e di një numër shumë i vogël dhe Allahu i Lartëmadhëruar.

## Kush ishte Alia r.a?

Rreth biografisë së tij është shkruar shumë, mirëpo ne këtu do të sjellim vetëm thënien e dy dijetarëve të mëdhenj të botës islame. Dijetari El Hudarij ka thënë: "Njëri prej shkaqeve kryesore të largimit të besimtarëve nga Aliu r.a. ishte besimi i madh në vetveten e tij, bindjet e të fuqishme dhe largpamësi si dhe dallimi shumë i madh i vizionit të tij krahasuar me elitën kurejshite. Ky dijetar kur bën krahasimin midis Aliut r.a. dhe Omerit r.a. është shprehur në këtë mënyrë: "Omeri r.a. e kishte shtrënguar fort umetin, ndërsa umeti e kishte shtrënguar fort Aliun r.a."

Ndërsa Shabiu thoshte: "Aliu r.a. i ngjasoi Mesihut-Isait të birit të Merjemes: Populli e deshi, por e mbuluan të vërtetën e dashurisë ndaj tij, një pjesë tjetër e urreu, por gjithashtu edhe këta e mbuluan të vërtetën ndaj urrejtjes së tij". (Shelebij:1/635) ■

1 Bile shumë historianë bizantinologë e mohojnë të ketë ndodhur një betejë në vitin 636 midis arabëve dhe Bizantit. Mirëpo historiani Cameron e pohon një gjë të tillë dhe thotë: Numri i arabëve sulmues ka të ngjarë të ketë qenë mjaft i vogël, por bizantinët e kishin konsumuar forcën e tyre dhe pas një disfate bizantine në lumin Jarmuk më 636, Herakliu i priu një tërheqjeje bizantine prej territorit, të cilin e kishte rifituar vetëm pak kohë më parë. (Cameron: 63)

2 Këtu bëhet fjalë për popullin e pejgamerit Salih a.s. (M.J)

3 Dinuri: 162 (Ky hadith është transmetuar pak a shumë në të njëjtin version nga shumë transmetues. Muhamedi s.a.v.s. e kishte paralajmëruar Aliun se do të pritej në kokë dhe se do t'i mbulohej mjekra me gjak.)

4 Testamenti është paraqitur në disa libra të historisë, për më shumë lexoni Tarihu-Taberi, Dinurin, Bidaje...

5 Aliu nuk e caktoj me gojë djalin e tij, mu ashtu sikur që nuk e kishte caktuar Muahmedi s.a.v.s. asnjërin prej sahabëve të tij që ta zëvendësonin. Me këtë veprim ai kërkoi zgjedhje të lira midis muslimanëve.

**K**ëto ditë, një lajm befasoi degën e ruajtjes së fshehtësive të të dhënave dhe shumë konsumatorëve. Mbi 130 milionë të dhëna të kartave të kreditit u grabitën nga një treshe hackerash në SHBA. Për aq kohë sa ekziston mbledhja e të dhënave, ekziston edhe brengosja për sigurinë e tyre. Ka kohë që kërcënimi ndaj të dhënave ka goditur edhe Shtëpinë e Bardhë. Edhe Presidenti i SHBAsë Barack Obama, gjatë fushatës së tij elektorale ra viktimë e një sulmi hacker. Më 29 maj Obama, foli edhe për sigurinë ndaj luftës virtuale në internet, të ashtuquajtur "cyberwar". Në këtë kontekst ai tërhoqi vërejtjen për varësinë e

"malware" – pa e kuptuar fare këtë, sqaron Hypponen: "Qysh nga ky moment kompjuteri nuk është më i yti. Ai kontrollon prej kriminelëve online, të cilët duan të fitojnë para. Ata ose kryejnë veprime të ndaluara me kompjuterin tënd duke dërguar spam, ose ajo që është më e mundshme, duke skicuar çfarë ndodh me tastierën tënde me shpresën që ti të japësh numrin e kartës së kreditit, gjatë blerjes online. E në këtë mënyrë njerëzit humbasin numrat e kartave të tyre të kreditit". Kështu p.sh. në rastin e fundit në SHBA ndodhi që ordinatorët e komanduar në distancë infektuan ordinatorë të tjerë. Si rrjedhojë krijohen rrjete të kontrolluara ilegalisht, të ashtuquajtur rrjete bot (programe kompjuterike që

2.500 anëtarë të regjistruar. 56 njerëz u arrestuan, ndër ta edhe anëtarë të rrjetit në Gjermani. Gazetari britanik Misha Glenny prej vitesh merret me globalizimin e kriminalitetit të organizuar. Gjatë investigimeve të tij ai ka hasur edhe në rrjetin e cyber kriminalitetit: "Ka njerëz që ofrojnë në këto faqe aksesin tek rrjetet bot. Ato i japin me qira këto rrjete, ose i shesin ato si "malware" (programe të dëmshme) përmes të cilave mund të ndërtohet rrjetet bot. Kjo realizohet thjesht dhe shpejt. Nuk është e nevojshme të kesh njohuri të veçanta teknike për ta bërë këtë. Mjaftojnë vetëm njohuritë bazë për kompjuterin, siç i ka çdo 16 apo 17 vjeçar". Sipas gazetarit Glenny, në mbarë botën ka një serë faqesh të tilla kriminale.

# Sulm i hatashëm hakerësh

Amerikës nga një strukturë funksionuese e informacionit duke theksuar: "Cyberspace është realitet. Por po aq reale janë edhe rreziqet, që rrjedhin prej tij. Ekziston një ironi e madhe në epokën tonë të informacionit, që pikërisht teknologjitë, të cilat na mundësojnë të arrijmë dhe të ndërtojmë diçka, forcojnë edhe ata, që duan të shkatërrojnë atë çka ngremë ne." Bota është e futur në rrjet. Si rrjedhojë edhe kriminelëve të futur në rrjet u mundësohet aksesin tek të dhëna delikate dhe sekrete. Kjo ndodh shpesh duke instaluar programe ilegale dëmtuese, të ashtuquajtur "malware" - në ordinatorët e përdoruesve, që nuk kanë dijeni. Mikko Hypponen është drejtues i sektorit të studimeve pranë sipërmarrjes finlandeze të sigurisë FSecure. Qysh prej gati 20 vjetësh Hypponen merret me sigurinë e ashtuquajtur "cybersecurity". Qoftë edhe duke vizituar rastësisht faqe interneti të manipuluar mund të infektosh me programet e dëmshme

funksionojnë automatikisht). Tillmann Werner studion botnet-et në Universitetin e Bonit: "Me botnet ne kuptojmë një sasi sistemesh të infektuara, të cilat komandohen në distancë. Ka një komandë qendrore dhe një instancë kontrolli, siç i quajmë ne. Poseduesi i botnetit përkatës ka kontrollin ndaj këtyre sistemeve të infektuara. Normalisht me sistemet e infektuara mund të bësh çfarë të duash". Botnet-et mund të arrijnë përmasa të jashtëzakonshme. Ndërkohë janë zbuluar rrjete me njëmillionë e gjysmë ordinatorë të infektuar. Akesi dhe kontrolli ndaj këtyre rrjeteve tregtohen në internet midis kriminelëve të rafinuar në aspektin teknik. Në tetor 2008 policia federale në SHBA, FBI, pas një operacioni që vazhdoi dy vjet rresht asgjësoi faqen ilegale në internet "Dark-Market". "Dark Market" kishte




# Letërsia në përfaqasje me besimet fetare

**Atdhe IBRAHIMI**

**D**itë më parë doli nga shtypi vepra e studiuesit, shkrimtarit dhe publicistit Milazim Krasniqi, "Letërsia dhe besimet fetare". Një vepër e tillë i ka munguar shumë letërsisë shqipe, e cila studion kontekstin jashtëletrar në përfaqje me besimin fetar, prandaj me botimin e kësaj vepre Milazim Krasniqi ka dhënë një kontribut të veçantë në fushën e letërsisë së përgjithshme dhe krahasuese.

Milazim Krasniqi duke shkruar për civilizimet e lashta argumenton se letërsia është pjesë e pandashme e këtyre civilizimeve, që nga antikiteti politeist, i cili ishte shkëputur tërësisht nga shpalljet hyjnore monoteiste. M. Krasniqi e sheh letërsinë imituese të artit antik, e cila përçon mesazhe të dhunës, anarkisë dhe të

shfrenimit njerëzor. Duke qenë kështu, autori me këmbëngulje kërkon që letërsia të distancohet nga skemat e besimit politeist, nëse mëton që ta shpëtojë veten dhe njeriun nga katandisja e mëtutjeshme shpirtërore dhe kulturore.



Vetëm kështu mund të promovojë rëndësinë e të besuarit në një Zot të vetëm si rruga më e mirë dhe më e sigurt që shpie drejt përparimit të gjithanshëm kulturor.

Milazim Krasniqi, procesin krijues letrar nuk e sheh të shkëputur nga besimi fetar, pavarësisht nga fakti se letërsia në etapat e kaluara nuk ka qenë në koherencë të mjaftueshme me besimet fetare monoteiste si promovuese të vlerave morale, individuale dhe shoqërore. Prandaj në studimin e tij, ai përpiket që ta inkuadrojë fenë monoteiste si bazamentin më të rëndësishëm të ekzistencës shpirtërore të njeriut në këtë botë, si genie e krijuar nga një Zot i vetëm.

Milazim Krasniqi beson fuqishëm se inkuadrimi i letërsisë në aspektet e besimit fetar monoteist do të ndikonte në mënyrë të veçantë te individi, që ai ta njohë në radhë të parë Zotin, pastaj vetveten dhe botën tjetër.

Me botimin e kësaj vepre Shtëpia botuese: "Logos-A" dhe Biblioteka: "Divan" kanë kryer një punë të lavdërueshme dhe të dobishme. Në këtë mënyrë është plotësuar një mungesë e madhe dhe i është dhënë mundësia lexuesve dhe studiuesve shqiptarë të lexojnë dhe të studiojnë një nga tekstet më të mira të këtij autori. ■



Bashkëbisedim me regjisorin Sabri Pajaziti

# HERË KORRIM SUKSES, E HERË EDHE FUNDOSEMI

**S**abri Pajaziti ndien nevojën për arrati nga vetja dhe nga njerëzit e vendit të tij. "Ne shqiptarët shpesh na kaplon dëshira për të ikur nga atdheu. Herë korrim sukses, e herë edhe fundosemi andej", - thotë ai për vendasit. Sabriu i lipsej këto kohë veç një arratisje e shkurtër nga vendi dhe teatri që bëhet sot në Kosovë, për të njohur një realitetit të ndryshëm nga ai ku jeton. Regjisori 35-vjeçar bëri kilometra të tëra për të dorëzuar një projekt në Festivalin Teatror të të Rinjve në Tiranë. Një vendim që të rinjtë brenda kufijve hezitojnë ta marrin edhe në kushtet më të favorshme se të tija.

Vepra "Fluturimi, çfarë kënaqësie!" e dramaturgut rumun Doru Motoc, që Pajaziti ka zgjedhur për konkursin, tregon pikërisht realitetin që regjisori sheh ditë për ditë. "Ka të bëjë me dy personazhe që nuk e dinë prejardhjen e vet, e njohin shumë pak njeri-tjetrin dhe nuk e dinë ku po shkojnë. Shpikin fluturimin si të vetmen mënyrë shpëtimi", - tregon Sabriu, i cili nuk i ka ende emrat e dy aktorëve që interpretojnë në këtë shfaqje. Sa për prezantimin e projektit, ai ka zgjedhur aktorët kosovarë: Edonis Kastrati dhe Gëzim Bucolli, por nuk dihet nëse do të jenë po këta deri në fund. Sabriu e tërheq mënyra se si punohet në teatrin shqiptar. "Mendoj që teatri shqiptar e çmon shumë klasiken, qasjen klasike të vënies së një vepre në skenë. I kushton rëndësi edhe simbolikës, metaforës. Më tërheqin këto elemente. Në Kosovë gjen një teatër më transparent. Mua si krijues më ngacmon më tepër simbolika dhe universalja. Pastaj Tirana të jep

një energji tjetër që ndikon në krijim", - shprehet Pajaziti. Regjisorët e rinj që bëjnë Festivalin Teatror të të Rinjve, çdo vit, kanë ankesa për buxhetin, që sipas tyre nuk del as për kostume dhe skenografi. Nuk duhet harruar edhe ngurrimi dhe mungesa e kurajës për të thithur fonde në rrugë të tjera.

## Artistët e rinj nuk e gjejnë gjithmonë veten

Sabriu, megjithëse është pak herët që të flasë për financat e projektit, që nuk dihet se a do ta ketë shansin e realizimit, ai sheh një realitet të zymtë në Ferizaj, vendin ku jeton. Ai tregon se regjisorët e rinj kanë hapësira të pakta. Edhe kur vendosin t'i mbështesin të rinjtë, institucionet e Kulturës, Ministria, Bashkitë dhe organizatat joqeveritare, marrin vendime "të padrejta".

"Problemi është se fondacionet përcaktojnë edhe qëllimet e tyre. Për shembull shfaqja duhet të jetë për dukuritë negative, të flasë kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kundër drogës, duhanit, prostitucionit.

Jo të gjithë artistët kanë qasje të tilla. Departamenti i Kulturës dhe i Rinisë në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkitë japin grante për t'i ndihmuar të rinjtë. Ata jo gjithmonë janë të drejtë, jo gjithmonë ofrojnë kushte të mira dhe shumë herë bëjnë kufizime. Artistët e rinj nuk e gjejnë gjithmonë veten", - shprehet Pajaziti rreth teatrit në Kosovë, duke u përpëlitur ende për një identitet. Problem ngelet statusi i artistit dhe të drejtat që i jep ky status.

■  
(J. P)

# “Hajt se një ditë do të bëhet mirë!”



## Besime RRUSTEMI

**A**rtistët kosovarë janë lënë pas dore dhe shpresa e tyre për një jetë më të mirë profesionale thuhet se është shuar. Shpresa e tyre për angazhim profesional, nga ndonjë regjisor vendor ose i huaj, mbeten vetëm fjalë boshe “Hajt se një ditë do të bëhet mirë!” Mirëpo vullneti dhe dëshira e madhe për t’i qëndruar publikut kosovar sa më afër, e shtyu një grup aktorësh që të marrin vetiniciativë për të shfaqur komedinë “SUPERFLOQI”, për të cilën u punua intensivisht 58 ditë të plota, me së paku 3 orë prova në ditë.

Idea e gjithë kësaj shfaqjeje ishte e regjisorit Kastriot Saqipi dhe e menaxherit Mirsad Ferati.

Komedia në fjalë pasqyron gjendjen e tanishme teatrale të artistëve, të cilët vendosin të tregojnë vullnetin e tyre, por që janë në kërkim të një regjisorit, i cili e pranon bashkëpunim mirëpo në momentin që kupton se nuk do të ketë pagesë e lëshon shfaqjen dhe i lë aktorët në duar të fatit. Aktorët të dëshpëruar nga ky veprim, kërcënojnë se do ta zgjojnë nga varri Kristo Floqin që t’iu bëjë regji!

Kështu edhe ndodh kur pranë tyre shfaqet një njeri dhe pranon detyrën e tij si regjisor. Por, kush është ky: Rekuizer?! Lugat?! Apo regjisor?! Në fakt ky është një “i çmendur”, i cili ka ikur nga neuropsikiatria dhe si vend më të mirë për strehim ka gjetur teatrin.

Kjo është pasqyra e komedisë “SUPERFLOQI”, e cila u dha premierë në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica” në Mitrovicë.

Në rolin kryesor, nën petkun e Kristo Floqit, të vetëmëruar si Super

Floqi, interpretoi Artan Avdyli, kurse në rolet e tjera interpretuan: Altina Kusari, Mirsad Ferati, Edona Berisha dhe Fikrim Berisha.

Komedia mori përkrahje të madhe nga audiencia dhe pritet të vazhdojë rrugëtimin e saj për t’u shfaqur më pas në Teatrin Dodona në Prishtinë, pastaj në Gjakovë, Ferizaj, Kamenicë, Gjilan, Podujevë, Vushtri dhe të kthehet me sukses të madh papë në Mitrovicë.

“Me gjithë vështirësitë dhe problemet e tejkaluësme, ne arritëm të sjellim një shfaqje profesionale, siç është komedia “SUPERFLOQI” dhe arritëm që pas dhjetë ditësh të mbledhim në Qendrën e Kulturës Rexhep Mitrovica, në Mitrovicë, një audiencë të madhe në numër”, - u shpreh drejtori i Qendrës Kulturore Mirsad Ferati. “Duke pasur parasysh gjendjen politike në qytetin tonë, ne me shfaqjen tonë arritëm të tërheqim vëmendjen e opinionit, të paktën për disa minuta sa qëndruam bashkë, duke e argëtuar me këtë komedi, e cila ngërthen në veten e saj një problem tjetër: “jetën e vështirë artistike”.

Drejtori i Qendrës së Kulturës “Rexhep Mitrovica” në Mitrovicë dhe njëherësh menaxher i shfaqjes, shpreh falënderime për aktorët e kësaj shfaqjeje, si dhe për shumë donatorë pa ndihmën e të cilëve nuk do të realizohej kjo komedi.

“Vetiniciativa për realizimin e komedisë “SUPERFLOQI” është nisma jonë për zhvillimin e jetës profesionale, kulturore dhe artistike. Presim bashkëpunim dhe zhvillim edhe më të hovshëm, me synimin që t’i arrijmë teatrot dhe skenat botërore”, - citoi në fund vullnetmiri i artit, Mirsad Ferati. ■

# HIGJIENA E GOJËS, BRENGË E ARSYESHME

Kujdesi i shtuar për higjienën e gojës, para së gjithash, higjiena e dhëmbëve dhe e mishit të dhëmbëve, jo vetëm se do t'iu japin një buzëqeshje të bukur, por edhe një shëndet të përgjithshëm shumë të mirë. Në fakt, trupi i shëndoshë dhe dhëmbët e shëndoshë nuk shkojnë pa njëri-tjetrin. Shumë studime kanë rezultuar se bakteret që gjenden në gojë mund të qarkullojnë nëpër pjesë të tjera të trupit. Kjo do të thotë se një higjienë e keqe e gojës mund t'i shkaktojë çrregullime të ndryshme organizmit në përgjithësi

**Artan N. BEJTA**

## Rëndësia e higjienës orale

**J**o rastësisht thuhet se dhëmbët e shëndoshë ruajnë trupin e shëndoshë, e po ashtu ata që i pastrojnë dhëmbët rregullisht shijojnë ndjenjën e freskisë dhe të aromës së mirë të gojës. Shumë studime kanë rezultuar me bakteret që gjenden në gojë mund të qarkullojnë nëpër pjesë të tjera të trupit. Pastrimi i rregullt i dhëmbëve me një brushë të pastër dhëmbësh dhe me pastë për dhëmbë janë mjete të efektshme për të luftuar infeksionet e gojës, gjegjësisht organizmit. Kjo do të thotë se higjiena e keqe e gojës mund të shkaktojë probleme nga më të voglat, si infeksione të gojës, e gjer në ato më të rrezikshme për jetën, si sëmundjet e zembrës.

Është vërtetuar se higjiena e gojës e rrit vetëbesimin, ndërkaq dhëmbët e prishur dhe mishi i sëmurë i dhëmbëve, përpos që paraqesin problem shëndetësor, paraqesin edhe një problem të madh estetik, që pa dyshim ndikon në uljen e vetëbesimit të njeriu. Këtë e vërteton fakti se kur keqëri të keqe nga goja, të tjerët do të ikin nga ti dhe, në këtë mënyrë, do të ndihesh i izoluar dhe i lënë anash nga shoqërimi i të tjerëve. Kujdesi i shtuar për higjienën e gojës, para së gjithash, higjiena e dhëmbëve dhe mishit

të dhëmbëve, jo vetëm se do t'iu japin një buzëqeshje të bukur, por edhe një shëndet të përgjithshëm shumë të mirë.

## Hapësira e gojës dhe sëmundjet e saj

Në kushte normale, hapësira e gojës përmban një numër të konsiderueshëm të bakteve specifike, por në momentin e prishjes së integritetit të mukozës së hapësirës së gojës mund të shkaktojnë infeksione të ndryshme. Ndër problemet më të shpeshta që paraqitet në hapësirën e gojës, si pasojë e mosmirëmbajtjes së higjienës së rregullt të gojës mund të përmendim:

**Formimin e pllakës dentare dhe gurëzave,** të cilët janë faktorët kryesorë në krijimin e problemeve të mishit të dhëmbëve si dhe kariesit (prishjen e dhëmbëve). Në të vërtetë pllaka dentare është një depozitim i bardhë dhe i butë, i cili krijohet në sipërfaqet e dhëmbëve. Është formacion, i cili formohet kur bakteret (sporet) bashkohen me pështymen dhe ushqimin. Pllaka dentare përmban qindra lloje bakteresh. Preventivi më i mirë për të penguar formimin e kësaj pllake është mirëmbajtja e rregullt dhe e mirë e higjienës së gojës. Gurëzat dentare janë formacione të kalcifikuara dhe të forcuara. Ngjiten fort pas dhëmbëve. Në përgjithësi largohen nga dentisti me instrumente të veçanta.



**Kariesi (prishja e dhëmbëve)** janë vrmat të cilat krijohen në smaltin e dhëmbëve. Një ndër shkaqet kryesore të kariesit është mbledhja e pllakës. Bakteret në pllakë formojnë acid pas reaktionit të tyre me sheqerin dhe amidonin që ndodhet në ushqime. Acidet mbahen në kontakt me dhëmbët me ndihmën e pllakës dhe me kalimin e kohës e shkatërrojnë smaltin dhe dentinën.

**Paradontozat (sëmundjet e mishit të dhëmbëve)** janë infeksione dhe inflamacione të indeve që rrethojnë dhëmbët. Pllaka dentare është shkaku kryesor për formimin e këtyre sëmundjeve.

**Gingivitis (inflamimi i mishit të dhëmbëve)** ka shumë lloje, por në shumicën e rasteve janë të shkaktuara nga pllaka dentare. **Periodontitis** ndodh në qoftë se gingivitis keqësohet dhe progreson drejt indeve mbështetës të dhëmbit si membrana periodontale dhe procesi alveolar (kocka rreth dhëmbit).

## Si ta mirëmbajmë higjienën orale?

Larja e dhëmbëve dhe përdorimi i pastës dentare rregullisht ndihmojnë në shëndetin e dhëmbëve dhe mishit të dhëmbëve dhe parandalojnë kariesin dentar dhe sëmundjet e mishit të dhëmbëve. Është shumë e rëndësishme që të bëhet zakon mbajtja e një higjienë të rregullt dhe të mirë të gojës, duke përdorur brushën dhe pastën dentare. Autorë të ndryshëm preferojnë teknika të ndryshme të pastrimit të dhëmbëve (metoda sipas Stilman-it, Bass-it, etj.). Mirëpo ajo që është e rëndësishme të dihet është që gjatë pastrimit të dhëmbëve kujdes i veçantë duhet kushtuar që dhëmbët të pastrohen mirë jashtë, brenda, pas dhe në hapësirat midis tyre pasi që pllakëza bakteriale (bakteret) mund të fillojnë të shkaktojnë karies në çdo pjesë të dhëmbit. Pastrimi i dhëmbëve duhet të bëhet në drejtim vertikal, duke filluar nga mishi i dhëmbëve drejt dhëmbit dhe në këtë mënyrë, si sipërfaqja e brendshme e tij, ashtu edhe ajo e jashtme, pastrohen me një lëvizje



gjysmërrotulluese (në këndin 45°) me drejtim nga jashtë. Është i mangët pastrimi i dhëmbëve në të cilin lëvizja e furçës bëhet në drejtim horizontal.

Është shumë e rëndësishme që të bëhet pastrimi i dhëmbëve pas çdo shujte (racioni) e gjithsesi një herë para se të biem në gjumë (natën), pasi që koha e veprimt të baktereve është më e gjatë. Sipërfaqja kafshuese e dhëmbëve pastrohët në atë mënyrë që brusha vendosët në kënd të drejtë me sipërfaqen e dhëmbëve, kështu që pastrimi i tyre bëhet me lëvizje prapa-para. Duhët theksuar se çdo pjesë e vargut të dhëmbëve duhet të pastrohët së paku 10-15 sekonda, ndërsa e gjithë procedura e pastrimit të dhëmbëve të zgjasë 2 deri 3 minuta.

### Brushat për dhëmbë

Pasi që funksioni kryesor i brushës së dhëmbëve është mënjanimi mekanik i materieve të ndryshme nga sipërfaqet e dhëmbëve (depozitimeve të buta, mbetjeve të ushqimit, baktereve, etj.) në këtë mënyrë, duke penguar formimin e pllakës dentale, si faktor kryesor për shkaktimin e kariesit dhe të parodontopatisë, atëherë gjatë zgjedhjes së brushës duhet të merren parasysh këto veti:

**Madhësia** – Në të vërtetë madhësia e brushës varet prej moshës dhe madhësisë së gojës dhe nënkuptohët se të fëmijët e vegjël preferohen brushat që e kanë kokën e vogël. Është e preferueshme që koka e brushës të mos jetë më e madhe se 3 cm.

**Cilësia e fijeve** - Brushat mund të jenë të ndërtuara nga fijet natyrore dhe sintetike. Fijet natyrore nuk preferohen për shkak të mundësisë së grumbullimit të baktereve në kanalën e tyre, po ashtu sipërfaqen e jashtme dhe majën nuk e

kanë të lëmuar. Për pastrimin e dhëmbëve janë më të preferuara brushat, që janë të ndërtuara nga fijet sintetike, ndërsa maja e fijeve është e rrumbullakësuar dhe e lëmuar. Te fëmijët që posa fillojnë t'i pastrojnë dhëmbët, preferohët që të përdoret brusha me fije tejet të buta.

**Funksionaliteti** – Është shumë e rëndësishme që, pas përdorimit, brusha të pastrohët mirë dhe të mbrohet nga kontaminimi dhe pluhuri. Para përdorimit brusha duhet të jetë e tharë, për këtë arsye është mirë që të përdoren dy-tri brusha sipas renditjes. Nëse dyshohët që brusha juaj është përdorur nga dikush tjetër, hidhëni atë, nëse brushës i bien fijet, gjithashtu duhet ndërruar. Mos e përdorni brushën më shumë se dy-tre muaj.

### Pasta e dhëmbëve

Pasta e dhëmbëve përdoret për të lehtësuar lëvizjen dhe shkapërderdhjen e pllakëzave bakteriale dhe zakonisht në përmbajtjen e tyre, përveç elementeve freskuese, posedojnë edhe ato kurative (shëruese) ku bëjnë pjesë mineralet e ndryshme si: kalciumi, fluori etj. Edhe pse reklamata thonë të kundërtën, dijen se asnjë pastë dhëmbësh nuk i bënë dhëmbët më të bardhë se sa ata janë në realitet. Pasta heq njollat nga dhëmbët, por kurrë nuk i zbardh ato. Lënda më e rëndësishme që duhet të përmbajë një pastë e dhëmbëve është fluori. Ai i forcon dhëmbët dhe rrit qëndrueshmërinë e tyre ndaj sulmeve të acideve. Fluori, gjithashtu, frenon gërryerjet e dhëmbëve dhe mund të ndihmojë dhëmbët me vrima të vogla. Dy lloje fluori mund të përdoren në një pastë dhëmbësh, fluorid natriumi dhe monofluorfosfat natriumi. Që të dyja

mbrojnë dhëmbët ndaj gërryerjeve, por lloji i parë mbron pak më mirë. Që fluori të japë efektin më të madh në gojë duhet që dhëmbët të lahen dy herë në ditë, pas ngrënies së mëngjesit dhe pas ngrënies së darkës. Në qoftë se gjatë pastrimit të dhëmbëve kemi një gjakderdhje të lehtë atëherë bëhet fjalë për krijimin e pllakëzave bakteriale në mishin e dhëmbëve dhe preferohët të shkohët te mjeku i dhëmbëve (stomatologu).

### Vitaminat dhe mineralet që mbrojnë dhëmbët

Jo vetëm një higjienë e keqe e gojës, por edhe një ushqim i keq, mund të shkaktojë shqetësime si karies, dobësim të dhëmbëve, inflamacione, etj. Në veçanti i duhet kushtuar kujdes mungesës së vitaminave dhe kripërave minerale. Shiko se cilat nga këto nuk duhet të mungojnë kurrë dhe ushqimet se ku mund t'i gësh.

**Vitamina A** - ndihmon për ta mbajtur fluide mukozën e gojës. Është e pranishme te perimet, te frutat si kajsia dhe pjepri dhe te karotat, patatet e ëmbla dhe te spinaqi.

**Vitamina C** - forcon mishrat e dhëmbëve. Burime të mira të vitaminës C janë dhe perimet dhe frutat e freskëta.

**Vitamina D** - influencon në rritjen dhe shëndetin e dhëmbëve. Është me shumicë te qumështi, por dhe te vaji i peshkut. Mungesa e saj provokon dobësimin e dhëmbëve.

**Vitamina E** - mbron nga "rrënjët e lira", pra nga plakja, indet dhe mukozat e gojës. Gjendet te vaji i sojës dhe perimet me fletë të gjelbra si spinaqi.

**Vitamina K** - është e nevojshme për mpiksjen e gjakut për të evituar kështu gjakderdhjen në mishrat e dhëmbëve. Për ta gjetur mjafton të hash rrepa, lakra dhe spinaq.

**Kalciumi** - forcon kockat dhe dhëmbët, gjendet me shumicë te qumështi, kosi, djathërat e freskët, etj.

Fosfori - është një përbërës shumë i rëndësishëm i indit kockor, i smaltit dhe i sementit të dhëmbëve. Gjendet pothuajse te të gjitha ushqimet, por në mënyrë të bollshme te mishi, peshku, frutat e thata dhe drithërat.

**Magnezi** - së bashku me kalciumin dhe fosforin është një nga tre elementet më të rëndësishëm për shëndetin e dhëmbëve. Gjendet në sasi të mëdha te frutat e freskëta, te peshku dhe te të gjitha drithërat. ■



Nis trajnimi për sistemin "TMS" edhe për zyrtarët e klubeve të Superligës së Kosovës

# Klubet trajnohen se si duhet t'i mbrojnë lojtarët e tyre

"Lojtarët e Kosovës tash e tutje do të trajtohen njësoj si futbollistët e tjerë të botës kur të ndërrojnë klubet. Edhe kjo është një rrugë që çon në drejtim të pranimi të plotë të FFK-së dhe të klubeve. Në një mënyrë është një pranim, por ne jemi të përkushtuar t'i përmbahemi marrëveshjes që kemi me FIFA-n rreth transferimit të lojtarëve dhe tash e tutje lojtarët e Kosovës janë të mbrojtur, gjë që është një arritje e madhe në këtë fazë të zhvillimeve", - ka thënë Vokri. Ditë më parë, FIFA e ka futur edhe Kosovën në sistemin e saj të transferimeve



## Dilaver POLISI

**Z**zyrtarët e klubeve të Superligës së Kosovës në futboll për një javë do të trajnohen nga zyrtarë të Federatës së Futbollit të Kosovës për sistemin "TMS", që ka të bëjë me transferimin e lojtarëve sipas rregullave të FIFA-s, ka bërë të ditur zyrtari për regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve të FFK-së, Adem Çollakaj. "Secili klub do të ketë një person të autorizuar për këtë punë, i cili është i obliguar ndër të tjera të njohë gjuhën angleze dhe punën me kompjuter", - ka thënë Çollakaj. Ditë më parë, FIFA ka futur edhe Kosovën në sistemin e saj të transferimeve.

Në fakt, Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), që nga data 10 gusht e këtij viti, është me kodin e saj në shtëpinë botërore të futbollit (FIFA) për transferimin e lojtarëve. Angazhimi i FFK-së për t'iu dhënë fund kalimeve ilegale nga klubet kosovare në ato të rajonit dhe më larg, tashmë është kurorëzuar.

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, ka thënë se lo-

jtaret e Kosovës tash e tutje do të trajtohen njësoj si futbollistët e tjerë të botës kur të ndërrojnë mjedis.

"Një delegacion i yni ishte i pranishëm në FIFA, në lidhje me sistemin e ri të transferimeve të lojtarëve nga 2 deri më 8 gusht", - ka thënë Vokri. "Lojtarët e Kosovës tash e tutje do të trajtohen njësoj si futbollistët e tjerë të botës kur të ndërrojnë klubet. Edhe kjo është një rrugë që çon në drejtim të pranimi të plotë të FFK-së dhe të klubeve. Në një mënyrë është një pranim, por ne jemi të përkushtuar t'i përmbahemi marrëveshjes që kemi me FIFA-n rreth transferimit të lojtarëve dhe tash e tutje lojtarët e Kosovës janë të mbrojtur, gjë që është një arritje e madhe në këtë fazë të zhvillimeve".

Në trajnimin që u mbajt në FIFA, nga Kosova ishte sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu bashkë me Artan Govorin, zyrtar për marrëdhënie me jashtë.

Sipas Salihut, 205 shtete anëtare të FIFA-s janë njoftuar se FFK-ja është aktive dhe sipas Salihut çdo kalim i lo-

jtareve nga Kosova duhet të ketë pëlqimin e FFK-së.

"FIFA tash e tutje do të ketë një sistem të ri i quajtur TMS (sistemi i përputhjeve), sepse do të jetë i digjitalizuar dhe duhet të ketë përputhje të të dhënave për lojtarë nga klubi që blen dhe klubi që e lëshon lojtarin për t'u pranuar nga FIFA. Klubet do ta kenë kodin e tyre të veçantë", - ka thënë Salihu. "Kjo do të jetë një punë jashtëzakonisht e vështirë, por tash e tutje jemi të obliguar t'i përmbahemi dhe prej të premtes çdo kalim i lojtarëve nga Kosova duhet të ketë pëlqimin e FFK-së".

Deri më tash, Federata ishte e pa-fuqishme për të ndalur kalimet ilegale, pasi nuk kishte mbështetjen e FIFA-s. Lojtarët përmes menaxherëve të tyre fillimisht regjistroheshin në klubet e rajonit, kryesisht në Shqipëri dhe me atë licencë më pas finalizonin transferimin në klubet ku dëshironin. Më të dëmtuarat nga gjithë ky proces ilegal ishin skuadrat që ngeleshin pa lojtarët e tyre në çdo kohë, pa paralajmërim dhe pa përfituar asgjë. ■

# Dardan Berisha i gatshëm për Kosovën në çdo kohë

Basketbollisti nga Peja, Dardan Berisha, i cili aktualisht luan për klubin polak Anwil dhe për përfaqësuesen e Polonisë, është shprehur se për Kosovën është i gatshëm të luaj në çdo kohë, nëse këtë i a lejon FIBA, pasi tani luan me Poloninë

## Alban BILALLI

**D**ardan Berisha u lind në Pejë, më 15 nëntor 1988. Si fëmijë filloi të merrej me sport. Në fillim luante futboll, për t'u marrë më vonë më intensivisht me basketboll dhe për të bërë emër më vonë në arenën ndërkombëtare. Në Kosovë ai ka luajtur për klubin Peja nga Peja. Më pas në moshën 17 vjeçare shkoi në Kroaci, te Cibona e Zagrebit. Bëri karrierë edhe në Spanjë për të kaluar në Poloni, ku është aktualisht basketbollisti i klubit të njohur polak

nin e Polonisë për eliminatoret e Eurobasketit 2011.

Në intervistën dhënë revistës sonë, ai flet për fillimet e tij të basketbollit, për largimin e tij nga Kosova në drejtim të arenës evropiane. Pastaj flet për ndeshjet e zhvilluara me fanellën e Polonisë, si dhe për dëshirën e tij për të luajtur për Kosovën.

**PAQJA: Kur keni filluar të luani për herë të parë basketboll dhe ku keni luajtur në Kosovë?**

**D. Berisha:** Së pari kam luajtur futboll. Më pas kam filluar të luaj basketboll. Aty nga moshën 12 vjeçare kam filluar të luaj basketboll më shpesh. Në moshën 14 vjeçare kam filluar të luaj profesionalisht basketboll. Në Kosovë kam luajtur vetëm për një klub, për Pejën.

**PAQJA: Kur jeni larguar nga Kosova në drejtim të klubeve evropiane?**

**D. Berisha:** Në moshën 17 vjeçare kam shkuar në Kroaci tek klubi i Cibonës të Zagrebit, ku kam qëndruar një vit e gjysmë, nga vitet 2005-2007. Në fund të vitit 2007 kam shkuar në Spanjë, te klubi i Caceres 2016. Pas 6 muajsh qëndrimi në Spanjë, jam transferuar te klubi nga Warshava Polonia 2011, ku kam qëndruar deri këtë verë. Këtë verë jam transferuar te klubi Anwil, me të cilin kam nënshkruar kontratë tre vjeçare.

**PAQJA: Për eliminatoret Eurobasket 2011, po luani në pesëshen startuese, çfarë do të thotë kjo për ju?**

**D. Berisha:** Është një kënaqësi e madhe, por edhe një arritje shumë e madhe në karrierë, sepse të luash për Poloninë si i "huaj" dhe të jesh në mesin e 12 basketbollistëve më të mirë të Përfaqësueses së Polonisë nuk është pak. Për çdo ndeshje luaj me një mesatare prej 25 minutash, shënoj pikë dhe asistoj. Trajneri e vlerëson mjaft lart lojën time.

**PAQJA: Si po e pret opinionin polak që**

*një shqiptar nga Kosova po udhëheq lojën e tyre?*

**D. Berisha:** Tifozët më përkrahin shumë. Ata thërrasin emrin tim në sallë kur luaj, por edhe jashtë saj në rrugë më përhëndesin. Mediat më vlerësojnë mjaft lartë. Ato edhe kur gaboju gjatë lojës, nuk i polemizojnë gabimet e mia. Gazetarët sportivë shkruajnë për mua si një basketbollist me një të ardhme të ndritshme.

**PAQJA: Cili është dallimi mes basketbollit në Kosovë dhe atij në Poloni?**

**D. Berisha:** Në basketbollin polak nuk ka politikë. Nuk ka llafe. Ka punë, ka organizim mjaft të mirë, si në klube, po ashtu në përfaqësuesen dhe në Federatë. Në Poloni luajnë basketbollistë mjaft cilësorë. Sidomos ata që vijnë nga Amerika janë shumë të mirë, por luajnë edhe shumë basketbollistë nga shtetet fqinje të Kosovës. Konkurrenca është shumë e ashpër, si për titull e po ashtu për mbijetesë.

**PAQJA: Nëse Kosova anëtarësohet në FIBA dhe ka të drejtë të zhvillojë ndeshje ndërkombëtare, me cilën përfaqësues do të luani?**

**D. Berisha:** Në çdo kohë dhe çdo moment jam i gatshëm të luaj për Kosovën. Por a kam të drejtë të luaj për Kosovën, pasi tash luaj për Poloninë, nuk e di. E rëndësishme është që dyert e basketbollit evropian dhe botëror të hapen për basketbollin e Kosovës. Unë kam vendosur të luaj për Poloninë ngase nuk e dija se kur Kosova do të pranohet në FIBA. Vitet po kalonin e unë nuk mund të prisja, sepse tërë jetën nuk mund të luash basketboll.

**PAQJA: Për fund çfarë do t'u thuash simpatizuesve tuaj në Kosovë?**

**D. Berisha:** Nëpërmjet revistës suaj unë i falënderoj të gjithë shqiptarët kudo që janë, për përkrahjen që po më japin. Po ashtu i porosisë të rinjtë që të merren sa më shumë me sport. ■



# PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



## AKTIVITETE NGA SHOQATAT:

Zëri Ynë - Prishtinë

\* \* \*

Zëri Ynë - Prizren

\* \* \*

Bleta - Rahovec

\* \* \*

Yvesa - Prishtinë

\* \* \*

Vizioni për Edukim, Studim dhe Avancim VESA - Mitrovicë

\* \* \*

Investimi Në Të Ardhmen INTA - Skenderaj

\* \* \*

Horizonti i Diturisë HiD- Pejë

\* \* \*

Rinia e Istogut RIN-IS - Istog

\* \* \*

Edukata - Drenas

\* \* \*

Rinia Jonë - A - Prishtinë

SHTOJCË KUSHTUAR AKTIVITETEVE GJATË MUAJIT TË RAMAZANIT



## ‘ZËRI YNË’ SHTROI IFTAR NË ‘VILLA GËRMIA’

**Jeton ISUFI**

**E**dhe këtë vit Shoqata Kulturore “Zëri Ynë”, e cila është e njohur për aktivitete të ndryshme kulturore, për nder të muajit ramazan, në fund të këtij muaji të madhërisëm shtroi iftar, në të cilin ishin të pranishëm afër 200 persona.

Në një atmosferë imponante në ambientin e restorantit “Villa Gërmia” në Prishtinë, ku edhe u shtrua iftari, të pranishëm ishin agjërues të profileve nga më të ndryshmet, duke filluar nga teologët, profesorët, publicistët, studentët, e njerëz të tjerë.

Përveç organizimeve të aktiviteteve të tjera të shumta nga fusha të ndryshme edhe organizimi i iftareve është pjesë e aktiviteteve tradicionale, të cilat Shoqata Kulturore “Zëri Ynë” i përsërit për çdo vit që nga formimi i saj.

Pajtim Gashi, student i Fakultetit Teknik, njëri



nga agjëruesit e pranishëm në këtë iftar, tha se ndihet mjaft i kënaqur që është pjesëmarrës në një iftar në të cilin janë të mbledhur persona të shumtë, të cilët kryejnë njërin nga obligimet më madhore të fesë islame, agjërimin në muajin ramazan.

“Veprat e mira janë ato me të cilat ngrihemi te Zoti ynë Fuqiplotë dhe për të cilat pa dyshim që do të shpërblehemi, ndërsa kryerja e veprave të mira në muajin ramazan është diçka për të cilën shpërblehemi shumëfish për një vepër, pasi që jemi duke kryer një nga obligimet më të dashura që mund të bëjmë për Krijuesin tonë, andaj edhe ky iftar dhe tubimi ynë këtu është ibadet në vete, përderisa shohim gjithë këto fytyra të buzëqeshura të agjëruesve, të lumtur që janë të mbledhur së bashku”, - tha Pajtim Gashi.

Të kënaqur për organizimin e iftarit ishin edhe të pranishmit e tjerë pjesëmarrës, ndërsa organizatorët, pasi falënderuan mysafirët e iftarit, thanë se Shoqata Kulturore “Zëri Ynë” edhe pas muajit ramazan do të vazhdojë aktivitete të tjera kulturore dhe etike. ■

**Zëri Ynë**  
SHOQATA KULTURORE



# Ramazani dhe Bajramet janë pjesë e pandashme e kulturës sonë shpirtërore

Ajni **SINANI**

**T**ë gjithë njerëzit para iftarit nxitojnë që të jenë në shtëpitë e tyre për të bërë iftarin me anëtarët e familjes. Disa prej tyre këtë e bëjnë edhe nëpër lokale. Kjo bën që rrugët e qytetit të jenë të boshatisura plotësisht gjatë kohës së iftarit. Çdo ditë, disa minuta para akshamit, sikurse në gjithë Kosovën, edhe në Prizren njerëzit ulen pranë sofrave dhe presin ezanin që lajmëron iftarin. Kjo atmosferë i fal gjithsecilit ndjenja dhe ndijime të thella. Po ashtu, në shtëpi dhe në të gjithë qytetin ndihet një atmosferë e veçantë.

Atmosfera fascionuese e Ramazanit bën që rrallëkush të jetë indiferent gjatë këtij muaji të bekuar. Është gati e pamundur të përshkruhet në mënyrë adekuate bukuria magjepse e syfyrit dhe iftarit dhe shkëlqimi e ndriçimi i minareve të 30 xhamive të Prizrenit nga akshami deri në jaci, madje në shumë xhami deri në sabah. Gjatë gjithë muajit, në fytyrat e të rinjve vërehet gëzimi. Falja e teravive dhe shtruarja e iftareve të përbashkëta, ligjëratat dhe ndejat e shumta kolektive janë ato që e karakterizojnë Ramazanin në Prizren, sikurse edhe në gjithë Kosovën. Ato e zbukurojnë dhe e bëjnë më madhështore atmosferën e mrekullueshme të Ramazanit në qytetin e lashtë.

R a m a z a n i është një muaj i

veçantë dhe atë e bën të veçantë agjërimi, leximi i Kuranit fisnik dhe kryerja e shumë adhurime të tjera që bëhen gjatë tij me një rigozitet më të madh. Atë e bën të veçantë edhe vetë ajo që bart kuptimi i fjalës Ramazan, që vjen nga fjala arabe remedun - që nënkupton shiun që bie në tokë të thatë. Dhe sikurse shiu që është një begati e Zotit që e ringjall tokën, edhe Ramazani është një mirësi e Krijuesit të gjithësisë që e ringjall dhe e përtërin shpirtin e njeriut.

Pikërisht për këtë Ramazani është një kohë e shkëlqyer që njeriu t'i kthehet vetes, që ai të bëjë një llogari të vetvetes dhe të rishikojë raportet e tij me Krijuesin, me familjen dhe me anëtarët e tjerë të rrethit dhe shoqërisë ku jeton.

Muslimanët gjatë Ramazanit e njohin më mirë njëri-tjetrin, janë më afër mes tyre, tregojnë më shumë solidaritet dhe i ndihmojnë ata që kanë nevojë. Ramazani, me ibadetin e agjërimit dhe abstenimit nga shumë gjëra, e kalit besimtarin që të jetë më i përgatitur dhe më i qëndrueshëm gjatë ballafaqimit me vështirësitë dhe sfidat e kohës. Besimtarët, përveç parapërgatitjes së brendshme

shpirtërore, bëjnë edhe përgatitje të tjera sikurse janë rregullimi dhe lyerja e shtëpive dhe xhamive.

Në Prizren, në të gjitha xhamitë, është falur namazi i teravisë dhe ka pasur edhe lexim të Kuranit fisnik (mukabele), kurse në një xhami është falur me hatme namazi i teravisë. Gjithashtu, çdo ditë ka pasur iftare për të varfrit, që janë shtruar nga KFOR-i turk dhe një iftar është shtruar çdo ditë nën përkujdesjen e komunës dhe të vetë kryetarit të Prizrenit. Shoqata 'Zëri Ynë' ka shtruar një iftar në xhumanë e fundit të Ramazanit, në kujtim të ditës së Kudsit, si përkujtim dhe lutje për popullin e Palestinës.

Dy xhami të reja kanë filluar të funksionojnë për herë të parë për kryerjen e faljes së namazit në fillim të Ramazanit. Ajo që është e veçantë për Ramazanin në Prizren janë simitet dhe pitajkat me vezë që i gatujnë bukëpjekësit gjatë Ramazanit. Një traditë e mirë që ka filluar këto viteve të fundit është edhe organizmi nga ana e AKEA-s i një panairi në hapësirën pranë Hamamit, ku përfshihet shitja e librave, e prodhimeve të ndry-

shme artizanale, vendosja e tavolinave për ndeja të çajit dhe kafes, si dhe shitja e ëmbëlsirave shtëpiake, paratë e të cilave janë të destinuara për jetimët dhe të varfrit. Ambienti i ngjason deri në një masë pazareve të Stambollit dhe të Kajros. ■



# “VESA” - begaton jetën shoqërore në Mitrovicë

Berat UJKANI

**M**uaji i madhërishtëm ramazan ishte karakteristik edhe në aspektin e realizimit të projekteve të ndryshme. Iniciativa qytetare, organizata joqeveritare dhe grupe të ndryshme të rinjsh ishin mjaft aktive duke participuar në implementimin e projekteve dhe realizimin e aktiviteteve të natyrave të ndryshme përgjatë gjithë këtij muaji.

Në këtë drejtim, organizata joqeveritare "Vizioni për edukim, studim dhe Avancim" – VESA, e cila vepron dhe shtrin aktivitetin e saj në qytetin e Mitrovicës, gjatë gjithë muajit të madhërishtëm ramazan ishte mjaft aktive sa i përket organizimit të aktiviteteve të ndryshme.

Qyteti i Mitrovicës, përgjatë gjithë muajit ramazan, u karakterizua nga realizimi i projekteve të ndryshme që përfshinin aspekte të ndryshme, duke filluar nga publikimet e ndryshme të karakterit edukativo-informues, iftaret e përbashkëta, takimet me studentë e deri tek aktivitetet bamirëse dhe programet e karakterit shoqëror, të cilat vetëm sa e begatuan jetën shoqërore në komunën e Mitrovicës.

“VESA” e filloi këtë cikël të realizimit të aktiviteteve të lartcekura javën e parë të muajit ramazan, duke organizuar iftarin e përbashkët tashmë tradicional me pjesëmarrjen e mysafirëve nga mbarë vendi ynë, të cilët e begatuan këtë organizim. Ky organizim përfshinte në vete një mision fisnik që konsistonte në



njohjen, si dhe në forcimin e lidhjeve mes të pjesëmarrësve. Duhet theksuar se ky organizim, pas përfundimit të iftarit, u pasua me një program modest.

Publikimet e ndryshme, përfshirë broshurat dhe shumëzimin e CD-ve të karakterit edukativo-informues, ishin pjesë e programit të tërësishëm të projekteve të realizuara nga VESA. Projekti “Margaritarët e Urtësisë” ishte vetëm një pjesë që plotësonte këtë degëzim të projekteve të OJQ-së “VESA” dhe konsistonte në publikimin dhe shpërndarjen e posterëve, të cilët përmbanin në vete urtësi nga thesari i pasur islam.

Takimi me përfaqësuesit e shoqatës së të zhdukurve me moton “Ne jemi me ju”, me rastin e Ditës Ndërkombëtare

të të Zhdukurve, si dhe dhurimi i disa pakove ushqimore për familjarët e tyre ishte aktiviteti i radhës i realizuar.

Edhe këtë vit u organizua takimi me elitën e studentëve të qytetit, të cilët vijojnë studimet në Universitetin e Prishtinës. Në një organizim të tillë merrnin pjesë studentë të të gjitha profileve të UP-së. Mysafir special në këtë takim ishte hoxha i nderuar Enis Rama, prezenca e të cilit, përkatësisht këshillat drejtuar studentëve nga ana e tij, vetëm sa e begatuan një takim të tillë.

Projektet e realizuara nga VESA vijuan me implementimin e aksionit humanitar në ndihmë bashkëqytetarëve tanë me kushte të vështira jetese “ATA KANË HISE NË PASURINË TONË”.





Pjesa përfundimtare e realizimit të agjendës së paraparë për implementimin e projekteve gjatë këtij muaji u përmbyll me organizimin e programit shoqëror-kulturor, që konsistonte në prezantimin vizual të projekteve të realizuara dhe ligjëratat përkatëse të mysafirëve specialë të programit, hoxhallarëve të nderuar, Ekrem Avdiu dhe Enis Rama. Ky organizim shënonte njëkohësisht edhe përmbylljen festive të përbushjes me sukses të planit të paraparë.

Programin e organizuar e bëri më të larmishëm një video e shfaqur, e përgatitur enkas për këtë organizim, e cila në mënyrë më të detajzuar paraqiti punën e anëtarëve të OJQ-së "VESA", gjatë muajit ramazan.

Pa dyshim ajo çka ishte shumë e rëndësishme në tërë këtë organizim ishte pjesëmarrja masive e qytetarëve e në veçanti e të rinjve, të cilët e stërbushën sallën dhe vetëm sa kontribuan në madhësinë e një organizimi të tillë.



Duke folur rreth programit të tërësishtëm të projekteve të realizuara, koordinatori i projektit "VESA-Ramazan 2010", Driton Kurti theksoi: "Ne edhe këtë vit arritëm të realizojmë një program të larmishëm të projekteve për muajin ramazan, që vetëm sa e begatuan jetën



shoqërore në qytetin tonë, duke i përbushur kështu objektivat tona dhe plotësuar një nga pikat themelore të programit vjetor të OJQ-së sonë"

"Realizimi dhe përmbyllja në mënyrë të suksesshme të këtij plani të paraparë, tregon edhe njëherë për punën e palodhshme dhe kontinuele që janë duke bërë anëtarët e kësaj organizate në drejtim të avancimit të jetës rinore në qytetin e Mitrovicës dhe kultivimit të vlerave të mirëfillta të të rinjtë", - ka thënë Kurti.

"Vizioni për edukim, studim dhe Avancim" – VESA, përfundoi me sukses edhe këtë cikël të aktiviteteve të parapara, duke begatuan kështu në përgjithësi jetën shoqërore në qytetin e Mitrovicës dhe njëkohësisht duke ju ofruar bashkëqytetarëve të vet një program të larmishëm të projekteve të realizuara karshi problemeve dhe preokupimeve të cilat janë pjesë e pandashme e jetesës në këtë qytet. ■

Ky aksion përfshinte shpërndarjen e pakove të mbushura më gjësende ushqimore dhe higjienike, për më tepër se 80 familje të qytetit tonë, për kategoritë e identifikuar në shkallën më të lartë për nevojën e ndihmës, të specifikuar si më poshtë:

- Familjet e jetimëve;
- Familjet me anëtarë të sëmurë;
- Familjet e veteranëve dhe invalidëve të luftës;
- Familjet në ndërtesën e minatorëve në Stanterg;
- Familjet me kushte jashtëzakonisht të vështira jetese.

Një iniciativë e tillë u mirëprit shumë mirë nga qytetarët dhe zgjoi interesim të madh të një pjesë shumë e madhe e tyre, të cilët treguan gatishmërinë e tyre për kontribut të vazhdueshëm në mënyrë që një projekt i tillë të realizohet në vazhdimësi.



# DUA VEND DHE HAPËSIRË TA ADHUROJ ZOTIN TIM!

## Mevludë ZEJNULLAHU

**D**itë e diel, 5 shtator. Nga ballkoni i shtëpisë, përshëndeta fqinjën time të besimit katolik. Ajo kthehej nga përrurimi i katedrales në qendër të Prishtinës, me emrin e Nënë Terezës. Ky përrurim i katedrales u bë në kuadër të veprimtarive me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Nënë Terezës.

Gurthemeli i kësaj katedrale katolike u vu në vitin 2005, në hapësirën e Gjimnazit "Xhevdet Doda".

Fqinja ime ishte e lumtur dhe më tregonte se katedralja ishte e ndërtuar shumë mirë, kishte hapësirë të madhe dhe gjithçka ishte rregulluar dhe menduar në mënyrë të përsosur për besimtarët katolikë.

E dëgjova me vëmendje dhe biseduam ca minuta aty, edhe pse nuk mundëm të pimë kafe së bashku, pasi që unë isha duke agjëruar.

Në muajin e bekuar ramazan, besimtarët muslimanë përjetojnë një lloj këndellje shpirtërore.

Në 10 ditët e fundit të muajit ramazan në Xhaminë e Madhe në kryeqytet falej edhe namazi i natës, i njohur si namaz vullnetar - nafile.

Zakonisht në këto net, nga ora 24:00, i lija të gjitha obligimet e mia të përditshme, si lexim dhe shkrim për t'i bërë ibadet Allahut.

Edhe në natën e 27-të të këtij muaji, 10 minuta para orës 24:00 arrita në xhami.

Nga larg pashë turma të besimtarëve që prisnin në radhë për të hyrë brenda. Por më kot. Xhamia e Madhe (e cila vetëm quhet ashtu, nuk i zë brenda as besimtarët e rregullt) ka edhe oborrin

e vogël. Asnjëherë nuk ka kapacitet për t'i pranuar ata që dëshirojnë të hyjnë brenda rrethojave, prandaj besimtarët dalin edhe në rrugë.

Derisa secili mendohej të gjente një vend të vockël për vete, muezini filloi ta thërrisë ezanin. Zuri vend kush zuri, e hyri kush hyri, falja e namazit filloi.

Mua e shumë të tjerëve na mbetën vetëm dy zgjidhje, të faleshim në rrugë ose të ktheheshim në shtëpi.

Nuk doja të kthehesha pa u falur dhe ta humbisja vlerën dhe peshën e asaj nate, andaj zura vend larg oborrit të xhamisë, afër disa veturave të parkuara në skaj të rrugës.

Derisa largoja me dorë disa gurë, letra e mbeturina të tjera nga vendi, të cilin e gjeta të lirë, një njeri i moshuar që rrinte te dera e xhamisë më solli një copë batanije për t'u falur në të.

Për një çast ktheva kokën mbrapa. Pas meje ishin radhitur shumë femra të moshave të ndryshme.

Pa menduar më tej, u lidha në namaz. Harrova që isha në rrugë, harrova që nata filloi të ftohej, harrova që nën batanije kishin mbetur ca gurë dhe kur bija në sexhde ata "puthnin" fytyrën time. Harrova gjithçka dhe tek e fundit kjo është madhështia e namazit, kontakti me Krijuesin dhe përkushtimi ndaj Tij.

Të nesërmen duke dalë nga shtëpia, takova fqinjën time. Pas përshëndetjes së zakonshme, shpejtova hapin. Nuk doja ta ndjeja gjykimin e saj mbi atë se pse atyre u krijohen mundësitë për t'ua mbajtur fenë e tyre e neve jo. Thjesht të mos krijohej në psikikën e saj 'a priori' bindja se ne jemi specie e veçantë, jashtëtokësorë, të trajtuar nga tokësorët e pushtetit tonë si 'non grata'.

Kisha frikë se ajo do të gjykonte se çfarë jemi ne, që shteti nuk na plotëson nevojat dhe kërkesat elementare. T'i thosha se edhe kështu nuk jemi keq dhe ndihemi të lumtur, do ta gënjeja. T'i thosha se komuniteti musliman është shumicë dhe do të duhej që t'i plotësoheshin kërkesat fillimisht atyre, ndoshta do të ofendohej. Kështu që vendosa të largohem, gjithnjë duke i kujtuar vetes që jam duke agjëruar.

Duke ecur rrugëve të kryeqytetit mendimet e mia më rëndonin shumë më tepër kokën sesa dielli i këtij shtatori. Derisa muaji ramazan po shkon dhe po përcillet me mot të nxehtë, nëse nuk ndërtohet një xhami që do t'i plotësojë nevojat tona, çfarë do të bëhet me ne në të ardhmen. Pastaj si do t'u bëjmë ballë temperaturave të ulëta gjatë dimrit e të falemë në rrugë?

Në kohën në të cilën po jetojmë është turp të mos kemi kushte e vend për t'u falur.

Është turp si qytetarë të barabartë të këtij shteti të përjetojmë ndasi aq të dukshme e fatkeqësisht nga vetë pjesëtarët e besimit tonë. Të gjithë ata duhet ta kenë parasysh e ta kujtojnë se nëse ata vetë nuk kanë "kohë" t'i bëjnë sexhde Allahut, baballarët e gjyshërit e tyre i kanë parë dhe i mbajnë mend shumë mirë duke e bërë një veprim të tillë.

Do të doja t'ua kujtoja të gjithë atyre që kanë bllokuar këtë çështje, mos të frikësohen nga ndërkombëtarët sepse ata lirshëm e praktikojnë fenë e tyre, ata nuk turpërohen nga feja e tyre, ata nuk mohojnë fenë e tyre. E pikërisht për këtë, ata janë ata që janë, e këta tanë janë këta që janë.

E, këta Allahu i udhëzofte!





## LUTJE PËR SOLIDARITET NË XHAMINË “KADIRI”

**Bujar ISMA**

**M**e rastin e përfundimit të muajit të shenjtë ramazan, pas gjithë asaj sakrifice, besimtarët muslimanë të Rahovecit shënuan kulmin e gëzimit dhe lumturisë në familjet e tyre në festën e Fitër Bajramit.

Në fjalimin e tij drejtuar xhematit, Adnan Pallqa, imam i xhamisë “Kadiri”, i përgëzoi besimtarët për këtë festë të madhe, duke lutur Zotin për pranimin e agjërimit dhe lutjeve të muslimanëve gjatë tërë muajit ramazan, si dhe për festën e Bajramit.

Ai theksoi se besimtarët muslimanë gjatë këtyre ditëve janë më të fortë se kurrë në besimin e tyre.

Sa i përket solidaritetit, Pallqa tha që pikërisht këto janë ditët kur njerëzit duhet të solidarizohen mes vete, që shtresa e lartë t’i ndihmojë shtresës së varfër duke ia shtrirë dorën e mirësisë njeri-tjetrit, në mënyrë që të tregohen më të devotshëm dhe që ta arrijnë kënaqësinë e Zotit.

Në anën tjetër, nuk munguan aktivitete e shoqatave dhe organizatave të ndryshme nëpër Kosovë. Ndërkaq shoqata kulturore ‘Bleta’ në Rahovec, përveç iftarit të përbashkët që mbajti më 3 shtator, gëzoi gjithashtu edhe 15 familje muslimane me pako ushqimore për nder

të festës së Bajramit të Madh. Kryetari i kësaj shoqata, Jahja Hondozi, theksoi se kjo traditë do të vazhdojë çdo herë dhe ka shprehur dëshirën që për Bajramin e ardhshëm ky numër pakosh të dyfishohet.

Edhe qytetarët u shprehën të gëzuar me rastin e kësaj feste. Ata urojnë që të

presin edhe shumë bajrame të tjera, me shpresën që Zoti t’ua ketë pranuar agjërimin dhe lutjet. Ata, gjithashtu, bëjnë thirrje që të gjithë t’ia shtrijnë dorën njeri-tjetrit, me qëllim që në këto ditë feste të mos ketë hidhërim dhe kjo mirësi të vazhdojë edhe në ditët në vijim. ■





# Iftar për shkëmbimin të përvojave

**Liridon JAHAJ**

**O**JQ-ja 'RIN-IS' në Istog organizoi një iftar të përbashkët, ku morën pjesë shumë të rinj. Ishin mbledhur rreth 60 veta, në mesin e të cilëve kishte shumë hoxhallarë nga komuna e Istogut. Pritjen në këtë iftar e bëri drejtori i 'RIN-ISit', Agron Rexhaj, i cili ishte edhe nikoqir i këtij organizimi. Ky iftar kishte për qëllim afirmimin e vlerave të bekuara të muajit të bekuar të Ramazanit dhe njëkohësisht shkëmbimin e përvojave të ndryshme të marra nga aktivitetet e shumta të organizuara në gjithë Kosovën, por edhe jashtë saj. ■





# RAMAZANI MUAJ I MËSHIRËS

**Arber ZEKA**

**S**i në çdo vend dhe cep të botës, muaji i festës dhe gëzimit në komunën e Skenderajt u prit në një atmosferë të këndshme. Nuk munguan aktivitetet e shumta promovuese. Organizata joqeveritare "Investimi në të Ardhmen" organizoi tribunë islame me titullin "Njeriu, Arsyeja dhe Qëllimi", pjesë e së cilës ishte edhe një program i pasur artistik me recitues Kurani dhe ilahish. Jo pak njerëz shfaqën interesimin e tyre të ishin pjesë e këtij organizimi, siç e cilësuan disa nga pjesëmarrësit: "përkujtimi i gjërave sjell dobi", duke aluduar te ligjëratat e mbajtur me të njëjtin titull nga hoxha i nderuar Enis Rama.

Siç është bërë traditë, shtrimi iftareve nga OJQ "INTA" nuk mungoi as në këtë vit. Secili nga mysafirët e ndryshëm kishte të veçantat e veta. Sigurisht se nga të veçantat ka edhe më të veçanta. Ajo që duhet dalluar ishte iftari i shtruar për 250 veta, pjesëmarrës të së cilit

ishin kryesisht kujdestarë jetimësh dhe jetimët, ku edhe u shpalo programi i OJQ-së "INTA" para zyrtarëve komunalë dhe strukturave të tjera të komunës, për aktivitetet që zhvillohen në këtë pjesë të shoqërisë. Dhe natyrisht e veçanta e kësaj mbrëmje ishte shpaloja e një programi artistik para të pranishmëve, të përgatitur enkas për këtë rast nga vetë jetimët.

Po mbi të gjitha, ajo që më së shumti e dallon këtë muaj, është hareja si në asnjë muaj tjetër. Laramania e punëve të mira nga njerëzit që dallohen për humanitet tregohet enkas në këtë muaj, duke pasuar parasysh se një gjë të tillë e ka vepruar edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. OJQ "INTA" ka bërë shpërndarjen e më shumë se 100 pakove ushqimore, ku vlera e një pakoje sillet rreth 35 euro. Kësaj, sigurisht, ju gëzuan shumë familje skamnore.

Ndër risitë e shumta të aktiviteteve të OJQ-së "INTA", gjatë këtij muaji, duhet të përmendet shpërndarja e fletushkave

të shumta për ramazanin dhe për probleme të tjera jo të njoftuara në mes të shoqërisë. Në këtë drejtim, po ashtu, u shpërndanë edhe një numër i madh CD-sh, në të cilën është përfshirë një ligjëratë nga hoxha Bekir Halimi, me titullin "Si ta presim Ramazanin".

Ndër të tjera, për t'u solidarizuar me muslimanët e mbarë botës, OJQ "INTA" ka bërë shtrimin e një iftari, nën moton "Lutjet dhe duatë tona të këtij muaji ia dedikojmë popullit palestinez", si përkujtim për të gjithë muslimanët, vëllezërit dhe motrat tona në katër skajet e botës, me dëshirën që të paktën një dua t'ua dedikojmë atyre.

Kështu OJQ "INTA" i përmbylli aktivitetet e saj nën parullën se: Duke qenë se Ramazani është muaji që sjell më së shumti mëshirë, atëherë le t'i shohim muslimanët të mëshirshëm ndaj njëritjetrit dhe të bashkuar si kurrë më parë nën qëllimin e vetëm, nënshtrimin ndaj Krijuesit të gjithçkaje. ■

# Mediat dhe Ramazani

**Gëzim QERIMI**

**M**uaji i bekuar ramazan është një nga obligimet më madhështore islame, i cili nuk bën jehonë vetëm në mesin e muslimanëve. Është e pamundur që të gjesh një shoqëri që në fillim të këtij muaji të adhurimit, nuk aktualizohet nga mediat e të mos marrë vesh bota anembanë se ka filluar muaji i agjërimit për muslimanët.

Nisur nga karakteri i këtij muaji të bekuar, edhe në Kosovë shtohen aktivitetet në ramazan. Nëpër xhami, në muajin ramazan angazhohen më tepër hoxhallarë me qëllim që të rritet edhe cilësia e ligjëratave. Duhet të përmenden me theks të veçantë vizitat e disa ligjëruesve nga vende të ndryshme, që në fakt tregojnë për bashkëpunimin e frytshëm të hoxhallarëve. Me qëllim të begatimit të jetës fetare në këtë muaj të rëndësishëm, organizohen edhe iftare, ku në veçanti prezantojnë të rinjtë, organizohen tribuna fetare dhe bëhet shpërndarja e një sasive të konsiderueshme të literaturës fetare. Rëndësi e veçantë në këtë muaj i është kushtuar edhe ngritjes fetare të femrave dhe për këtë qëllim nëpër xhami organizohen ligjëratat për femra nga teologe të ndryshme.

## Mbulesë e vogël mediale për Ramazan

Në vitet e gjashtëdhjeta, themeluesi dhe paraardhësi i idesë për mediat na ka paralajmëruar për ekzistencën e “teknologjisë elektronike” dhe mundësinë e saj që të bëhet “sistemi ynë qendror nervor”. Ai ka paralajmëruar se mediat janë duke u bërë porosia e vetme e mundshme. Media e kohës sonë, shikuar nga aspekti i ndikimit që ushtrojnë mbi ne, kapacitetit të tyre për ndryshimin e fakteve, konsiderohen si pastrim i trurit për qytetarët e Kosovës, absolutisht i fuqishëm dhe i pranishëm dhe, në realitet, shkaktar i ekzistimit të “frymës” dominante të kohës së postmodernizimit.

Në Kosovën e pasluftës hapet televizioni i parë publik i Kosovës, i quajtur RTK, për të cilin menduam se do të jetë një medium i lirë, pa anime, i drejtë dhe korrekt, medium i të gjitha dëshirave të qytetarëve të Kosovës, por kjo nuk ndodhi tash e disa vjet. Kjo që menduam ishte vetëm një ëndërr e mirë. Gjithashtu, men-

themi se vazhdon të mbetet shumë larg plotësisht të programit të saj, ku do ta gjenin veten të gjithë qytetarët e saj, pa dallim feje, moshe, gjinie a kombësie. Fatkeqësisht ky diskriminim i RTK vërehet më së shumti në raport me fenë islame e gjithashtu edhe me mos hapësirën e duhur për muajin ramazan.

themi se vazhdon të mbetet shumë larg plotësisht të programit të saj, ku do ta gjenin veten të gjithë qytetarët e saj, pa dallim feje, moshe, gjinie a kombësie. Fatkeqësisht ky diskriminim i RTK vërehet më së shumti në raport me fenë islame e gjithashtu edhe me mos hapësirën e duhur për muajin ramazan.

## KTV, RTV21 injorojnë muajin e bekuar ramazan

KTV dhe RTV21, vazhdimisht që prej themelimit të tyre, vazhdojnë ende misionin e tyre karshi Islamit dhe përfshirjes së tij në skemën programore. Për më tepër i ngjasojnë kohës së regjimit jugosllav, por si duket ka rastisur që kompania më e madhe mediale në Kosovë ‘Koha’ të drejtohet nga i njëjti njeri që në atë kohë kishte themeluar Lidhjen Demokratike të Jugosllavisë, Veton Surroi, komunisti i atëhershëm, projekti politik i të cilit dështoi që në fillim, por vazhdon përmes mediave me mjaft sukses.

Dallimi i KTV-së dhe RTV21-së prej TV-ve të ish-Jugosllavisë dhe mentalitetit komunist është se me gjithë atë ka një liberalizim të skemës programore të këtyre dy kanaleve televizive. Në këtë kontekst mund të themi se në shumicën e mediave elektronike dhe të shkruara të Kosovës, e në veçanti në kompaninë mediale Koha dhe të RTV21 mund të shohësh gjithçka, përveç tematikës islame. Përrjashtim ka në disa raste të rralla, atëherë kur është ndonjë datë për t’u shënuar jepet ndonjë emision, ta zëmë për festën e Bajramit.

Është për t’u habitur fakti se pse disa

## Ramazani dhe RTK -ja

RTK-ja e sotme, karshi Islamit dhe përfshirjes së tij në skemën programore, pothuajse është e njëjta TVP, e kohës komuniste. Për më tepër, deri para një viti i njëjti njeri ka qenë udhëheqës, z. Agim Zatriqi, komunisti i atëhershëm, mbetje në kohën demokratike. Por me ardhjen e drejtorit të ri të RTK-së z. Sylejman Shaqirit gjerat kanë ndryshuar për së miri, së paku në Ramazan.

Për dallim nga ramazani i kaluar, ku RTK-ja bënte injorimin total të aktiviteteve të Ramazanit, madje shpeshherë programet e saj në kohë iftari dhe syfyri kanë qenë provokuese dhe nënçmuese për besimtarët islamë. Këtë ramazan, fatbardhësisht, RTK-ja ka bërë një lëvizje shumë të vogël në skenën e saj programore, duke organizuar disa emisione dhe debate të drejtpërdrejta më hoxhallarë të Bashkësisë Islame të Kosovës. Vlen të theksohet emetimi i dokumentarit ‘Ramazani ndër vite’ si dhe emetimi i programit argëtues me rastin e festës së Fitër Bajramit.

RTK duke qenë transmetues publik dhe i financuar nga vetë ne, mund të



prijës fetarë, në rastet kur ftohen në emisione (që janë të rralla), për festën e Bajramit ose për festa të tjera me rëndësi të veçantë, nuk e shfrytëzojnë rastin, që të bëjnë thirrje publikisht që të ketë më shumë hapësirë për emisionet fetare.

Islami është në fokus vetëm për ndonjë ditë Bajrami ose atëherë kur është në shënjestër ndonjë polemikë absurde, siç ishte rasti i Marinës, ose pluhuri i madh që u ngrit për arrestimet në Prizren e Mitrovicë, por që opinioni nuk u informua fare pas u liruan të gjithë të arrestuarit. Për gjëra që janë esenciale për publikun shqiptar as që mund të flitet. Ky vend ka pak njohuri për Islamin, ngase periudha komuniste në të cilën kaloi, synonte që çdo gjë fetare ta përdhunonte, ta shkatërronte dhe ta zhdukte. Këtë praktikë, me krenarinë e tyre injorante, vazhdojnë ta bëjnë shumë media në Kosovë.

KTV-ja dhe RTV21 jo vetëm që nuk emeton ndonjë emision fetar, por është paradoks që në ditën e festës së Bajramit, shpeshherë këto dy medime televizive nuk bëjnë hapjen e programit gjer në mesditë. Pse e bëjnë këtë vetëm ata e dinë! Ndoshta festat më të mëdha islame - festat e Bajramit për ta mund të konsiderohen edhe si dite zie.

### Hapësira të reja programore për Fenë Islame

Peace TV është kanali më i dashur dhe më i begatshëm fetar, ku qytetarët e Republikës së Kosovës kanë mundësinë të mësojnë më shumë për fenë e tyre të cilës i përkasin mbi 98% e qytetarëve. Edhe pse me plotë të drejtë themi që ky është projekti më i madh që është bërë deri më tani në dobi të besimtarëve islam dhe që deri me tani është pritur jashtëzakonisht mirë nga tele-shikuesit, fatkeqësisht si gjithmonë dikujt e mira dhe e dobishmja i duket e keqe dhe e dëmshme. Fjala është për IPKO-në e cila e quan veten kompania e telekomunikacionit me rritjen më të shpejtë në Evropë dhe gjithashtu bën shpërndarjen e rr-

jetit kabllovik në Kosovë. Kjo kompani deri me tani nuk ka pasur as vullnetin më të vogël, që përkundër kërkesave të shumta drejtuar stafit menaxhues, të fusë në rrjetin kabllovik edhe Peace TV. Qytetarët kur kanë mundësi sanksionimi të medieve të pandërgjegjshme duhet ta bëjnë këtë, sepse vetëm kështu mund ta vetëdijesojnë mentalitetin e tyre.

Për dallim nga televizionet kombëtare, televizionet private në disa qendra të Kosovës emetojnë programe të ndryshme fetare, të cilat janë shumë të shikuara nga tele-shikuesit kosovarë.

Televizionet lokale i dhanë hapësirë shumë më të madhe emisioneve fetare, për dallim nga televizionet kombëtare.

Në qendra të ndryshme të Kosovës emetojnë shpesh emisione fetare, veçmas gjatë muajit ramazanit. Janë për t'u lavdëruar: RTV "Besa" i cili u jep hapësirë emisioneve fetare brenda vitit, e posaçërisht gjatë muajit ramazan, duke emetuar emisione speciale për festa fetare, duke përfshirë shumë emisione si: garat në këndimin e Kuranit, ilahi (këngë fetare), biseda me mysafirë të ndryshëm nga Tetova, Prishtina, Presheva etj. Gjithashtu edhe televizioni "Iliria", pastaj televizioni i Dukagjinit, i cili në veçanti gjatë muajit ramazan i kushton vëmendje të posaçme emisioneve fetare.

Prapë është për t'u habitur fakti se radiot lokale i japin më shumë hapësirë sesa radiot që mbulojnë tërë territorin e Kosovës.

-Mediat e shkruara në Kosovë janë mediat të cilat i japin më së pakti hapësirë Islamit. Mediat e shkruara kosovare i japin hapësirë Islamit vetëm për Ditën e Bajramit ose ndonjë komunikate të BIK-ut. Me përjashtim të gazetës Epoka e Re, e cila sadopak, kohë pas kohe, jep hapësirë.

Në gazetën kosovare temat fetare pothuajse mungojnë plotësisht, përveç ndonjë skandali ose ndonjë fyerje ndaj Islamit ose propagande, si p.sh shprehje si terrorizëm islamik, etj.

Gazeta "Bota sot" jo që nuk boton ndonjë temë me karakter islam, por është gazeta e vetme e cila shumë herë nuk boton as komunikatat e BIK-ut, si dhe gjatë muajit të bekuar të Ramazanit vazhdimisht shkruan për katolicizmin si dhe tema që fyejnë muslimanët.

Në Kosovë botohen disa revista islame, pastaj vijnë edhe disa nga Maqedonia dhe Shqipëria, siç janë Familja, Vepra, Albislam, mirëpo këto revista kanë një shitje solide dhe rrallëherë i shoh të ekspozuara me gazetën e tjera ditore e javore në kioskat anekënd Kosovës.

Ky diskriminim kaq i madh që i bëhet Islamit dhe muslimanëve në Kosovë nga mediat besoj se nuk do të vazhdojë edhe më tutje, sepse është në dëm të tyre, në dëm të muslimanëve dhe në dëm të Kosovës, përndryshe besoj nëse gjendja nuk ndërron për të mirë, qytetarët do të protestojnë bindshëm dhe nuk do t'i përgjigjen ftesës për t'u bërë shikues dhe lexues të tyre. ■



# Aktivitetet gjatë Ramazanit edhe në Drenas



## Leturim GRUDA

**O**.J.Q. "EDUKATA", e cila ka organizuar deri më tani me dhjetëra aktivitete brenda dhe jashtë komunës së Drenasit, me rastin e festës së Fitër Bajramit organizoi një pritje madhështore të kësaj feste në sheshin e qytetit të kësaj komune. Edhe gjatë muajit Ramazan kishte mjaft organizime në këtë komunë nga organizata të ndryshme dhe nga xhamatet e xhamive të ndryshme të kësaj komune. Vlen të theksohen iftaret e mbajtura në xhaminë e Zabelit, e cila ka një xhamat kryesisht të përbërë nga studentë të dalluar të kësaj komune, të cilët po japin një kontribut shumë të çmuar në ngritjen fetare dhe kulturore të komunës së Drenasit. Rinia studentore e O.J.Q. "EDUKATA" ka planifikuar që në ditët në vazhdim t'i intensifikojë përpjekjet që ta mbushë vakuumin e krijuar nga mungesa e aktiviteteve kulturore, edukative dhe sportive në këtë komunë. ■



# Sfida me vetveten përballë diturisë

Zgjuarsia është një dritë hyjnore, ndriçimi i së cilës ndrit jo vetëm sipërfaqen e sendeve, por edhe brendinë e tyre. (S. Frashëri)

## Sahadete SOPJANI

**N**ë shumë vende të botës mendohet se kuizet e diturisë janë shumë të ushqyeshme për trurin e njeriut, duke marrë parasysh se sa të famshëm janë si p.sh, kuizi “Kush do të bëhet milioner”, kuiz ky që të famshëm nuk e bën vetëm çmimi që ka për të dhënë, se sa e bëjnë të famshëm pyetjet të cilat e përbëjnë.

Në Prishtinë, gjatë muajit ramazan, më 30.08.2010, OJQ “Yvesa” organizoi kuizin e diturisë me rreth 900 pyetje të lëmenjve të ndryshëm shkencore, si nga lëmi i biologjisë, historisë, kimisë, juridikut, ekonomisë, letërsisë, artit, religjionit, matematikës dhe fjalëve të urta. Konkurrimi ishte i hapur për një kohë të gjatë dhe interesimi ka qenë i lartë. Qëllimi i këtij kuizi ka qenë bashkimi i të rinjve në një tubim interesi që mund të përfitohet si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ana materiale. Ky kuiz ka filluar të bëhet traditë për OJQ “Yvesa”, meqë kjo është hera e dytë që kjo organizatë organizon diçka të tillë, edhe pse këtë vit pjesëmarrës kanë qenë vetëm femrat, përkundër vitit të kaluar, ku dyert ishin të hapura për të gjithë. Një pjesë tjetër e rëndësishme të ky kuiz ishte që pjesëmarrëset duhet të ishin studente ose nxënëse të shkollës së mesme, me qëllim inkurajimi, por edhe lehtësimi, për çmimin që do të merrnin për punët e tyre të përditshme studimore! Shpërblimi

ka qenë shumë modest, gjithsesi i këndshëm në krahasim me jetën ekonomike në Kosovën.

Kuizi është mbajtur në zyrën e OJQ “Yvesa”, ku është zhvilluar një garë e fortë mes tri finalisteve të kuizit dhe pas kësaj gare, që zgjati gati dy orë, dolën edhe fitueset. Vendin e parë e zuri Valentina Alloqi, vendin e dytë Adlie Morina dhe vendin e tretë Zerina Loxha.

Pjesëmarrëset e kuizit u ftuan në një iftar të shtruar më 03.09.2010 në restorant “Villa Gërmia”. Aty, në mënyrë solemne, u ndanë shpërblimet për fitueset e kuizit.

Vendi i parë u shpërblye me 200 euro, vendi i dytë me 100 euro dhe vendi i tretë me 50 euro. Përveç kësaj, Shoqata Kulturore “Zëri Ynë” për fitueset ndau libra në shenjë dhurate.

Tubimi i këtyre të rejave ka qenë shumë i dashur dhe shumë i mirëpritur. Kënaqësia e pjesëmarrjes së tyre në atë takim shihej qartë në sytë e këtyre të rejave, duke shkëlqyer nga dëshira për të sfiduar veten dhe njohuritë e tyre.

Është për t'u habitur se sa këndshëm është të ndihesh në rrethin e njerëzve që e dashurojnë dijen dhe që për bashkudhëtar të jetës së tyre kanë librin. Nganjëherë kur jeta të ngatërron nën thumbat e saj në qorrsokakë të ngurtë, pa shije dhe pa aromë të mirë, libri është ai që të bën të shpresosh për një botë më të ndritshme, duke bërë ta dashurosh jetën ashtu si është. ■



# 'PAQJA STUDENTORE' MENDON PËR STUDENTËT EDHE GJATË VERËS

**Hekuran AVDYLI**

**O**rganizata 'Paqja Studentore' e Universitetit të Prishtinës, në dhjetëditëshin e parë të muajit ramazan, organizoi një iftar për studentët e Universitetit të Prishtinës, në të cilin morën pjesë afër gjashtëdhjetë studentë. Ky iftar u shtrua në ambientet e restorantit "Kalliri i Mirësisë", në Prevallë të Prizrenit.

Sipas Lavdim Gashit, kryetar i 'Paqes Studentore', qëllimi i mbajtjes së këtij iftari ka qenë tubimi i studentëve në kohën kur ata pushojnë, pra, në gusht.

"'Paqja Studentore' e sheh si të domosdoshme dhe të arsyeshme të punojë për studentët jo vetëm para zgjedhjeve, por edhe gjatë gjithë vitit. Edhe organizimi i këtij iftari është bërë me qëllim të relaksimit të studentëve të cilët agjërojnë, duke u dhuruar një iftar në ambientet perfekt të Alpeve Shqiptare në Prevallë", - tha Gashi.

Studentët arritën në Prevallë një orë para iftarit, me ç'rast kishin kohë edhe për një shëtitje

në natyrën e bukur të Prevallës.

Fitore Bajraktari, studente e Fakultetit të Mjekësisë, tha se organizimi i këtij iftari është diçka shumë e qëlluar nga Paqja Studentore.

"Ndihej shumë e lumtur që mund t'i shohë shoqërinë dhe kolegët e mi studentë në ramazan, ndërsa organizatorët i falënderoj shumë dhe them se organizime të tilla si ky i iftarit janë dëshmi se Paqja me të vërtetë mendon për studentët e jo për interesa të ulëta" - tha Fitore Bajraktari.

Për 'Paqen Studentore' ky nuk ishte iftari i parë, pasi që organizime të tilla iftaresh ka pasur edhe vitet e kaluara.

Organizimi i sivjetmë vjen edhe si një detyrim shtesë i kësaj organizate për të bërë më shumë për studentët e Universitetit të Prishtinës, studentë të cilët me votat e tyre bënë që kjo organizatë, në zgjedhjet e fundit studentore, të dalë si më e votuara, duke dëshmuar kështu edhe përkrahjen dhe shpërblimin e studentëve për punën e bërë nga organizata 'Paqja Studentore'. ■



# Monologu që zuri vendin e parë

**Besiane GASHI**

**O**JQ "Horizonti i Diturisë", me rastin e muajit të madhërisëm ramazan, organizoi një konkurs me monologë me temën: "Muaji i madhërisëm ramazan". Ndërsa me datë 7 shtator me anë të një aktiviteti solemn në Kinoteatrin "Jusuf Gërvalla" në Pejë është shpallur edhe rezultati nga komisioni vlerësues. Vendi i parë i takoi Besianë Gashit, vendi i dytë Liridon Lajqit, ndërsa vendin e tretë e zuri Enis Musa. Të tri vendeve të para shpërblimet ua ndau drejtori i OJQ "Horizonti i Diturisë", z. Gzonit Salihaj.

## Muaji i shenjtë ramazan!

Jam përmalluar o Zot, jam përmalluar  
si fëmija për gjirin e nënës  
Ty për të të madhëruar  
nën dritën e bardhë të hënës!

Ja sërish u hap porta e ramazanit për mua. Miku im zdrukthëtar është i gatshëm për të më gdhendur.

U bë një vit që nga takimi i fundit me të. Sa faqe jetë janë shkruar gjatë kësaj kohe dhe sa ditë e net janë shpenzuar më së miri e tregon lëvizja e akrepave të orës që ngjason me tiktaket e zemrës, të cilën e kam burgosur me sëmundje...

Por ajo akoma është gjallë! Kur dëgjoi thirrjen për agjërim, u drodh në kraharor nga nderi që i bëri Krijuesi i saj.  
Bashkë me të u nderua edhe toka, mbi të cilën në këtë muaj të shenjtë zbresin melaiket e paqes, sikurse pikat e shiut nga qielli.

KY ËSHTË DETI I MËSHIRËS. PËRGËZIM PËR KËRKUESIT E MARGARITARËVE!

Sapo u zhyta në të o Zot, ndjeva një lehtësi të madhe sikur ai që pastrohet pas një kohe të gjatë.

Me këtë ndjenjë freskie po lundroj e lumtur përgjatë ditëve të numëruara.

Devotshmëria është barka ime. Rejjani stacioni im!

Valë pas vale mëkatet u shkrin në lot e istigfar, pendimi në namaz e meditim, duart në sadaka e vëllazëri, fjalët në dhikër e tesbih dhe jeta në punë e adhurim.

E veshur me petkun e dashurisë hyjnore i jam afruar bregut të detit e çliruar nga çdo robëri. Më e lirë se zogu në fluturim hapëroj e etur drejt pedestalit të virtyteve të bukura për ta marrë shpërblimin e ripërtëritjes shpirtërore.

Zemra e përjetoi miraxhin mirupafshim, o muaj i bekuar, ti më dhe mesazhin më të ndritur e më të çmuar:

Të jetoj me vlerat e Kuranit ta shijoj ëmbëlsinë e imanit dhe në çdo punë të mbarë të jem përherë në saf të parë.

Nga ramazani në ramazan  
nefsin tim ta bëj kurban  
ME ALLAHUN NË TAKIM  
SOT  
NESËR  
DHE GJER NË AMSHIM!

Nën Patronatin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë

**OJQ "HID"**  
**Organizon**  
Konkurs për Monologje

**Tema: MUAJI I SHENJTË I RAMAZANIT**

Konkursi është i hapur deri më datë: 01.09.2010  
Të gjithë të interesuarit monologjet mund t'i dërgojnë në email:  
horizontiditurse@gmail.com

Tri monologjet më të mira do të shpërblehen!

Për çdo informatë mund të kontaktoni në tel: 044 455 221,  
email:horizontiditurse@gmail.com, ose drejtpërdrejt në zyrë të  
OJQ "Horizonti i Diturisë", Rr. Ali Hadri, Nr. 6, Pejë, prej orës 14:00 - 16:00.



# PRAKTIKA TË MIRA SHËNDETË

**Iliriana ALLOQI &  
Bernard TAHIRBEGOLLI**

**A**gjërimi i ramazanit ka dobi shpirtërore, fizike, psikologjike dhe sociale. Megjithatë mund të paraqiten probleme “artificiale” nëse agjërimi nuk praktikohet si duhet. Para së gjithash, nuk ka nevojë të konsumohet ushqim i tepërt në iftar ose syfyf.

Meqë Ramazani bie në periudha të ndryshme të vitit, për shkak të dallimit mes kalendarit lunar dhe atij gregorian, edhe problemet shëndetësore që mund të paraqiten janë të ndryshme. Ndërsa gjatë stinës së dimrit problemet kryesisht janë me kequshqyerjen, ushqimin e tepërt dhe gjumin e pakët, në stinën e verës këtyre problemeve iu shtohen edhe dehidrimi dhe hipoglikemia. Që të gjitha këto, zakonisht, ndodhin për arsye të mungesës së shprehive të mira jetësore dhe mosadaptimit me agjërimin.

Nganjëherë probleme të ngjashme paraqiten edhe te një kategori tjetër e njerëzve, që kanë sëmundje të ndryshme e të cilët kanë dëshirë të agjërojnë.

**Islami ka alternativa edhe për situata specifike si këto të mësipërmet** (Kuran 2: 185).

Këshilla për të gjithë ata që lëngojnë nga ndonjë sëmundje dhe që duan të agjërojnë është që të konsultohen me mjekun për gjendjen e tyre shëndetësore dhe mundësitë e trajtimit të mëtutjeshëm të sëmundjes.

Në një hulumtim të bërë në Kuvajt është gjetur se 60% e pacientëve të hospitalizuar e kanë ndërruar vetë marrjen e terapisë, gjë e cila pa konsultim të mjekut mund të shkaktojë probleme edhe më të mëdha. Disa medikamente, nëse merren në mënyrë të çrregullt, mund të ndikojnë në rritjen e rezistencës së mikroorganizmave ndaj tyre, të tjerave u mbaron koha e veprimit dhe efektet që është dashur t'i japin i kanë për kohë shumë të shkurtër dhe praktikisht problemet, më pas, mund të rriten edhe më shumë.

**Zoti nuk ngarkon tej mundësi** (Kuran En'am, 152)

Disa sëmundje të caktuara mund të trajtohen me disa grupe barnash, kështu që mjeku në bazë të rrethanave mund t'u rekomandojë ndërrimin e terapisë dhe marrjen e një terapie vetëm dy herë në ditë nëse është e nevojshme.

Agjërimi është një trajtim i efektshëm për çrregullimet psikike dhe emocionale. Ai ndihmon në lehtësimin e sëmundjeve si artriti, koliti, astma, alergjitë e ndryshme dhe largon lodhjen, duke ulur kalimin e pjesëzave të vogla të patretura mirë nga zorrët në enët e gjakut, kështu që e kursen organizmin nga shumë agjentë të panvojshëm për një kohë.

Përveç atyre që u përmendën “agjërimi është një praktikë e vërtetë, që siguron rregull në të ushqyerit e shëndetshëm”, - thotë Dr. Ali Sait Turgut.

Po ashtu, ramazani është një shans i mirë për ata që kanë kilogram të tepërt, në mënyrë që t'i heqin ato.

Shujtat e iftarit dhe syfyrit janë të mjaftueshme, për sa i përket mbajtjes së baraspeshës kalorike trupore dhe materieve të nevojshme ushqyese.

Dieta jonë gjatë ramazanit nuk ka nevojë të ndryshojë nga dieta jonë normale. Ajo duhet të jetë sa më e thjeshtë, ashtu që as të mos shtojmë peshë, e as mos të humbim.

# ESORE PËR AGJËRIM TË LEHTË

Në raport me kohën e gjatë të ditëve të verës, ushqimi ynë në syfyr duhet të jetë i begatë në meny me karbohidrate komplekse, pra me ushqime që treten ngadalë. Kjo për arsye se këto ushqime qëndrojnë në traktin digjektiv rreth 8 orë dhe, në këtë mënyrë, bëjnë që organizmi të mos ndiejë uri për një kohë më të gjatë të ditës. Në mesin e këtyre ushqimeve bëjnë pjesë: elbi, gruri, meli, bollguri, fasulja, thjerrëzat, mielli i zi dhe orizi i paqëruar.

Për dallim prej këtyre produkteve që qëndrojnë gjatë në traktin digjektiv, për iftar rekomandohen karbohidrate të thjeshta, pra ushqime me tretje të shpejtë. Qëndrimi i këtyre produkteve me tretje të shpejtë në traktin digjektiv sillet rreth 3-4 orë. Këto produkte është mirë të konsumohen në iftar, sepse krahas ngritjes në nivelin optimal të glukozës në gjak, ato treten shpejt dhe lënë vend edhe për ushqime të tjera më vonë. Në këtë kategori hyjnë sheqeri dhe mielli i bardhë.

Mbyllja e agjërimit është një moment sa i kënaqësisë, po aq edhe i rrezikut. Ngase pas një urie organizmi do t'ia arrijë synimit të plotësisë dhe nuk do përzgjedhë shumë ushqime të mira a jo të mira. Të rekomanduashme në këtë çast janë ushqimi i lehtë ose uji ngase nuk do ta rëndojnë lukthin dhe do ta sinjalizojnë se "pas pak do të vjen ushqim tjetër, kështu që bëhu gati".

Pas iftarit, posaçërisht, rekomandohet të konsumohen pemët, ngase përveç se janë të lehta për t'u tretur, ato plotësojnë një pjesë të nevojave të materieve ushqyese të organizmit si lëngje, minerale dhe vitamina.

Mishrat e pjekur, ushqimet shumë djegëse dhe ushqimet që përmbajnë shumë sheqer, të tilla si ëmbëlsirat, mund të shkaktojnë probleme shën-

detësore si dispepsi, të rrahura të shpejta të zembrës, gogësim, refluks ezofageal etj.

Rritja e aciditetit të lukthit shkakton një ndjenjë të pakënaqësisë dhe djegie në gjoks dhe kërkon përveç marrjes me sasi të pakta të ushqimit, nganjëherë edhe medikamente.

Kështu që personave me këtë problem iu rekomandohet që të vizitohen te mjeku dhe gjatë ramazanit ta shtojnë numrin e shujtave ndërmjet iftarit dhe syfyr, duke bërë kështu që për 4 ose 5 shujta me nga pak ushqim të merret një sasi e mjaftueshme ushqimi për agjërimit disaorësh. Nuk preferohet që këta persona të bien të flenë pas ngrënies



së shujtës së iftarit ose syfyr, për arsye se kjo e rrit në masë të ndjeshme refluksin gastroezofageal, e bashkë me atë edhe djegien e kraharorit si simptomë përcjellëse.

Parandalimi i dehidrimit gjatë ditëve të nxehta të verës duhet të jetë në mesin e prioriteteve të ruajtjes së shëndetit të agjëruesit. Konsumimi i 2.5 deri 4 litra ujë dhe lëngje mes iftarit dhe syfyr do të ndikojë që organizmi të kondensojë sasi të mjaftueshme dhe të mos bjerë në dehidrim gjatë ditës. Duhet pasur kujdes që deri para fjetjes të konsumohen të paktën 8 gota ujë, në mënyrë që në syfyr të mos ketë probleme dhe disbalancë mes



kapacitetit dhe nevojës për ujë.

Pijet e gazuara, përveç që janë të dëmshme jashtë ramazanit, janë veçanërisht të dëmshme në ramazan. Kjo ngase për një kohë të "gjatë" lukthi është në "pushim" dhe i qetë. Ngacmimi që vjen nga këto lëngje mund ta shtojë në masë të madhe aciditetin e lukthit, e po ashtu mund të ndikojë në shfaqjen e refluksit gastroezofageal.

Konsumimi i kafes dhe çajit duhet të kufizohet në syfyr. Kjo ngase konsumimi i tepërt ngacmon organizmin në lirim të urinës dhe jashtëqitjes. Këto dy të fundit ndikojnë në zvogëlimin e sasive të ujit, natriumit, kaliumit e magneziumit në organizëm e mund të çojnë edhe në dehidrim. Për të kompensuar nevojat e organizmit për këto elemente, konsumimi i bananes është një opsion i mirë, por duhet pasur parasysh që konsumimi i shtuar i saj mund të çoj deri në kapsllëk.

Është e rëndësishme që koha në ramazan të menaxhohet në mënyrë të tillë që, përveç ibadeteve të agjërimit dhe faljes së namazit, t'i kushtohet kujdes edhe kohës së gjumit, studimit, punës dhe aktiviteteve fizike. Aktivitetet fizike si ecjet e lehta, do ndihmojnë që, krahas dietës ditore me kalori të caktuara, të digjen edhe ca kalori dhe organizmi të qëndrojë në peshë optimale. Falja e namazeve të teravive përveçse do ndihmojë që trupi të jetë me fleksibil, do ndihmojë gjithashtu edhe që ai të shpenzojë përafërsisht 200 kalori. Gjumi i mjaftueshëm do ndikojë si një "bateri" për realizimin e aktiviteteve ditore, e po ashtu do ndihmojë në parandalimin e lajmërimit të dhembjes së kokës, plogështisë dhe parandalimit të uljes së përqendrimit në punë.

Në Angli ramazani shfrytëzohet nga shumë institucione shëndetësore si model dhe mundësi e mirë për lënien e cigares. Kjo posaçërisht praktikohet në mesin e aziatikëve dhe afrikanëve. Meqë një person mund të qëndrojë pa substancat e "vartësisë" që ka duhani, për një kohë prej para lindjes së diellit deri pas perëndimit të diellit, mund edhe ta lërë atë krejt. ■



Fondacioni  
NEKTARI I MIRËSISË

## 'MARA' NDIHMOI GJATË RAMAZANIT

**A**ktivistet e fondacionit 'Nektari i Mirësisë' në Prishtinë kanë ndihmuar disa familje skamnore gjatë muajit ramazan. Në fazën e kërkimit të donatorëve është rënë në kontakt me disa biznese të reja vendore, të cilat kanë dhënë kontributin e tyre në fondacion. Suksesi më i madh i fondacionit është shënuar me rastin e gjetjes së një donacioni nga shteti holandez. Ashtu sikurse fondacioni 'Nektari i Mirësisë' edhe fondacioni holandez udhëhiqej nga studentët. Për ta realizuar bashkëpunimin reciprok studentët nga Holanda kanë ardhur në Kosovë me mjetin e tyre transportues. Numri i familjeve të ndihmuara në muajin ramazan ka qenë mbi njëzetë. Artikujt e përfshirë në pako ishin: gjëra ushqimore, higjienike, veshmbathje, ushqim i veçantë për fëmijë, lodra fëmijësh etj. Një pako arrinte vlerën 45 euro. Një pjesë e gjërave të dhuruara janë sjellë nga Holanda nga këta tre studentë të Fondacionit 'Mara'. Shpërndarja

e këtyre pakove ushqimore në bashkëpunim me këtë fondacion është realizuar në fillim të muajit ramazan dhe është vazhduar përgjatë gjithë muajit, duke ndihmuar edhe familjet e tjera. Është ndihmuar edhe një nxënës 18 vjeçar, i cili ka pësuar një sulm në trurin e tij, e që tash e dhjetë muaj është pothuajse i palëvizshëm në shtrat. Familja e tij jeton me qira në njërën nga lagjet e Prishtinës. Gjendja e tyre është rënduar edhe më shumë, pasi që babai i djalit është detyruar të ndërpresë punën për shkak të nevojës për të qëndruar afër djalit të sëmurë, i cili ka arritur të përfundojë vetëm gjysmëvjetorin e parë të shkollës së mesme 'Alaudin' dhe pret edhe ndihma të tjera për mjekim.

**Lavdim GASHI**

# Aktivitetete të shumta nga OJQ 'Rinia Jonë - A'



**Lavdim GASHI**

**1** Iniciativa qytetare 'Rinia Jonë-A' edhe në muajin e Ramazanit vazhdoi aktivisht dhe suksesshëm në realizimin e projekteve të ndryshme përmes të cilave synoi vetëdijësimin e qytetarëve dhe institucioneve vendore.

Kampanja sensibilizuese për mos-diskriminimin e vajzave të mbuluara ishte aktiviteti i cili në këtë muaj hyri në fazën përfundimtare të tij.

Kjo kampanjë filloi më datën 8 korrik në kryeqytetin tonë konkretisht në Sheshin N. Tereza ku ishte vendosur një fotografi me mbishkrime të ndryshme.


Pikë tjetër përbërëse e këtij aktiviteti ishte edhe një fllajer, në të cilin përshkruhej e sqarohej vlera e mbulesës të një besimtare, pastaj trajtimin të cilin ia bën ligjshmëria vendore si dhe mbrojtjen e konventave ndërkombëtare për respekti-

min e dispozitave fetare. Zbukurimin dhe vlefshmërinë artistike të këtij aktiviteti ia jepte edhe prezenca 3 nxënësve nga shkollat mesme të ndryshme të kryeqytetit, të cilët nxënës realizuan tri piktura me moton e kësaj kampanje "Ndal Diskriminimin".


Kulminacioni i aktivitetit ishte elementi simpatik përbërës i këtij aktiviteti, balonat të cilët ishin të mbushur me helium e në vete kishin një poster ku ishte foto e mbulesës me mbishkrimin "Ndal Diskriminimin".

Ky aktivitet është realizuar edhe në qytetin e Pejës, ku kanë ndryshuar pikat përbërëse të aktivitetit; në këtë aktivitet pika kryesore ishte paraqitja e tri deryve me mbishkrimin "Hapja derën Tolerancës", pastaj "Mbyllja derën Diskriminimit" dhe "Kosova është Shtëpia ime".

**2** Duke ju afruar dhjetë netëve të fundit të Ramzanit aktivistët e 'Rinisë' konkretisht hoxha Sami



ef Fetahu përktheu dhe përshtati një shkrim me titullin 'Më e Mirë se Një mijë Muaj' e që në të jepen sqarime për Natën e Kadrit, kur duhet kërkuar, si duhet kërkuar dhe çfarë duhet vepruar





në kohën kur ajo kërkohet dhe pretendohet se gjendemi në të. Fllajeri është shpërndarë në xhamitë e Prishtinës në hyrje të dhjetë netëve të fundit.

**3** Pikë e vazhdshmërisë në dhënien e hakut në sqarimin dhe ofrimin e literaturës lidhur me Natën e Kadrit, ishte edhe punimi i veçantë në të cilën paraqitej hadithi i pejgamberit a.s.

Kjo lutje është shpërndarë pas shpërndarjes së fllajerit lidhur me sqarimet mbi Natën e Kadrit dhe janë përfshirë xhamitë e Prishtinës.



**4** Ekspozita e fotografive, një ide e lindur thjesht nga keqardhja për gjendjen në të cilën gjenden besimtarët muslimanë. Me 5 shtator ditë e diel ishte Nata e pretenduar e Kadrit, pikërisht në atë ditë edhe u hap solemnisht katedraleja në Prishtinë. Iniciativa QYTETARE ``Rinia Jonë - A`` realizoi ekspozimin e pesë fotografive me madhësi tetë metra gjatë dhe një e gjysmë lartësi. Fotografitë ishin të realizuara në oborret e xhamive të ndryshme të kryeqytetit, ku shifej qartë dhe thjesht mungesa e hapësirave për të kryer me një komoditet adhurimet e besimit islam..Këto fotografi janë vendosur në 5 vendet më të frekuentuara të kryeqytetit, para qeverisë së Kosovës, te komuna e Prishtinës pastaj te xhamia e qarshisë, te rrethi i madh në Lakrishte dhe e fundit edhe pika më e rëndësishme pranë katedrales, e cila po këtë ditë përurohej. Me rëndësi është të ceket interesimi i madh i mediave vendore. Gjashtë televizione dhanë si lajm dhe dy të tjera kanë pasur

temë debati të veçantë në emisionet e tyre ditore. Pastaj aktiviteti është mbuluar edhe nga gazetatat ditore dhe web faqe të ndryshme.

**5** Organizata “Rinia Jonë - A” njërin nga aktivitetet e vitit të kaluar kishte organizmin e tribunave ligjëratave me karakter fetar. Konkretisht ishin mbajtur pesë ligjëratat në xhaminë ‘Jusuf Qelebiu’ dhe një tribunë ne Hotel Grand. Temat të cilat ishin shtjelluar, nga anëtarët e organizatës janë përshkruar në letër dhe përpunuar për botim në formë libri. Ligjëruesit ishin nga Prishtina si Osman Abazi, Regjep Qerkezi, hafiz Afrim Bulliqi Husamedin Abazi dhe Bahri Sejdiu. Në tribunën e mbajtur në hotelin Grand ishin të ftuar Dr Dashurie Kryeziu dhe Dr. Shefqet Krasniqi.

**6** Njëri nga aktivitetet tona në këtë muaj të begatshëm të Ramazanit ishte edhe shtruarja e një iftari në xhaminë Jusuf Qelebiu ku imam është ef.Hakif Hoti.

Të ftuar në këtë iftar ishin kryesisht djem të rinj, të cilët kanë reformuar jetët e tyre, pas kalimit të një pjese të jetës jashtë një Islami praktikues tashmë i janë bashkuar “vallës” së udhëzimit si dhe shumë të rinj të tjerë. ■



Zdrukthëtari: prodhime bungu dhe interieri

N.T.P.



**Rrasa e Zogut**

+377 44 417 197

+377 45 269 202

Adresa: Fsh. Gërmovë, Viti

Studio për prodhimin e kuzhinave

**kezza**



**VITE GARANCION**

kkeza@hotmail.com

mob. +377 (0)44 141 909

tel & fax. +381 (0)38 243 863

Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes **Raiffeisen Bank**

**Made in Kosova**



Libri më i ri  
i mr. Ajni Sinani  
botuar nga Zëri Ynë



4€

Mr. Ajni SINANI

# Çështja e Palestinës

PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

(1948 - 2008)

Zëri Ynë